



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 108

Tiranë – E mërkurë, 19 korrik 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Kulturës nr. 446, datë 11.7.2023	Për miratimin e formatit dhe të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për akreditim të institucionit muzeor..... 11115
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 445, datë 11.7.2023	Për miratimin e veprimtarisë së Bordit të Akreditimit të Muzeve dhe të formatit të certifikatës së akreditimit..... 11119
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 12.6.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 240, datë 16.6.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimin e fjalisë “ <i>Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit</i> ”, në nenin 482, paragrafi 3, të Kodit të Procedurës Civile, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimin e fjalisë “ <i>Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara</i> ”, në nenin 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 11125
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 36, datë 16.6.2023	Me objekt shfuqizimin e ligjit nr. 145/2020, datë 3.12.2020, “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 145/2020, datë 3.12.2020, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi..... 11147

Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 8, datë 3.7.2023	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	11176
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 9, datë 3.7.2023	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	11178

**UDHËZIM****Nr. 446, datë 11.7.2023****PËR MIRATIMIN E FORMATIT DHE TË
DOKUMENTACIONIT SHOQËRUES TË
KËRKESËS PËR AKREDITIM TË
INSTITUCIONIT MUZEOR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; nenit 215 të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për formatin e kërkesës, dokumentacionin shoqërues të kërkesës për akreditim të institucionit muzeor pranë Muzeut Historik Kombëtar (MHK), me qëllim dhënien ose jo të akreditimit për muzeun.

2. MHK-ja funksionon në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Muzeve (KKM).

3. Ky udhëzim zbatohet për akreditimin e muzeve si vijon:

- a) muze qendror;
- b) muze vendor;
- c) muze autonom;
- d) muze privat.

4. Çdo institucion qendror dhe vendor, person fizik apo juridik i regjistruar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për akreditimin e muzeut, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi, jo më vonë se një periudhë kohore prej 5 vitesh nga krijimi i tyre.

5. Formulari dhe dokumentacioni shoqërues paraqitet pranë MHK-së në cilësinë e Sekretariatit Teknik.

6. Dokumentacioni shoqërues duhet të përmbajë:

- a) letërnjoftimin e aplikuesit;
- b) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- c) sigurimin e disponueshmërisë së koleksioneve të muzeut për shoqërinë;

d) strategjinë për funksionimin dhe zhvillimin e muzeut.

7. Subjektet e interesuara ose ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore paraqesin pranë MHK-së, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të KKM-së, kërkesën për akreditim të institucionit muzeor. MHK-ja, brenda një afati prej 15 ditësh nga kërkesa, i paraqet Bordit të Akreditimit të Muzeve relacionin mbi përputhshmërinë formale të kërkesës me formatin dhe dokumentacionin që shoqëron kërkesën, të miratuara sipas këtij udhëzimi.

8. Në rast se MHK-ja konstaton se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi nuk plotëson dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5 të këtij udhëzimi njofton kërkuesin për të bërë plotësimet e nevojshme brenda një afati 10-ditor.

9. Bordi i Akreditimit, pas marrjes së relacionit dhe dokumentacionit që shoqëron kërkesën nga MHK-ja, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të BAM-së, fillon procesin e verifikimit, i cili përfundon me një raport paraprak dhe i propozon Këshillit Kombëtar të Muzeve dhënien ose jo të akreditimit për muzeun. Raporti u njoftohet subjekteve të interesuara, të cilat brenda 30 ditëve, paraqesin vëzhgimet e tyre.

10. Raporti përfundimtar në vijim të vëzhgimeve të subjekteve të interesuara i paraqitet KKM-së jo më vonë se 8 muaj, nga paraqitja e kërkesës. Bordi i Akreditimit të Muzeve, në fund të raportit i propozon KKM-së dhënien ose jo të akreditimit për muzeun.

11. Vendimi i KKM-së për akreditimin e muzeut apo rrëzimin e kërkesës i njoftohet palës propozuese dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, e cila, nëse propozimi është pozitiv, lëshon certifikatën e akreditimit për muzeun.

12. Ngarkohet Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Kulturës dhe MHK-së për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
MUZEU HISTORIK KOMBËTAR

Aneks 1

FORMULAR KËRKESË PËR AKREDITIMIN E NJË MUZEU

1. TË DHËNA PËR KËRKUESIN	
Emri i Muzeut kërkuar:	
Adresa e institucionit:	
Klasifikimi i Muzeut:	☐ Qëndror ☐ Vendor ☐ Autonom Institucion Publik ☐ Autonom Person Juridik privat ☐ Muze Privat
Klasifikimi sipas tematikës:	☐ Muze i përgjithshëm ☐ Muze i specializuar
Klasifikimi sipas pronësisë së fondeve:	☐ Muze publik <i>(për muzetë qendror, vendor dhe muzetë autonom – institucion publik)</i> ☐ Muze privat <i>(për muzetë privat dhe autonom – person juridik privat)</i>
Statusi:	☐ Me status kombëtar <i>(vetëm për muzetë qendror dhe privat)</i> ☐ Pa status kombëtar
NIPT:	
Përfaqësuesi i autorizuar në ndjekjen e projektit:	<i>(Emri, Mbiemri, ID, Nr. Tel / Cel, Email)</i>
Kontakt i Institucionit:	<i>(Adresa, Nr. Tel / Cel, Email)</i>
2. TË DHËNA PËR INFRASTRUKTURËN E MUZEUT	
Vendodhja e saktë:	
Nr. kate:	
Sipërfaqja totale:	
Projekti Arkitektonik	
Plani i emergjencave	<i>Mund të jetë dokument më vete ose pjesë e projektit arkitektonik.</i>



3. KAPACITETI ORGANIZATIV

A. Drejtimi dhe menaxhimi i Muzeut

Deklaratë e qëllimit të veprimtarisë:	Qëllimi i ekzistencës së Muzeut
	Kategoria e Vizitorëve të cilëve u shërbehet
Struktura Organizative	Strukturë organizative e përshtatshme dhe dokumentacion i plotë për strukturat drejtuese.
Struktura e plotë për menaxhimin dhe drejtimin e Muzeut:	Organigramë e plotë e strukturës dhe gjithë funksioneve të saj.
	Dokumente ligjorë (<i>Statute apo udhëzime të shkruara ku përcaktohet autoriteti dhe përgjegjësia për marrjen dhe miratimin e vendimeve që rregullojnë veprimtarinë e institucionit muzeor</i>).
	Kontratat e punës me stafin.
	Dëshmi të dokumentuara se struktura drejtuese e muzeut këshillohet në mënyrë profesionale nga individë apo struktura të vecanta.

B. Planifikimi, burimet njerëzore dhe financiare

Plan - Strategjia 5 vjeçare e zhvillimit të Institucionit Muzeor	Periudha kohore e shtrirjes së këtij Plani/Strategjie
	Objektivat kryesorë të planit/strategjisë
	Listimi i aktiviteteve që duhet të ndërmerren për arritjen e objektivave
	Burimet që planifikohen për të arritur këto objektiva (<i>Burimet njerëzore, instrukturore dhe financiare</i>)
	Tabela e buxhetit për vitin aktual kur aplikohet për akreditimin dhe për vitin pasardhës
	Periudha kohore e rishikimit të Planit Vjetor
Dokumentet e qëndrueshmërisë financiare të institucionit	<i>Burimet bazë të financimit:</i> 1. Buxheti i shtetit 2. Të ardhurat nga biletat 3. Të ardhurat nga të tretët

C. Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut në muze

Dokumenti i Vlerësimit të riskut për Sigurinë e Godinës, Stafit dhe Koleksioneve të Muzeut	<i>Dokumenti 5-vjeçar i vlerësimit të riskut për Sigurinë e Godinës</i>
--	---

4. MENAXHIMI I KOLEKSIONEVE

A. Ruajtja dhe zhvillimi i koleksioneve

Dokumenti i Koleksioneve Muzeore	1. Sasia e koleksionit të ekspozuar 2. Sasia e koleksionit që gjendet në arkiv (<i>nëse ka</i>)
Dokumenti i Politikave të Muzeut për Zhvillimin e Koleksioneve Muzeore	1. Përshkrim i përgjithshëm i koleksionit muzeor që muzeu ka në dispozicion 2. Temat dhe prioritetet e ardhshme për të grumbulluar koleksione



		muzeore 3. Informacion për kuadrin e etik lidhur me blerjen dhe zotërimin e koleksioneve muzeore 4. Përcaktimi i periudhës kohore kur ky dokument ri-shikohet nga strukturat përkatëse
B. Hartimi dhe përdorimi i informacionit mbi koleksionet muzeore		
Dokumenti i Politikave për koleksionin		<i>Mund të jetë dokument i vecantë ose pjesë e Planit të Menaxhimit të Koleksionit të Muzeut</i>
Procedurat e dokumentimit të Spektrit Primar përmas Planit të Menaxhimit të Koleksioneve		Përfshihen hapa si: 1. Hyrja e objektit muzeor në muze 2. Blerja dhe ekspozimi 3. Kontrolli i vendodhjes e lëvizjes së objektit muzeor 4. Inventarizimi 5. Katalogimi 6. Dalja e objektit nga muzeu 7. Huamarrja e objekteve nga muzeu 8. Huadhënia e objekteve nga muzeu 9. Planifikimi i dokumentimit Paraqitja e Manualit të Procedurave të Dokumentimit të Koleksioneve Muzeore
C. Përkujdesja dhe ruajtja e koleksioneve muzeore		
Dokumenti për Ruajtje, Restaurimin dhe Konservimin e koleksionit muzeor		<i>Mund të jetë dokument i vecantë ose pjesë e Planit të Menaxhimit të Koleksionit të Muzeut</i>
Plani i Menaxhimit për Ruajtje, Restaurimin dhe Konservimin e koleksionit muzeor		<i>Mund të jetë dokument i vecantë ose pjesë e Planit të Menaxhimit të Koleksionit të Muzeut</i>
4. VIZITORËT DHE PËRVOJAT E TYRE		
A. Aksesit i lehtësuar në muze për publikun dhe vizitorët		
Dokumenti i Aksesit për Vizitorët në Muze		Parashikon të gjithë hapat që ndërmerren për të lehtësuar aksesin e vizitorëve në koleksionet muzeore
Plani për përmirësimin e Aksesit të Vizitorëve në Koleksionet Muzeore		Paraqitja e një plani për: 1. Përmirësimin e aksesit fizik në godinë 2. Përmirësimin e shpjegimit intelektual të koleksionit muzeor 3. Përmirësimin e aksesit online <i>Mund të jetë një dokument i vecantë ose pjesë e Planit për Rritjen e numrit të Vizitorëve në Muze</i>
B. Mirëkuptimi dhe afërsia me vizitorët nga stafi i muzeut		
Plani për rritjen e numrit të vizitorëve në muze		

**C. Përfshirja e vizitorëve dhe përmirësimi i përvojave në Muze**

Plani për promovimin e Muzeut dhe Organizimin e Aktiviteteve që përfshijnë vizitorë të kategorive të ndryshme

Plani i promovimit përfshin forma të marketingut si:

1. *Offline (fletëpalosje, guida, suvenire)*
2. *Online (ëbsite, rrjete sociale)*
3. *Aktivitete të formave të ndryshme interaktive*

5. NJOFTIMI

Marrja e informacionit:	Postë	Email	E-Albania
Email (për njoftimin):			
Afati i njoftimit:	Jo më vonë se 3 ditë nga vendimi i KKM-së		

Ky shërbim jepet bazuar në:

1. Ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
2. VKM-në nr.788, datë 26.12.2018 “Për përbërjen, kompetencat, mënyrës e funksionimit e të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Muzeve”;
3. Urdhrin nr. ___, datë _____ të Ministrit të Kulturës “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Muzeve dhe Sekretarisë Teknike”;
4. Udhëzimin nr. ___, datë _____ të Ministrit të Kulturës “Për miratimin e formatit të kërkesës, dokumentacionit shoqërues dhe procedura e shqyrtimit të dokumentacionit nga ana e Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Muzeve për krijimin e muzeve”.

URDHËR

Nr. 445, datë 11.7.2023

**PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË SË
BORDIT TË AKREDITIMIT TË
MUZEVE DHE TË FORMATIT TË
CERTIFIKATËS SË AKREDITIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 dhe nenit 119, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 5, të nenit 41, të nenit 217, pikës 4, dhe të nenit 218, të ligjit nr. 27/2018, datë 17.5.2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e veprimtarisë së Bordit të Akreditimit të Muzeve, sipas rregullore bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Miratimin e formatit të certifikatës së akreditimit, sipas modelit bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Ngarkohet Muzeu Historik Kombëtar, Bordi i Akreditimit të Muzeve për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Kulturës për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

RREGULLORE

**PËR VEPRIMTARINË DHE MENYRËN E
FUNKSIONIMIT TË BORDIT TË
AKREDITIMIT TË MUZEVE**

Neni 1
Objekti

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësisë të Bordit të Akreditimit të Muzeve (këtu e në vijim BAM-i), organizimin e tij të brendshëm, thirrjen e mbledhjeve dhe procedurat e vendimmarrjes.

2. BAM-i përcakton nëse muzeu dhe/ose aktiviteti muzeor i tij përmbushin standardet e caktuara të cilësisë, edukimit, sigurisë, ruajtjes dhe



mbrojtjes së vlerave kulturore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo rregullore miratohet në përputhje me nenet 41, 197, 216 e vijues, e nenin 241, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 3 Parimet

Anëtarët e BAM-it, gjatë kryerjes së detyrave, udhëhiqen nga parimet e:

- a) ligjshmërisë;
- b) barazisë;
- c) pavarësisë;
- d) përgjegjshmërisë në marrjen e vendimeve;
- e) drejtësisë dhe paanësisë;
- dh) profesionalizmit, cilësisë, eficiencës dhe efektivitetit të shërbimit;
- e) ruajtjes së konfidencialitetit;
- ë) papranueshmërisë së konfliktit të interesit.

Neni 4 Përbërja e BAM-it

1. BAM-i ngrihet dhe funksionon pranë Këshillit Kombëtar të Muzeve (KKM).

2. BAM-i përbëhet nga kryetari dhe 4 anëtarë, të cilët emërohen për një periudhë 2-vjeçare, me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

3. Anëtarët e BAM-it mund të japin dorëheqjen në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim kryetarin 15 ditë përpara largimit. Anëtari ka detyrimin të përmbushë detyrat e ngarkuara deri në largimin e tij, si dhe të dorëzojë detyrën sipas legjislacionit në fuqi.

4. Lirimi nga detyra i anëtarit të BAM-it bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Urdhri për lirimin përmban arsyen, kohën e mbarimit të detyrës dhe/ose detyrat apo përgjegjësitë e anëtarit në dorëzimin e detyrës.

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë e BAM-it

Detyrat e BAM-it janë si më poshtë:

1. Harton raportin paraprak për akreditimin e një muzeu dhe/ose një aktiviteti muzeor pas marrjes së relacionit dhe dokumentacionit që shoqëron kërkesën nga sekretaria teknike pranë Muzeut Historik Kombëtar.

2. Argumenton dhe mbështet vendimet e tij për akreditimin, në bazë të nenit 216, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe në parashikimet si më poshtë vijon:

- a) statusin ligjor të institucionit/muzeut;
- b) të dhënat kryesore për institucionin/muzeun dhe programet e tij;
- c) raportet e vetëvlerësimit të institucionit/muzeut;
- d) raportin e vlerësimit në institucionin muzeor;
- e) raportin e vlerësimit nga grupi i vlerësimit të jashtëm rast pas rasti;
- f) informacionin për zbatimin e rekomandimeve të dhëna gjatë vlerësimeve/akreditimeve të mëparshme dhe çdo të dhënë tjetër të rëndësishme;
- g) çdo të dhënë shtesë, të kërkuar përpara marrjes së vendimit.

3. Rivlerëson dhe rishqyrton raportin e tij të akreditimit, në rastet kur:

- a) KKM-ja identifikon mungesë përputhshmërie me standardet, pas marrjes së akreditimit fillestar ose gjatë periudhës së akreditimit;
- b) ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore i dërgon të dhëna dhe dokumente për shkelje të mundshme të standardeve të cilësisë ose parashikimeve ligjore.

4. Bazuar në pikën 2, të nenit 216, të ligjit nr. 27/2018, propozon për kohëzgjatjen dhe afatin e vlefshmërisë së akreditimit. Kriteret për përcaktimin e vlefshmërisë së akreditimit janë:

- a) përmbushja e standardeve të akreditimit, rezultatet nga procedura të mëparshme akreditimi dhe zbatimi i rekomandimeve të mundshme;
- b) rezultatet nga monitorimi i procesit të akreditimit nga institucionet që i kanë në administrim dhe ndërmjet periudhave të akreditimit;
- c) të dhënat për qëndrueshmërinë institucionale, veçanërisht për sa i përket proceseve, burimeve dhe stafit.



Neni 6

Të drejtat dhe detyrat e kryetarit dhe anëtarëve të BAM-it

1. Kryetari i BAM-it ka të drejta dhe detyra si vijon:

- a) kryeson dhe drejton mbledhjet e BAM-it;
- b) miraton rendin e ditës për çështjet që do të shqyrtojnë BAM-i;
- c) nënshkruan vendimet e BAM-it.

2. Anëtari i BAM-it ka të drejta dhe detyra si vijon:

- a) të njihet me dosjen dhe çdo dokument tjetër që lidhet me çështjen për të cilën do të marrë vendim;
- b) të shprehë lirshëm mendimin e tij;
- c) të kërkojë caktimin e ekspertëve të jashtëm kur vlerëson se çështja ka nevojë për ekspertizë më të thelluar;
- ç) të shpërblehet si anëtar i BAM-it;
- d) të marrë pjesë rregullisht në mbledhje;
- dh) të ushtrojë funksionet e tij me profesionalizëm dhe përgjegjshmëri;
- e) të ruajë konfidencialitetin për çështjet, dokumentet dhe faktet për të cilat ka marrë dijeni për shkak të detyrës;
- ë) të shmangë çdo situatë konflikti interesi;
- f) të votojë;
- g) të arsyetojë mendimin kundër.

Neni 7

Vula e BAM-it

1. BAM-i ka vulën e vet zyrtare, e cila përmban këto të dhëna:

- a) në rrethin e parë të jashtëm shkruhet “REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MINISTRIA E KULTURËS”;
- b) në rrethin e dytë shkruhet “BORDI I AKREDITIMIT TË MUZEVE”;
- c) në qendër të vulës vendoset stema e Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Aplikimi për akreditim

1. Subjektet e interesuara aplikojnë pranë sekretarisë teknike nëpërmjet plotësimit/ depozitimit të të gjitha të dhënave, në përputhje me formatin e kërkesës, dokumentacionin shoqërues të

miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Sekretaria teknike bën regjistrimin e kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur në regjistrin e hyrjeve dhe hap dosjen përkatëse të çështjes, dhe brenda afatit 45-ditor i paraqet BAM-it relacion mbi përputhshmërinë formale të kërkesës me formatin dhe dokumentacionin shoqërues, sipas formatit të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Nëse kërkesa e paraqitur nuk përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e parashikuar në ligj/aktet nënligjore, sekretaria teknike njofton kërkuuesin dhe i cakton atij një afat 10-ditor për plotësimin e kërkesës. Nëse kërkuesi nuk plotëson dokumentacionin brenda afatit të caktuar e kthen dosjen “pa veprim”.

4. Nëse dokumentacioni është i plotë apo plotësohet brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, sekretaria teknike, brenda afatit 15-ditor, i paraqet BAM-it relacionin mbi përputhshmërinë e kërkesës me formatin dhe dokumentacionin që shoqëron kërkesën të miratuar sipas këtij udhëzimi.

5. BAM-i, pas marrjes së relacionit dhe dokumentacionit që shoqëron kërkesën nga sekretaria teknike, fillon procesin e verifikimit, i cili përfundon me një raport paraprak. Ky raport u njoftohet subjekteve të interesuara, të cilat brenda 30 ditëve paraqesin vëzhgimet e tyre.

6. Raporti përfundimtar në vijim të vëzhgimeve të subjekteve të interesuara i paraqitet KKM-së, jo më vonë se 8 muaj nga paraqitja e kërkesës.

7. BAM-i, në fund të raportit, i propozon KKM-së miratimin ose jo të kërkesës për akreditimin e muzeut.

8. Vendimi i KKM-së për pranimin ose jo të kërkesës për akreditimin e muzeve i njoftohet palës propozuese dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

9. Në rast aprovimi të akreditimit ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore lëshon certifikatën e akreditimit të muzeut, sipas aneksit bashkëlidhur.

10. Vendimi i KKM-së mund të ankimohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.



Neni 9

Sekretaria teknike

1. Muzeu Historik Kombëtar funksionon si sekretari teknike e BAM-it, sipas parashikimit në pikën 5, të nenit 204, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Sekretaria teknike është përgjegjëse për:

- a) organizimin e mbledhjeve të BAM-it;
- b) kryerjen e njoftimeve dhe shpërndarjen e materialeve anëtarëve të BAM-it;
- c) mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve;
- ç) hartimin e vendimit/relacionit sipas vendimarrjes së BAM-it;
- d) njoftimin e vendimit të aplikuesit pas miratimit nga KKM-ja dhe ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
- dh) mbajtjen e regjistrit të vendimeve;
- e) mbajtjen dhe administrimin e dosjeve të BAM-it.

Neni 10

Regjistrat

1. Pranë sekretarisë teknike mbahet regjistri i vendimeve të akreditimit.

2. Regjistri i vendimeve përmban të paktën të dhënat për:

- a) numrin e vendimit;
- b) datën e vendimit;
- c) objektin e vendimit;
- ç) subjektin përfitues/aplikues;
- d) datën e njoftimit.

3. Regjistri mbahet në dy forma:

- a) në formë manuale; dhe/ose
- b) në formë elektronike.

Neni 11

Administrimi i dosjes nga sekretariati teknik

1. Sekretaria teknike merr në shqyrtim dosjet e përcjella sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe verifikon në aspektin formal nëse aplikimi dhe dokumentacioni i përcjellë është në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Nëse aplikimi përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e parashikuar në ligj sekretaria administron dosjen dhe, në përputhje me këtë rregullore, ia përcjell për shqyrtim BAM-it.

Neni 12

Caktimi dhe njoftimi i mbledhjeve

1. BAM-i mbledhet jo më pak se një herë në 2 muaj.

2. Pas shqyrtimit të relacioneve të paraqitura nga sekretaria teknike, kryetari cakton ditën dhe orën e thirrjes së mbledhjes dhe miraton rendin e ditës. Njoftimi me rendin e ditës dhe relacioni i sekretariatit teknik u përcillet të gjithë anëtarëve, jo më vonë se 3 ditë para datës së caktuar për mbledhjen. Anëtarët kanë të drejtë të propozojnë ndryshime ose shtesa në rendin e ditës përpara ditës së mbledhjes.

3. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes i komunikohet subjekteve të interesuara nga sekretaria teknike, jo më vonë se 3 ditë para datës së caktuar për mbledhjen. Së bashku me njoftimin sekretaria përcjell edhe rendin e ditës dhe, kur është rasti, kërkon dhe paraqitjen e dokumenteve të tjera lidhur me kërkesën.

4. Anëtarët dhe subjektet e interesuara marrin pjesë në mbledhjet e BAM-it në vendin, ditën dhe orën e përcaktuar në njoftim. Në rastin e pamundësisë për të marrë pjesë në kohën dhe vendin e caktuar, kanë detyrimin të njoftojnë paraprakisht kryetarin apo sekretarinë teknike të BAM-it mbi shkaqet e mungesës dhe mundësinë e shtyrjes së mbledhjes.

Neni 13

Zhvillimi i mbledhjeve

1. Mbledhjet e BAM-it zhvillohen gjithmonë në prani të kryetarit dhe janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në rast të mosarritjes së kuoromit të kërkuar, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse.

2. Fillimisht kryetari verifikon prezencën e anëtarëve. Në rastin e mungesës së anëtarëve, të kërkuarit/aplikuesit ose të ekspertëve, verifikon nëse ka shkaqe të justifikuara për mosparaqitjen dhe urdhëron mbajtjen e shënimit përkatës në procesverbalin e mbledhjes. Nëse është paraqitur kërkesë me shkaqet e justifikuara, kryetari shqyrton kërkesën dhe nëse e gjen të bazuar mund të vendosë shtyrjen e mbledhjes në një ditë dhe/ose një orë tjetër.

3. Në rast se nga verifikimi rezulton se nuk formohet kuorumi i nevojshëm për vendimarrje



shtyn mbledhjen, por jo më vonë se 48 orë. Nëse kuorumi i kërkuar nuk formohet as në mbledhjen e radhës, kryetari shtyn mbledhjen edhe për një afat tjetër 48 orësh. Në rast të mosformimit sërish të kuoromit të nevojshëm për vendimarrje, BAM-i vendos me të paktën gjysmën e anëtarëve.

4. Mbledhja e BAM-it mund të kërkohej edhe nga 1/3 e anëtarëve, duke i drejtuar kërkesë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Zhvillimi i mbledhjes, në këtë rast, miratohet nga kryetari dhe u njoftohet të gjithë anëtarëve.

5. BAM-i mund të shqyrtojë dhe të votojë vetëm për ato çështje që janë përfshirë në rendin e ditës.

6. Përjashtimisht, në mbledhje mund të shqyrtohen çështje të tjera vetëm nëse janë të pranishëm të gjithë anëtarët të cilët miratojnë përfshirjen e çështjes në rendin e ditës.

7. Procesverbali i mbledhjes përfshin:

- a) orën, datën, vendin e mbledhjes;
- b) verifikimin e prezencës së pjesëmarrësve;
- c) çështjet e diskutuara;
- d) formën dhe rezultatin e votimeve;
- e) çdo informacion apo dokument, objekt diskutimi;
- f) vendimarrjen;
- g) mendimin e pakicës/mendimin kundër.

Neni 14

Konflikti i interesit dhe papajtueshmëritë

1. Në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, çdo anëtar i BAM-it, që ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, ose ka ndonjë pengesë tjetër ligjore, ka detyrim të deklarojë konfliktin e interesit dhe të kërkojë mospërfshirjen e tij në shqyrtimin dhe votimin e çështjes përkatëse në rendin e ditës.

2. Anëtari i BAM-it nuk duhet të jetë autor apo bashkautor, administrator, ortak në projektet që i kalojnë për shqyrtim dhe miratim BAM-it.

3. Në rast të gjendjes së konfliktit të vazhdueshëm të interesit, duhet të zbatohen kërkesat e nenit 38, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

4. Gjendja e konfliktit të interesit dhe përjashtimi nga shqyrtimi dhe votimi i kryetarit apo anëtarit dokumentohet me procesverbal të rregullt.

Neni 15

Vendimarrja

1. Votimi në BAM është i hapur dhe të gjithë anëtarët duhet të votojnë. Abstenimi nuk lejohet. Anëtarët që votojnë kundër duhet të argumentojnë me shkrim mendimin e tyre.

2. Kryetari i BAM-it voton i fundit. Në rastet kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

3. Vendimet e BAM-it nënshkruhen nga kryetari dhe siglohen nga sekretariati i BAM-it.

4. Format i vendimeve paraqitet si aneks bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

5. Vendimi i BAM-it zbardhet nga sekretaria teknike në bazë të procesverbalit, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit.

6. Një projekt quhet i miratuar, kur me shumicë votash vendoset pranimi i tij pa pasur nevojë për rregullime, përmirësime apo ndryshime. Në rastin kur BAM-i vendos se një projekt ka nevojë për rregullime, përmirësime apo ndryshime, procedohet me shtyrje të vendimarrjes brenda 60 ditëve dhe plotësimin me propozimet dhe/ose kërkesat e lëna nga BAM-i. Procedura e rishqyrtimit, për plotësimet apo ndryshimet, do të jetë e njëjtë.

7. Vendimi i njoftohet subjektit të interesuar jo më vonë se 3 ditë nga data e marrjes së tij sipas rregullave të njoftimit të akteve administrative në bazë të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 16

Shqyrtimi i çështjeve me procedurë të përshpejtuar

Në raste të jashtëzakonshme të fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura, apo për çështje të një rëndësie të veçantë të interesit publik, kur rrezikohet dëmtimi i pasurive kulturore, BAM-i merr vendim me procedurë të përshpejtuar brenda 15 ditëve. Vendimi firmoset nga kryetari dhe të gjithë anëtarët.



Neni 17

Ekspertët e jashtëm

1. Gjatë ushtrimit të funksioneve të saj vendimmarrëse, BAM-i mund të thërrasë, rast pas rasti, ekspertë të jashtëm, kur vlerëson që është e nevojshme për shkak të natyrës së veçantë apo teknike të çështjes, ose të kërkojë dokumente shtesë nga kërkuesit.

2. Ekspertët japin opinionin e tyre me shkrim, sipas kërkesave dhe/ose detyrave të përcaktuara nga BAM-i dhe nuk kanë të drejtë vote. Nëse për paraqitjen e ekspertëve ose depozitimin e dokumenteve të tjera është i nevojshëm caktimi i

një seance tjetër, BAM-i cakton një datë tjetër për paraqitjen e ekspertit, dëgjimin e kërkuesve, ose paraqitjen e dokumenteve të tjera shtesë.

Neni 18

Dispozitat e fundit

1. Çdo urdhër, udhëzim apo rregullore që është në kundërshtim me këtë rregullore shfuqizohet.

2. Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të BAM-it, dhe miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

CERTIFIKATË

AKREDITIMI

Mbështetur në ligjin Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”;
Vendimit Nr. __, datë __. __. 2022 të Bordit të Akreditimit të Muzeve;
Vendimit Nr. __, datë __. __. 2022 të Këshillit Kombëtar të Muzeve

I jepet kjo certifikatë akreditimi

Nr. Regjistri: _____

___ / ___ / 202__
Data

Firma
Ministri I Kulturës



VENDIM
Nr. 34, datë 12.6.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 6.4.2023 dhe 12.6.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 24 (A) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Anila Hoxha

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Shqipërisë,
Këshilli i Ministrave,
Ministria e Brendshme,
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Së Shtetit,
Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 240, datë 16.6.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i fjalisë “Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit”, në nenin 482, paragrafi 3, të Kodit të Procedurës Civile, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i fjalisë “Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara”, në nenin 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 15, 17, 33, 41, 42, 43, 49, 52 dhe 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 39, 49, 71, 71/a dhe 76, pika 6, të ligjit nr.

8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarës, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*), Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Brendshme (*ish-Ministria e Punëve të Brendshme*), Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuarja Anila Hoxha prej datës 5.1.2012 ka ushtruar detyrën e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit në Departamentin e Trajnimit Policor. Marrëdhënia e punës është ndërprerë si rezultat i nxjerrjes së urdhrit nr. 652, datë 15.11.2013 të ministrit të Brendshëm (*urdhri nr. 652/2013*), me të cilin kërkuarja është liruar nga detyra me motivacionin “Për shkurtim të funksionit organik dhe në pamundësi emërimi në detyrë tjetër”, bazuar në nenin 57, pika 2, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar (ligji nr. 9749/2007). Në këtë urdhër është disponuar, gjithashtu, se të drejtat administrative dhe financiare të kërkuarës ndërpritën në datën 20.11.2013, se ajo trajtohet financiarisht për ditët e pushimit vjetor të pakryer, ndërsa pas ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, trajtohet financiarisht sipas nenit 12 të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 10142/2009).



2. Kërkuesja ka ngritur padi në gjykatë me objekt shfuqizimin e urdhrit nr. 652/2013 dhe detyrimin e Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ta dëmshpërblenin me pagën që ajo do të përfitonte, deri në plotësimin e mandatit 4-vjeçar si zëvendësdyrektore e përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe ta trajtonin në përputhje me pikën 2 të nenit 25 të ligjit nr. 9749/2007 në datën e përfundimit të mandatit. Në themel të kërkesëpadisë kërkuesja ka pretenduar se lirimi nga detyra ishte bërë në kundërshtim me ligjin, në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara, ndonëse sipas nenit 25 të ligjit nr. 9749/2007 qëndrimi në detyrën e zëvendësdyrektore të përgjithshme të Policisë së Shtetit ishte për një periudhë 4-vjeçare, e cila përfundonte në datën 5.1.2016.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 223, datë 27.1.2014, ka vendosur pranimin e pjesës së padisë, duke detyruar Ministrinë e Brendshme ta dëmshpërblejë kërkuesen me pagën mujore deri në datën 5.1.2016, ndërsa kërkimet e tjera të padisë janë rrëzuar. Gjykata ka arsyetuar se kërkuesja nuk legjitimohej në ngritjen e kërimit për shfuqizimin e aktit administrativ, bazuar në vendimin unifikues nr. 31/2003 të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit rikthimi në punë i punonjësit të Policisë së Shtetit është në diskrecionin e administratës së policisë, që nuk i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor. Sipas gjykatës, kur konfirmohet qartësisht vullneti i organit publik për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kontrata e shërbimit publik quhet e zgjidhur, ndërsa paligjshmëria e shkakut të zgjidhjes së kontratës i jep mundësi kërkueses të mbrohet vetëm për zgjidhjen e pasojave, ndaj vazhdimi i marrëdhënies së punës nuk mund të diskutohet ligjërisht. Me këtë arsyetim, gjykata ka konstatuar se ligji nr. 9749/2007 ka parashikuar shprehimisht rastet e largimit nga detyra përpara përfundimit të mandatit të zëvendësdyrektorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, tek të cilat nuk përfshihet ristrukturimi i organikës. Për pasojë, gjykata ka arritur në përfundimin se zgjidhja e kontratës së shërbimit të kërkueses ishte bërë pa shkak ligjor dhe se asaj i takonte vetëm dëmshpërblimi me pagën mujore deri në datën 5.1.2016, kur i përfundonte mandati 4-vjeçar.

Gjithashtu, gjykata ka arsyetuar se kërkimi për t'u trajtuar me pagesë kalimtare pas datës 5.1.2016 ishte i pabazuar, pasi vullneti i punëdhënësit ishte për lirimin nga detyra dhe trajtimin e kërkueses me pagesë kalimtare, ndaj për këtë kërkim nuk kishte mosmarrëveshje. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesja, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1164, datë 1.4.2014, ka vendosur ndryshimin pjesërisht të vendimit, duke pranuar edhe kërkimin për anulimin e urdhrit nr. 652/2013, ndërsa pjesa tjetër e vendimit është lënë në fuqi. Në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit ka vlerësuar se marrëdhënia e punës së kërkueses trajtohet sipas ligjit të posaçëm nr. 9749/2007, ndaj urdhri i lirimit nga detyra ankimohet në gjykatë sipas nenit 78 të ligjit që parashikon të drejtën e punonjësit të policisë për t'iu drejtuar gjykatës me padi për anulimin e aktit, në rastet e parashikuara nga neni 57, pika 2, shkronja "b", i të njëjtit ligj. Sipas saj, vendimi unifikues nr. 31/2003 është shprehur se marrëdhënia e punës së punonjësit të Policisë së Shtetit është shërbim publik dhe ky lloj punonjësi ka të drejtën të kërkojë gjyqësisht anulimin e aktit që i ndërpret marrëdhënien e punës dhe dëmshpërblimin, ndonëse nuk rikthehet në vendin e mëparshëm. Me këtë arsyetim, Gjykata Administrative e Apelit ka pranuar kërkimin për anulimin e urdhrit të lirimit nga detyra të kërkueses, për shkak se ishte nxjerrë në kundërshtim me ligjin për të njëjtat shkaqe, për të cilat gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar paligjshmërinë e tij. Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kanë paraqitur rekurs kundër vendimit, ndërsa kërkuesja ka paraqitur kundërrekurs.

5. Vendimi është lënë në fuqi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili me vendimin nr. 00-2016-3211 (592), datë 20.12.2016, ka interpretuar ligjin nr. 9749/2007 lidhur me marrëdhënien e punës të zëvendësdyrektorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe rregullimin e pasojave të zgjidhjes së saj. Sipas Gjykatës së Lartë, lirimi dhe largimi (përfshirja) nga detyra i punonjësit të Policisë së Shtetit janë dy forma të ndryshme të ndërprerjes



së marrëdhënies së punës me Policinë e Shtetit. Lirimi nga detyra nuk jepet në kuadrin e një mase disiplinore, ndaj shoqërohet me shpërblim (pagesë suplementare dhe pagë kalimtare). Zëvendës drejtori i përgjithshëm, ashtu si edhe drejtori i Përgjithshëm, janë pozicione të nivelit të lartë, drejtues të Policisë së Shtetit, ndaj rregullimi i tyre është thelbësisht i ndryshëm në ligj nga pozicionet e tjera në këtë institucion. Me këtë arsyetim, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se, në kushtet kur neni 26 i ligjit nr. 9749/2007 nuk parashikon shprehimisht suprimimin e pozicionit dhe lirimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm, urdhri i lirimit të kërkuar nga detyra ishte në kundërshtim me ligjin, ndaj, me të drejtë, ishte anuluar nga Gjykata Administrative e Apelit. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, në ndryshim nga gjykatat e faktit, ka vlerësuar se në rastin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm, e drejta për rikthimin në detyrë gëzon mbrojtje ligjore, pasi në bazë të nenit 25, pika 2, të ligjit nr. 9749/2007, individ i kthehet në të njëjtin gradë që kishte përpara marrjes së detyrës, që do të thotë se marrëdhënia e punës së kërkuar nuk ishte me afat të caktuar 4-vjeçar. Mbi këtë bazë, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta duhet të kishin urdhëruar, krahas dëmshpërblimit me pagën deri në përfundim të mandatit 4-vjeçar, edhe sistemimin e kërkuar në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel dhe gradë. Megjithatë, duke konstatuar se kërkuarja nuk kishte paraqitur rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se nuk mund të vendoste rikthimin në punë të kërkuar.

6. Në datën 24.7.2014 kërkuarja i është drejtuar shërbimit përbarimor privat për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në datën 12.6.2015 përbaruesi gjyqësor ka njoftuar Degën e Thesarit Tiranë për vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e thesarit të debitorit Ministria e Brendshme për shumën e detyrimit 788.120 lekë. Ndërsa me njoftimin e datës 12.1.2016, ai ka vënë në dijeni debitorët, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrinë e Brendshme se edhe pse paga bruto e kreditorit ishte derdhur, ende nuk kishte një përgjigje për

masat e marra për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Për rrjedhojë, përbaruesi ka konstatuar mospërmbushjen e detyrimeve në zbatim të vendimit nr. 1164, datë 1.4.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit. Po kështu, sipas përbaruesit, duke qenë se nuk ka urdhër lirim për kërkuar, ajo duhet të trajtohet për anën financiare në mënyrë të njëjtë me zëvendës drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Për këto arsye, përbaruesi ka njoftuar debitorët të marrin masat e nevojshme për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

7. Në datën 23.11.2015 kërkuarja, me pretendimin se ligjërisht nuk ekziston një urdhër lirim për të dhe se mandati i përfundonte në datën 5.1.2016, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të pajisej zyrtarisht me urdhrin e lirimit nga detyra të zëvendës drejtores së përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe kryerjen e pagesës kalimtare për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

8. Me shkresën nr. 1718/4-A prot., datë 17.12.2015, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i është përgjigjur se kërkesa është në kundërshtim me urdhërimet e vendimeve gjyqësore nr. 223, datë 27.1.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 1164, datë 1.4.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas saj, në pjesën arsyetuese të vendimeve, gjykatat kanë pranuar zgjidhjen e kontratës së shërbimit publik pa shkak të ligjshëm, duke zgjidhur në këtë mënyrë edhe pasojat e aktit të lirimit, pra trajtimin me pagë mujore deri më 5.1.2016. Në kushtet kur kërkuarja është dëmshpërblyer financiarisht me pagën mujore deri më 5.1.2016 dhe kur akti administrativ që i njihte të drejtën e pagës kalimtare është shfuqizuar nga gjykata, sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kërkuarja nuk mund të përfitojë dy dëmshpërblime për të njëjtin fakt.

9. Kërkuarja i është drejtuar sërish Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për nxjerrjen e urdhrin për lirimin nga detyra, trajtimin me pagesë kalimtare, njohjen e periudhës 20.11.2013–5.1.2016 për efekt të pensionit të parakohshëm dhe



suplementar të pleqërisë sipas ligjit, si dhe kryerjen e pagesave të përcaktuara në urdhrat e përmbaruesit gjyqësor.

10. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 874 (80-2016-890), datë 29.2.2016, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se mosmarrëveshja përbënte gjë të gjykuar. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuësja.

11. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3604, datë 12.10.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të nxjerrë urdhrin e lirimit të kërkueses, trajtimin e saj me pagesë kalimtare sipas ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, njohjen e periudhës 20.11.2013–5.1.2016 për efekt të pensionit të parakohshëm dhe pensionit suplementar të pleqërisë, si dhe rrëzimin e kërtimeve të tjera të padisë. Në dhënien e këtij vendimi ajo është bazuar edhe në arsyetimin e vendimit nr. 00-2016-3211 (592), datë 20.12.2016, të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit gjyqësor për anulimin e urdhrin të lirimit nga detyra të kërkueses.

12. Mbi bazën e rekursit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1854 (240), datë 16.6.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi gjyqësor për anulimin e urdhrin të lirimit dhe zgjidhjen e pasojave të tij është i formës së prerë dhe ka efekte juridike me natyrë ekzekutuese për mosmarrëveshjen në proces, ndaj ajo përbën gjë të gjykuar.

13. Në datën 10.10.2022, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, si dhe të nenit 482, paragrafi 3, fjalia e parë, të Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, (*ligji nr. 49/2012*), që parashikojnë mënyrën e njoftimit për procesin në Gjykatën e Lartë.

14. Me vendimin e datës 24.11.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, si dhe thirrjen në këtë gjykim të palëve ndërgjyqëse, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe të Avokaturës së Shtetit, në cilësinë e subjekteve të interesuara. Në seancën plenare mbi bazë të dokumenteve të datës 6.4.2023, Gjykata, duke konsideruar se objekti i ankimit përfshin edhe kërkimin për shfuqizimin e akteve normative, në bazë të nenit 39, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8577/2000 vendosi thirrjen në cilësinë e subjektit të interesuar të Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave¹.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga aktet e kundërshtuara i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

15.1. *E drejta për t'u njoftuar*, pasi njoftimi me shpallje i listave të gjykimit dhe kohës së gjykimit prej sekretarisë së Gjykatës së Lartë, që parashikohet në nenet 482 të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 bie ndesh me nenet 17, 33 dhe 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Shpallja publike është masë procedurale *ultima ratio*, vetëm kur gjykata nuk arrin të njoftojë palët personalisht dhe pasi i ka shteruar të gjitha mjetet e mundshme të njoftimit. Kërkuësja nuk ka marrë dijeni për ditën, datën dhe orën e gjykimit, ndonëse ka dhënë adresën e saktë të banimit dhe numrin e telefonit celular. Njoftimi me shpallje, edhe pse mund të jetë efektiv për ecurinë e procesit, nuk mund të mbizotërojë ndaj së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe asaj për t'u dëgjuar përpara se të gjykohesh sipas nenit 33 të Kushtetutës. Gjykata e Lartë nuk ka respektuar as afatin ligjor 15-ditor të njoftimit, përderisa në dy rubrika të faqes zyrtare të saj ka të dhëna të ndryshme.

¹ Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi kundër thirrjes në gjykim të këtyre subjekteve të interesuara.



15.2. *E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi Gjykata e Lartë, duke mos e njoftuar personalisht kërkuesen, e ka lënë pa asnjë mundësi mbrojtjeje juridike, duke i mohuar të drejtën e ankimit ndaj mosveprimit administrativ.

15.3. *E drejta për t'u gjykuar brenda afatit të arsyeshëm*, pasi shqyrtimi i çështjes së kërkueses në Gjykatën e Lartë ka zgjatur pothuajse 4 vjet, duke tejkaluar afatin 90-ditor, të parashikuar nga neni 60, pika 2, të ligjit nr. 49/2012.

15.4. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor* i lidhur me parimin e sigurisë juridike, pasi Gjykata e Lartë ka gabuar kur e trajton çështjen si *res judicata*. Kërkimi për trajtimin me pagesë kalimtare dhe trajtimin suplementar për kërkuesen nuk është gjykuar asnjëherë nga ndonjë trup gjykues, ndaj nuk mund të konsiderohet gjë e gjykuar. Kërkesa për pagesën kalimtare nuk mund të gjykohej nga gjykata në vitin 2014, pasi mosmarrëveshja administrative lindi në datën 5.1.2016 pas përgjigjes negative të Policisë së Shtetit. Gjykata e Lartë e ka ndaluar arbitrarisht kërkuesen që të kërkojë pension shtetëror, duke i kufizuar të drejtat sociale që i njeh legjislacioni në fuqi, sipas neneve 49 dhe 52 të Kushtetutës.

16. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka prapësuar si vijon:

16.1. Kërkuesja nuk legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin e nenit 482, paragrafi 3, të KPC-së, pasi kjo normë nuk është e zbatueshme për mosmarrëveshjet gjyqësore administrative. Kërkuesja nuk ka paraqitur kundërrekurs dhe rikthimi i çështjes në Gjykatën e Lartë nuk i jep mundësinë e paraqitjes së pretendimeve shtesë, ndaj ajo nuk legjitimohet, pasi të drejtat e shkelura nuk mund të rivendosen. Po kështu, kërkuesja ka pranuar të njoftohet me anë të shpalljes, pasi nuk ka dhënë pëlqimin paraprak për njoftimin me postë elektronike.

16.2. Pretendimi se dispozitat ligjore të kundërshtuara janë në kundërshtim me Kushtetutën është haptazi i pabazuar, pasi *e drejta për proces të rregullt ligjor nuk cenohet*. Rregullat e ligjit nr. 49/2012 për njoftimin individual janë ndryshuar në vitin 2014 për të siguruar administrimin e mirë të proceseve gjyqësore dhe për të eliminuar vështirësitë praktike që haste Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Ligjvënësi ka synuar të shmangë tejzgjatjen e

procesit gjyqësor, për më tepër që njoftimet nuk kanë vlerë të veçantë, për shkak se palët ndërgjyqëse nuk ftohen të marrin pjesë në gjykim në dhomën e këshillimit. Mënyra e njoftimit të gjykimit administrativ është e njëjtë me ato të gjykimeve penale dhe civile.

17. **Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit**, kanë paraqitur të njëjtat argumente dhe, në mënyrë të përmblëdhur, kanë prapësuar si vijon:

17.1. Kërkuesja nuk legjitimohet për kundërshtimin e nenit 482, paragrafi 3, të KPC-së, pasi nuk provon se kjo dispozitë e cenon atë. Pretendimet mbi normat ligjore janë ngritur drejtpërdrejt në Gjykatë, ndaj kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Po kështu, kërkuesja nuk ka paraqitur argumente në nivel kushtetues për papajtueshmërinë e normave ligjore.

17.2. Pretendimet e kërkueses se normat ligjore të kundërshtuara cenojnë *të drejtën për proces të rregullt ligjor* në drejtim të aksesit në gjykatë janë të pabazuara. Kërkuesja ka qenë në dijeni të gjykimit në Gjykatën e Lartë, pasi asaj i është komunikuar rekursi i palës së paditur në procesin gjyqësor dhe sekretaria gjyqësore e asaj gjykate e ka njoftuar me shpallje për datën dhe orën e seancës, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Ligji parashikon njoftimin individual kur individi ka lënë të dhënat e kontaktit elektronik në shkallët e tjera të gjykimit. Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave, me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor dhe brenda afateve të arsyeshme.

17.3. Pretendimi për gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë *tej afatit të arsyeshëm* është i pabazuar, pasi zgjatja e afatit ka ardhur si rezultat i reformës në drejtësi.

17.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar. Në thelb, kërkuesja nuk ka ngritur çështje të kushtetutshmërisë, por kërkon në mënyrë indirekte t'i jepet zgjidhje pretendimeve të saj në lidhje me themelin e mosmarrëveshjes. Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat dhe tagrat ligjore të saj kur ka vlerësuar se çështja



ishte gjë e gjykuar, ndaj nuk ka cenuar parimin e sigurisë juridike.

18. **Subjekti i interesuar, Ministria e Brendshme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

18.1. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është i papajtueshëm me Kushtetutën, pasi janë zbatuar rregullat e reja ligjore për njoftimin e palëve dhe shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë në dhomën e këshillimit. Këto rregulla kanë rritur efikasitetin e njoftimit, duke mundësuar përshpejtimin e gjykimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye është i nevojshëm disiplinimi i palëve që të lënë adresën e tyre elektronike në momentin e depozitimit të rekursit, që ato të njoftohen po në rrugë elektronike.

18.2. Pretendimet e kërkuases për nxjerrjen e një urdhri të dytë nga Policia e Shtetit janë të pabazuara. Ajo nuk është as *de jure* dhe as *de facto* punonjëse efektive e Policisë së Shtetit që nga data e nxjerrjes së urdhrit të lirim nr. 652/2013 të ministrit të Brendshëm. Pretendimet e kërkuases janë të natyrës ligjore dhe nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues.

18.3. Kërkesja është dëgjuar dhe ka pasur një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Aksesit në gjykatë ka qenë substantiv dhe jo thjesht formal.

19. **Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**, ka prapësuar si vijon:

19.1. Mosnjoftimi individual i kërkuases nga Gjykata e Lartë nuk përbën shkelje të normave kushtetuese. Njoftimi konsiderohet i kryer me anë të shpalljes në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

19.2. Kërkimi për shfuqizimin e dispozitave ligjore përbën abuzim me të drejtat procedurale kushtetuese, pasi cenimi i interesit individual të pretenduar nga kërkesja ka ardhur si rrjedhojë e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë.

19.3. Pretendimet e kërkuases nuk janë kushtetuese. Ato kanë marrë zgjidhje përfundimtare nga Gjykata e Lartë. Kërkesja mund t'i drejtohet Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesat paraprake

20. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës me dy kërkesa paraprake, që lidhen me kohën e paraqitjes së prapësimeve nga subjekti i interesuar, Kuvendi, dhe me përmbajtjen e prapësimeve të subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave.

21. Në lidhje me kërkesën e parë, kërkesja ka pretenduar se subjekti i interesuar, Kuvendi, i ka paraqitur parashtrimet e tij në kundërshtim me afatin e caktuar nga Gjykata dhe nuk ka kërkuar zgjatje të tij, ndaj e drejta për të paraqitur prapësime ka rënë në dekadencë dhe çdo material i paraqitur prej Kuvendit përtej datës 5.5.2023 nuk duhet të merret në konsideratë dhe as të analizohet nga Gjykata.

22. Gjykata vëren se sipas nenit 38, pika 6, të ligjit nr. 8577/2001, kur seanca zhvillohet mbi bazë të dokumenteve, mosparaqitja brenda afatit të përcaktuar dhe pa shkaqe të përligjura e parashtrimeve nga kërkuesi dhe e prapësimeve nga subjekti/et i/e interesuara passjell zhvillimin e gjykimit vetëm mbi bazën e kërkesës dhe/ose dokumenteve shoqëruese të saj të paraqitura në momentin e regjistrimit. Neni 28, pika 5, i Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës përmban të njëjtin rregull, por duke shtuar se Gjykata vendos ndryshe në rast se prania ose dëgjimi i palëve në seancë plenare vlerësohet i rëndësishëm për nevojat e gjykimit të çështjes.

23. Duke analizuar këtë kuadër normativ, Gjykata thekson se rregulli për pasojën e mosrespektimit të afatit synon të disiplinojë sjelljen e palëve në funksion të efektivitetit të gjykimit kushtetues. Për këtë arsye, Gjykata kujdeset që afatet e caktuara të jenë të arsyeshme për palët, ndërsa këto të fundit kanë detyrimin jo vetëm të respektimit të tyre, por edhe të njoftojnë zyrtarisht nëse verifikohet ndonjë rrethanë e përligjur që i pengon t'i respektojnë ato.

24. Në çështjen konkrete, subjekti i interesuar, Kuvendi, është thirrur nga Gjykata për të marrë pjesë në gjykimin kushtetues, duke vlerësuar se ishte i rëndësishëm dëgjimi i tij, në cilësinë e organit që ka miratuar normat ligjore të



kundërshtuara. Ai është njoftuar me shkrim në datën 7.4.2023 për paraqitjen e prapësimeve me shkrim brenda datës 5.5.2023, të cilat ai i ka depozituar në datën 24.5.2023. Këto prapësime i janë njoftuar rregullisht dhe në kohën e duhur kërkuar, e cila ka paraqitur edhe kundërgjegjësi për to, jo vetëm për aspektin formal të afatit, por edhe për themelin e prapësimeve. Në këtë situatë, Gjykata, duke ritheksuar rëndësinë e respektimit të afateve të caktuara prej saj nga të gjitha palët në proces, si dhe duke vlerësuar në tërësi rrethanat konkrete, çmon se kjo kërkesë paraprake nuk duhet pranuar.

25. Në lidhje me kërkesën e dytë paraprake, kërkuarja në parashtrimet e datës 25.5.2023 ka pretenduar se ajo pjesë e prapësimeve të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që kundërshtohet ndaj procesit gjyqësor dhe vendimit të Gjykatës së Lartë, në të cilin ai nuk ka qenë palë ndërgjyqëse, nuk duhet të merren në konsideratë nga Gjykata.

26. Gjykata vë në dukje se me vendimin e saj të ndërmjetëm të datës 6.4.2023, bazuar në nenin 39, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8577/2000 është vendosur thirrja në cilësinë e subjekteve të interesuara të Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit, duke vlerësuar se kanë interes të drejtpërdrejtë në gjykimin kushtetues për kërkimin që lidhet me shfuqizimin e akteve normative, për shkak se në procesin ligjvënës ushtrojnë respektivisht kompetencat e propozimit dhe të miratimit të ligjeve. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se kërkesa paraprake e kërkuarjes është e bazuar, ndaj do të shqyrtojë vetëm atë pjesë të prapësimeve të Këshillit të Ministrave që lidhet me kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 482, paragrafi 3, fjalia e parë, të KPC-së dhe nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012.

B. Për legjitimitimin e kërkuarjes

27. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin

përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

28. Gjykata ka pohuar se bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual, krahas vendimit gjyqësor, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, nisur nga përmbajtja e normave kushtetuese dhe atyre ligjore, kërkuarja legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriteret: i. legjitimitimi *ratione personae*, në kuptimin që individ i provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; ii. shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individ i provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; iii. legjitimitimi *ratione temporis*, në kuptimin që individ ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; iv. dhe legjitimitimi *ratione materiae*, në kuptimin që individ i provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në çështjen konkrete, kërkuarja ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, në të cilin ajo ka qenë palë ndërgjyqëse, si dhe përmbajtjen e neneve 482, paragrafi 3, të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë, ajo ka pretenduar se është rrjedhojë e një procesi, për të cilin ajo nuk është njoftuar rregullisht dhe se Gjykata e Lartë, përmes mënyrës së interpretimit të ligjit dhe gjësë së gjykuar, i ka cenuar parimin e



sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për sa u takon dispozitave ligjore, kërkuesja ka pretenduar se ato nuk parashikojnë njoftimin individual, ndaj zbatimi i tyre i ka cenuar të drejtën për t'u njoftuar rregullisht, të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur në atë gjykatë.

30. Subjektet e interesuara Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit kanë prapësuar se kërkuesja *nuk legjitimohet* për të kërkuar shfuqizimin e nenit 482, paragrafi 3, të KPC-së, pasi kjo normë nuk është e zbatueshme për mosmarrëveshjet gjyqësore administrative.

31. Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kërkueses është me natyrë administrative, ndaj mënyra e njoftimit të palëve për gjykimin në Gjykatën e Lartë rregullohet nga ligji nr. 49/2012, dispozitat e të cilit plotësohen nga KPC-ja. Kështu, sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 *“Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara”*. Në të njëjtën linjë, fjalia e parë e nenit 482, paragrafi 3, i KPC-së parashikon se *“Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit”*, dhe më tej, po ky paragraf parashikon se njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se neni 482, paragrafi 3, i KPC-së dhe neni 61, pika 2, i ligjit nr. 49/2012, që kundërshtohen nga kërkuesja, nuk parashikojnë nxjerrjen e akteve nënligjore dhe zbatohen drejtpërdrejt nga Gjykata e Lartë në procesin që ajo zhvillon, duke përmblusur në këtë mënyrë kushtin e efektit të drejtpërdrejtë, që parashikohet nga neni 49, pika 3, shkronja “e”, i ligjit nr. 8577/2000. Ky kuadër ligjor është përdorur nga Gjykata e Lartë për të kryer njoftimin e kërkueses për çështjen e saj, duke shpallur në faqen zyrtare dhe në këndin e njoftimeve në ambientet fizike listën e gjytimeve për seancat gjyqësore, si dhe përbërjen e trupit gjykues, ku përfshihet edhe çështja e kërkueses.

32. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim

të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, ndaj prapësimet e subjekteve të interesuara Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit në këtë drejtim janë të pabazuara.

33. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi i mjeteve juridike përbën parakusht që duhet përmblusur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në çështjen konkrete, kërkuesja, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë. Sipas saj, ndonëse neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012 parashikon se gjykimi duhet të përfundojë brenda 90 ditëve, çështja e saj është shqyrtuar pothuajse për një periudhë prej 4 vjetësh, sepse është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 26.12.2018 dhe ka përfunduar në datën 16.6.2022. Ky pretendim i kërkueses është prapësuar nga subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, si i pabazuar, me argumentin se kohëzgjatja e gjykimit është rezultat i faktorëve objektivë të njohur dhe të pranuar nga jurisprudenca kushtetuese dhe se situata lidhet me gjendjen objektive të shkaktuar nga reforma në drejtësi.

35. Gjykata eidenton se me ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, hyrë në fuqi më 5.11.2017, është përcaktuar, ndër të tjera,



se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore për t'i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, të cilat sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate në parim janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në rastin në shqyrtim, kërkesja nuk rezulton t'i ketë përdorur mjetet ligjore të parashikuara nga *nenet 399/1* e vijues të KPC-së për të mbrojtur të drejtën kushtetuese të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Ajo e ka ngritur këtë pretendim për herë të parë në ankimin kushtetues dhe nuk ka paraqitur ndonjë argument se përse nuk e ka përdorur "kërkesën për përshpejtim drejtuar Gjykatës së Lartë", pra nëse ky mjet ka qenë joefektiv në rastin e saj. Për rrjedhojë, në lidhje me këtë pretendim, Gjykata çmon se kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të *nenit 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000*.

37. Ndërsa për pretendimet e tjera që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e të drejtave për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me parimin e sigurisë juridike, kërkesja ka parashtruar se pasoja antikushtetuese i ka ardhur gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, vendimi i së cilës mund të ankimohet vetëm në Gjykatën Kushtetuese. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se për këto pretendime plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi kërkesja nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion, përveç ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, është i pabazuar prapësimi i subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit, se kërkimi për kushtetutshmërinë e dispozitave ligjore duhet të ishte ngritur nga kërkesja më përpara në

gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë që Gjykata e Lartë të shprehej nëse ato paraqesin probleme kushtetutshmërie.

38. Gjykata çmon se kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi përfundimtar i Gjykatës së Lartë mban datën 16.6.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 10.10.2022, brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga *neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000*.

39. Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet *ratione materiae*, pasi: i. pretendimet për cenimin e të drejtave për t'u njoftuar, mbrojtur dhe dëgjuar; ii. dhe pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit në lidhje me parimin e sigurisë juridike garantohen nga *neni 42 i Kushtetutës*, ndaj hyjnë në kompetencën e Gjykatës, në kuptim të *nenit 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës*.

40. Për sa i takon grupit të parë të pretendimeve, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumenti kryesor i kërkeses lidhet me pamundësinë e saj për t'u dëgjuar dhe mbrojtur nga Gjykata e Lartë, do t'i shqyrtojë ato në këndvështrimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive. Çështja në shqyrtim lidhet me faktin nëse kërkesja, për shkak të mënyrës së njoftimit të parashikuar nga ligji dhe të zbatimit të tij në praktikë, është penguar të dëgjohet dhe mbrohet efektivisht në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur në disfavor të saj. Për pasojë, Gjykata duhet të analizojë nëse asaj i është kufizuar aksesit në atë masë që i ka cenuar thelbin e së drejtës së mbrojtjes. Pas shqyrtimit të këtij grupi pretendimesh, Gjykata do të analizojë edhe pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike për konceptin e gjësë së gjykuar.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive

41. Kërkesja pretendon se mënyra e njoftimit me shpallje, e parashikuar nga *nenet 482, paragrafi 3, të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012*, si dhe mosveprimi në kohën e mënyrën e duhur nga Gjykata e Lartë në lëshimin e njoftimeve, i ka cenuar të drejtat për t'u njoftuar rregullisht, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në Gjykatën e Lartë. Sipas saj, vërtet



njoftimi me shpallje mund të jetë një masë efektive për ecurinë e procesit, por nuk mund të mbizotërojë ndaj së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe së drejtës për t'u dëgjuar. Njoftimi me shpallje nuk mund të jetë rregull i vetëm, i menjëhershëm dhe i detyrueshëm njoftimi. Ajo ka pretenduar, gjithashtu, se Gjykata e Lartë, duke mos e njoftuar personalisht, e ka lënë pa asnjë mundësi mbrojtjeje juridike dhe i ka mohuar abuzivisht të drejtën e ankimit ndaj mosveprimit administrativ. Gjykata e Lartë nuk ka respektuar as afatin ligjor 15-ditor të njoftimit, përderisa në dy rubrika të faqes zyrtare të saj ka të dhëna të ndryshme. Sipas saj, duke mos marrë dijeni për ditën, datën dhe orën e gjykimit, kërkuësja nuk ka pasur mundësi të njihet me trupin gjykues, të parashtrojë kërkesa për përjashtim të gjyqtarëve të trupit gjykues dhe për numrin e anëtarëve të trupit gjykues që duhet të shqyrtonte çështjen, të paraqesë memo për zhvillimet më të fundit ligjore dhe jurisprudenciale, vendase dhe të huaja, të zbatueshme sipas objektit të mosmarrëveshjes.

42. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit kanë prapësuar se njoftimi me shpallje, që parashikon ligji, synon miradministrimin e proceseve gjyqësore administrative dhe nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë. Sipas tyre, ligji thjeshton procedurat, duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor dhe brenda afateve të arsyeshme.

43. Subjekti i interesuar, Ministria e Brendshme, ka prapësuar se për shkak të numrit të madh të çështjeve që presin për t'u gjykuar në Gjykatën e Lartë, njoftimi i palëve personalisht do të sillte kosto të pajustificuara dhe vonesa, ndaj palët duhen disiplinuar që të lënë adresat elektronike në momentin e depozitimit të rekursit, që të njoftohen elektronikisht. Edhe subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka prapësuar se pretendimi i kërkuësës është i pabazuar, pasi njoftimi për procesin në Gjykatën e Lartë konsiderohet i kryer në momentin e publikimit të tij në sistemin *online*.

44. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

Ndërsa në nenin 17 të saj gjendet parimi i përgjithshëm, që lejon kufizimin e të drejtave kushtetuese, me kusht që kufizimi të bëhet vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, si dhe të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Kufizimi nuk mund të cenojë thelbin e së drejtës, e, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

45. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'u drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 18, datë 31.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. E drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të janë të lidhura me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga njëra anë, kjo e drejtë u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 13, datë 20.2.2017; nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Gjykata ka pranuar në jurisprudencën e saj se e drejta e aksesit në gjykatë nuk është absolute dhe ajo mund të jetë objekt i kufizimeve, me kusht që të mos cenohet thelbi i së drejtës. Një kufizim nuk do të jetë në përputhje me Kushtetutën nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimin nr. 26, datë 27.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).



48. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive bazohen në faktin e parregullsisë së njoftimit për datën e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, si pasojë e dy shkaqeve: (i) përmbajtjes së normave ligjore të kundërshtuara; (ii) dhe mënyrës së zbatimit të rregullave nga administrata e Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Gjykata do t'i shqyrtojë ato, duke analizuar fillimisht kushtetutshmërinë e dispozitave ligjore, për të vijuar me vlerësimin kushtetues të mënyrës së zbatimit të tyre.

C.1.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive, për shkak të përmbajtjes së ligjit

49. Gjykata vëren se fjalia e parë e nenit 482, paragrafi 3, të KPC-së dhe nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 parashikojnë njoftimin me shpallje të palëve për procesin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë, duke mos u shprehur për njoftimin individual të tyre. Në këtë kuptim, njoftimi individual i palëve nuk është detyrim për Gjykatën e Lartë, përveçse kur ata kanë depozituar të dhënat elektronike, ndaj kjo mënyrë njoftimi ndërhyr në të drejtën e aksesit në gjykatë të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive. Për rrjedhojë, Gjykata do ta vlerësojë çështjen sipas kriterëve të nenit 17 të Kushtetutës, të cilat u japin përgjigje pyetjeve nëse kufizimi është bërë me ligj, nëse ekziston interesi publik dhe nëse ndërhyrja është në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

50. Për sa i takon kriterit “*kufizimi vetëm me ligj*”, Gjykata çmon se ai është përmbushur në rastin konkret. Kufizimi është bërë me dispozitat ligjore përkatëse të KPC-së dhe ligjit nr. 49/2012, të cilat janë miratuar nga Kuvendi, sipas procedurave të parashikuara për këtë qëllim.

51. Lidhur me kriterin e “*interesit publik*”, Gjykata në praktikën e vazhdueshme të saj, ka pohuar se ky koncept është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e aktit konkret që paraqitet për kontroll përpara saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyes publike që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Ato mund të renditen vetëm

negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese tashmë është pranuar se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Gjykata vëren se dispozitat ligjore të kundërshtuara në çështjen konkrete parashikojnë njoftimin e palëve për datën, orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara, nga sekretaria e Gjykatës së Lartë, nëpërmjet shpalljes në ambientet e gjykatës, në faqen elektronike zyrtare të internetit dhe kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara ose të njohura, sekretaria kryen njoftimin individual të palëve edhe në këto adresa. E njëjta mënyrë e njoftimit të palëve parashikohet edhe në procesin që zhvillohet në gjykatën e apelit (neni 49, pika 2, i ligjit nr. 49/2012). Kjo mënyrë njoftimi duket se ka lidhje me procedurat e shqyrtimit të akteve të ankimit në këto gjykata, të cilat, si rregull, zhvillohen në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve, por gjithnjë duke u dhënë mundësinë palëve që të njihen me apelin/rekursin e palës tjetër dhe të parashtrojnë prapësimet/argumentet e tyre. Zhvillimi i seancës publike është përjashtim nga rregulli dhe vendoset vetëm për shkaqe të përcaktuara në ligj.

53. Referuar *travaux préparatoires* të miratimit të akteve që kanë sjellë ndryshime në dispozitat ligjore të kundërshtuara dhe konkretisht relacionet shoqëruese të projektit të ligjit nr. 38/2017 dhe nr. 100/2014 (ky i fundit plotësuar edhe me ndryshimet me ligjin nr. 49/2021), Gjykata konstaton se synimi kryesor i ligjvënësit ka qenë rritja e efektivitetit të sistemit të drejtësisë dhe miradministrimi i proceseve gjyqësore administrative. Kështu, sipas akteve të miratimit të ligjeve, ekzistenca e detyrimit ligjor për të kryer njoftimin “njësoj si në shkallë të parë”, ka sjellë pamundësinë e Kolegjit Administrativ për të zhvilluar seancat e planifikuara për shkak se në datën e zhvillimit të gjykimit, palët ndërgjyqëse nuk kanë marrë njoftimin për arsye të ndryshme, duke përbërë një pengesë serioze në zhvillimin e gjykimeve sipas kalendarit të miratuar, çka e ka detyruar Kolegjin Administrativ të shtyjë seancën



gjyqësore në një datë tjetër. Me anë të njoftimit me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë dhe njëkohësisht edhe në faqen zyrtare po të kësaj gjykate, shmanget tejzgjatja e procesit gjyqësor, për më tepër që njoftimet nuk kanë vlerë të veçantë për shkak se palët ndërgjyqëse nuk ftohen të marrin pjesë në gjykim në dhomën e këshillimit. Në këto kushte, njoftimi në mënyrat e tjera që kryen Gjykata e Lartë për çështjet me natyrë penale e civile nuk sjell cenimin e së drejtës së palëve për një proces të rregullt ligjor (*shih faqet 4 – 5 të relacionit të ligjit nr. 100/2014*).

54. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se ligjvënësi në miratimin e dispozitave ligjore të kundërshtuara ka përcaktuar qartë synimin e tij për rritjen e efciencës në procesin gjyqësor që zhvillohet në Gjykatën e Lartë, duke pasur parasysh kompetencat e saj dhe natyrën e procedurave të gjykimit që ajo zhvillon. Kjo mënyrë njoftimi duket se ofron edhe shpejtësi në gjykim, që i përgjigjet situatës aktuale të sistemit të drejtësisë, që karakterizohet nga volumi i lartë i çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ndërhyrja e ligjvënësit në të drejtën e aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive, mbart interes publik.

55. Në lidhje me kriterin e “përpjesëtimin të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar”, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se bëhet fjalë për parimin e proporcionalitetit, në thelb të të cilit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre. Për vlerësimin e tij duhen mbajtur në konsideratë disa kërkesa: i. Nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii. nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii. nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar, sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme. Proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh që kriteret e mësipërme të mos analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën (*shih*

vendimet nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 11, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese).

56. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar se çështja e saj është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 26.12.2018 dhe është shqyrtuar në datën 16.6.2022, duke tejkaluar afatin 90-ditor të përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012. Sipas kërkueses, njoftimi me shpallje nënkupton se ajo duhet të kalonte te stenda e Gjykatës së Lartë çdo ditë përreth 4 vjet dhe të kërkonte çdo ditë në internet nëse çështja e saj është njoftuar me shpallje për gjykim ose jo. Kjo është një barrë shumë e rëndë dhe aspak proporcionale për kërkuesen, si dhe objektivisht e pamundur të realizohet praktikisht, veçanërisht kur fluksi i njoftimeve në Gjykatën e Lartë është me dhjetëra çdo ditë.

57. Gjykata çmon se dispozitat e kundërshtuara nga kërkuesja, që parashikojnë mënyrën e njoftimit me shpallje të palëve për datën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, lidhen në mënyrë të arsyeshme me objektivin e ligjvënësit për të siguruar efciencën e proceseve gjyqësore, përfshirë shpejtësinë e tyre. Kjo masë nuk duket se vendos ndonjë barrë të tepërt për individin, palë në procesin gjyqësor, duke qenë se detyrimi për publikimin e njoftimeve në faqen e internetit të gjykatës, përveç atij për shpalljen në ambientet fizike të saj, shoqërohet edhe me mundësinë e njoftimit individual, kur vetë individi depoziton të dhënat elektronike të kontaktit të tij. Lidhur me këtë të fundit, në kushtet e zhvillimit të sotëm shoqëror, ku individi ka qasje të lehtë në internet dhe mjete elektronike, Gjykata vlerëson se bëhet fjalë për mundësi reale në dispozicion të individit, i cili me vullnetin e tij të lirë zgjedh që, krahas shpalljes publike, të njoftohet edhe individualisht. Në këto rrethana, mënyrat e parashikuara nga ligji përbëjnë një mjet efektiv për qëllimin e synuar. Duke qenë një masë e arsyeshme dhe e përshtatshme, ajo nuk e shndërron kufizimin e së drejtës së aksesit të lidhur me atë të mbrojtjes efektive, në arbitrar, për sa kohë që nuk cenohet thelbi i saj.

58. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit i lidhur me të drejtën për mbrojtje



efektive, për shkak të përmbajtjes së neneve 482, paragrafi 3, fjalia e parë, të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, është i pabazuar.

C.1.2. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive, për shkak të mënyrës së zbatimit të ligjit

59. Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022. nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, duke ndjekur edhe qasjen e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrar ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se çështja e kërkuarës është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 26.12.2018 mbi bazën e rekursit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ndaj vendimit të gjykatës së apelit. Sipas dëftesës së komunikimit të lëshuar në datën 7.11.2018, rekursi i është komunikuar kërkuarës rregullisht në datën 9.11.2018, megjithatë ajo ka zgjedhur të mos paraqiste kundërrekurs. Gjykata e Lartë ka vendosur që shqyrtimi i çështjes të zhvillohej në dhomën e këshillimit në datën 15.6.2022.

61. Për të realizuar njoftimin e palëve, përfshirë atë të kërkuarës, 15 ditë përpara seancës, konkretisht në datën 31.5.2022, sekretaria e Gjykatës së Lartë ka kryer njoftimin

me shpallje në dy mënyra: i. në ambientet e Gjykatës së Lartë është shpallur lista e çështjeve që do të shqyrtoheshin në dhomën e këshillimit në datën 15.6.2022, si dhe përbërja e trupit gjykues, ku përfshihej edhe çështja e kërkuarës; ii. dhe njoftimi me listë çështjesh që tregonte kohën e gjykimit dhe përbërjen e trupit gjykues është publikuar edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Çështje të shpallura për gjykim”, për kategorinë “Çështje administrative”, nënrubrika “Për shqyrtim në dhomë këshillimi”.

62. Gjykata vëren më tej se, sipas të dhënave të sistemit elektronik, në rubrikën “Njoftime për publikum”, në datën 15.6.2022 është publikuar “Informacion për shtyrjen e çështjeve administrative të planifikuara për shqyrtim në dhomë këshillimi”, përmes të cilit është bërë njoftimi, se: “Të gjitha çështjet administrative të shpallura për shqyrtim në dhomë këshillimi, datë 15.6.2022, do të shtyben për në datën 16.6.2022”. Po në këtë rubrikë, në datën 16.6.2022 është publikuar “Informacion mbi çështjet administrative të datës 16.6.2022”, përmes të cilit është dhënë informacion edhe për përfundimin e çështjeve administrative për shqyrtim në dhomën e këshillimit në këtë datë, ku jepen të dhëna edhe për çështjen e kërkuarës. Sipas këtyre të dhënave, Gjykata e Lartë në çështjen e kërkuarës ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3604, datë 12.10.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 874 (80-2016-890), datë 29.2.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

63. Duke zbatuar standardet kushtetuese në kontekstin e fakteve të çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se sekretaria e Gjykatës së Lartë ka përmbushur detyrimet ligjore të shprehura në nenin 61 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenin 482, paragrafi 3, të KPC-së. Kjo mënyrë njoftimi nuk e ka vendosur kërkuarën në pozita të pafavorshme ose të ketë ndikuar në mohimin e së drejtës së aksesit, në kuptimin substancial të saj, pasi, nga njëra anë, Gjykata e Lartë e ka realizuar komunikimin e këtyre të dhënave nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve në ambientet fizike të saj, si dhe faqes elektronike zyrtare dhe, nga ana tjetër, rekursi i është njoftuar rregullisht asaj, duke i dhënë në këtë mënyrë mundësinë për t’u njohur dhe mbrojtur përkundër pretendimeve të palës tjetër ndërgjyqëse. Për rrjedhojë, në kushtet kur



Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale për njoftimin e palëve, procesi gjyqësor i zhvilluar prej saj nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur efektivisht.

64. Për sa i takon pretendimit të kërkuësës për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të mbrojtjes, për shkak se nuk është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, nuk është njohur me trupin gjykues dhe nuk ka mundur të parashtrojë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarëve të trupit gjykues nga gjykimi i çështjes së saj, në shtesë të konstatimeve për rregullsinë e njoftimit të kërkuësës, Gjykata vëren, gjithashtu, se vendimi i këshillit të Gjykatës së Lartë nr. 8/2022 që ka përcaktuar përbërjen e kolegjeve të asaj gjykate, gjendet i publikuar në faqen zyrtare elektronike në rubrikën “Gjykata - Organizimi juridik - Këshilli i Gjykatës - Vendime”. Në rastin konkret, çështja që i përket kërkuësës është shqyrtuar nga trupi gjykues i Kolegjit Administrativ dhe përbërja e këtij kolegji është publike dhe e aksesueshme, si nga palët, ashtu edhe nga çdo person tjetër i interesuar. Për më tepër, nuk rezulton që kërkuësja të ketë argumentuar në mënyrë konkrete nëse ka ndonjë rrethanë ose fakt për ndonjë prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjit Administrativ në veçanti, ndaj Gjykata çmon se ky pretendim për shkak të natyrës së përgjithshme dhe abstrakte është i pabazuar.

65. Lidhur me pretendimin e kërkuësës se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar personalisht, ndonëse ajo kishte dhënë numrin e saj të telefonit celular, Gjykata vëren se nenet 128–144 të KPC-së parashikojnë mënyrat e njoftimit të akteve, ndër të cilat neni 141 rregullon njoftimin elektronik. Po kështu, Gjykata vëren se bazuar në nenin 141 të KPC-së, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë ka nxjerrë urdhrin administrativ nr. 131, datë 2.7.2021, “Për publikimin e datave të gjykrimeve dhe njoftimin e palëve” (*urdhri administrativ nr. 131/2021*), në pikën 5 të të cilit parashikohet se kur sekretaria gjyqësore konstaton se palët kanë deklaruar si të dhënë kontakti adresën e postës elektronike (*e-mail*), duhet të bëjë edhe njoftimin elektronik për datën e gjykimit. Në vlerësimin e Gjykatës, njoftimi elektronik është një alternativë e re ligjore, përdorimi i së cilës duhet nxitur, pasi i përgjigjet

jo vetëm nevojës për shpejtësi në procedura, por edhe problematikave të shfaqura në jetën e përditshme nga lëvizjet demografike dhe sistemi ende i pakonsoliduar i adresave të qytetarëve.

66. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuësja ka depozituar vetëm numrin e telefonit celular, i cili nuk përfshihet në konceptin e të dhënës së kontaktit “adresë e postës elektronike”, referuar përmbajtjes së urdhrit administrativ nr. 131/2021 të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë. Në kushtet kur ajo nuk ka deklaruar në aktet drejtuar Gjykatës së Lartë adresën e postës elektronike të saj, atëherë Gjykata çmon se pretendimi i saj është i pabazuar.

67. Në përmbledhje të të gjitha argumenteve të mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive, për shkak të zbatimit të ligjit, është i pabazuar.

C.2. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

68. Kërkuësja ka pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike, pasi gjykatat kanë gabuar si në kuptimin e kërkesës, ashtu edhe në arsyetimin e rrëzimit të saj, duke e interpretuar në kundërshtim me ligjin objektin e padisë si “kërkesë për të nxjerrë një urdhrë të dytë lirimi”. Sipas saj, duhet të ketë domosdoshmërisht një akt administrativ të lirit të saj nga radhët e Policisë së Shtetit dhe mbarimi i mandatit nuk duhet të interpretohet si përfundim ekstraligjor i marrëdhënies së karrierës në Policinë e Shtetit. Gjithashtu, ajo pretendon se gjykata gabon kur e trajton këtë çështje si *res judicata*, pasi çështja e trajtimit me pagesë kalimtare dhe trajtimi suplementar përbën një mosmarrëveshje gjyqësore dhe nuk përbën mosmarrëveshje administrative. Në kundërshtim me këtë parim, Gjykata e Lartë e ka ndaluar arbitrarisht kërkuësen që të kërkojë pension shtetëror, duke i kufizuar të drejtat sociale që i njeh legjislacioni në fuqi, sipas neneve 49 dhe 52 të Kushtetutës.

69. Sipas subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, ky pretendim i kërkuësës nuk ka natyrë kushtetuese, pasi në mënyrë indirekte synon t'u jepet zgjidhje pretendimeve që lidhen me themelin e mosmarrëveshjes gjyqësore. Gjykata e



Lartë ka vlerësuar drejt se gjendej përpara një vendimi të formës së prerë dhe përfundimtar, i cili e kishte zgjidhur përfundimisht mosmarrëveshjen e lindur midis palëve nga urdhri nr. 652/2013, duke u dhënë përgjigje kërtimeve dhe pretendimeve të tyre në proces. Kërkimet e reja të pretenduara si pasojë e këtij konflikti gjyqësor do të duhej të ngriheshin nëpërmjet mjeteve ligjore të ankimit dhe rekursit dhe jo me një padi të re. Kërkuesja mund të mbrohej në Gjykatën e Lartë duke paraqitur kundërekurs, mjet të cilin ajo nuk e ka ushtruar dhe, për më tepër, nuk ka dhënë asnjë argument se përse nuk e ka ushtruar.

70. Subjekti i interesuar, Ministria e Brendshme, ka prapësuar se pretendimet e kërkuar për nxjerrjen e një urdhri të dytë nuk janë të bazuara, pasi ajo aktualisht nuk është as *de jure* dhe as *de facto* punonjëse efektive e Policisë së Shtetit që nga data e nxjerrjes së urdhrit të lirimimit nr. 652/2013 të ministrit të Brendshëm. Pretendimet e kërkuar janë të natyrës ligjore dhe nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues. Kërkuesja është dëgjuar dhe ka pasur një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

71. Edhe subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka prapësuar se pretendimet e ngritura nga kërkuarja nuk përbëjnë shkelje të normave kushtetuese, por janë pretendime që kanë marrë zgjidhje përfundimtare nga Gjykata e Lartë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka analizuar drejt shkaqet e ngritjes së padisë, duke konkluduar se në rastin konkret jemi para “*gjësë së gjykuar*”. Pretendimet e kërkuar nuk janë të natyrës kushtetuese dhe ajo mund t’i drejtohet Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

72. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë, funksioni i të cilit është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Gjykata e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve kushtetuese,

pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 18, datë 30.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

73. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar lidhjen që siguria juridike ka me të drejtën kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në të cilën ky parim, përgjithësisht, shfaqet në formën e gjësë së gjykuar. Mosrespektimi i gjësë së gjykuar shkakton cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra cenon vetë sigurinë juridike. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, atëherë asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 17, datë 30.3.2021; nr. 50, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

74. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, kërkuarja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar shfuqizimin e urdhrit nr. 652/2013, detyrimin e palës së paditur ta dëmshpërblejë me pagën që do të përfitonte deri në plotësimin e mandatis 4-vjeçar të zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si edhe detyrimin e palës së paditur që në datën 5.1.2016, që përkon me përfundimin e këtij mandati, ta trajtojë sipas nenit 25, pika 2, të ligjit nr. 9749/2007. Me vendimin gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit është vendosur anulimi i urdhrit nr. 652/2013 dhe detyrimi i palës së paditur, Ministrisë së Brendshme, të dëmshpërblejë kërkuarën me pagën mujore deri në datën 5.1.2016, kur i mbaron mandati i saj 4-vjeçar si zëvendës drejtorë e përgjithshme e Policisë së Shtetit. Ky vendim është vënë në ekzekutim nga kërkuarja nëpërmjet shërbimit përmbarimor privat.

75. Kërkuarja, duke pretenduar se mandati i qëndrimit në detyrë ishte deri në datën 5.1.2016 dhe se ligjërisht nuk ekziston asnjë urdhër lirimimi për të, ka kërkuar nxjerrjen e një urdhri të tillë, si dhe kryerjen e pagesës kalimtare për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me



Policinë e Shtetit. Për shkak të refuzimit të kërkesës së saj nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kërkesja ka paraqitur një padi tjetër në gjykatë, duke kërkuar detyrimin e palëve të paditura, Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit, të nxjerrin urdhrin për nxjerrjen në lirim të saj, të trajtojnë kërkesën me pagesë kalimtare, të kryejnë pagesat e përcaktuara në urdhrat e përmbaruesit gjyqësor, si edhe t'i njohin periudhën 20.11.2013–5.1.2016 për efekt të pensionit të parakohshëm të pleqërisë, sipas legjislacionit përkatës.

76. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 874 (80-2016-890), datë 29.2.2016 ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se në procesin e mëparshëm gjyqësor, Gjykata Administrative e Apelit kishte shfuqizuar urdhrin nr. 652/2013 të lirimimit të kërkeses nga detyra, ndaj nuk kishte hapësirë diskutimi për një tjetër disponim me urdhër lirimi me shkak të ligjshëm. Sipas gjykatës, kur urdhri i lirimimit është shfuqizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, pretendimi që të disponohet me një urdhër të dytë lirimi, për të njëjtin fakt të gjykuar (lirim për të njëjtin motivacion, pasi nuk ka ndonjë rrethanë tjetër të verifikuar që të impononte lirim), do të binte në kundërshtim me efektet ekzekutive të vendimit gjyqësor. Po kështu, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se kërkitimi për të përfituar pagesë kalimtare, sipas nenit 12 të ligjit nr. 10142/2009, përbën *res judicata*, pasi ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe për të është disponuar me vendim të formës së prerë.

77. Vendimi është ndryshuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila me vendimin nr. 3604, datë 12.10.2018, ka pranuar kërkimet e padisë së kërkeses, që lidheshin me nxjerrjen e urdhrin të lirimimit nga detyra, trajtimin me pagesë kalimtare dhe njohjen e periudhës për efekte të pensionit të parakohshëm, si dhe atij suplementar të pleqërisë.

78. Mbi bazën e rekursit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1854 (240), datë 16.6.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ajo ka arsyetuar se

mosmarrëveshja e palëve e krijuar nga urdhri nr. 652/2013 ishte zgjidhur me vendim të formës së prerë dhe përfundimtar, ndaj kërkimet e reja për këtë mosmarrëveshje duhej të ishin ngritur nëpërmjet mjeteve ligjore të ankimit dhe rekursit dhe jo me një padi të re, siç ka vepruar kërkesja (*shih paragrafin 23 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

79. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë alogjik ose të ketë kundërtënie dhe pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke plotësuar kështu kërkesat kushtetuese që kërkon standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor. E drejta e kërkeses për pagesë kalimtare ka qenë objekt i gjykimit të parë që zgjidhi mosmarrëveshjen gjyqësore për urdhrin e lirimimit. Në atë gjykim, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit anuluan urdhrin e lirimimit, por rrëzuan kërkimet për pagesën kalimtare dhe trajtimin suplementar të kërkeses, ndërsa ajo nuk paraqiti rekurs për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Gjithashtu, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë në gjykimin e parë, duke lënë në fuqi vendimin për anulimin e urdhrin të lirimimit, ka pranuar se ndërprerja e marrëdhënieve të punës së kërkeses me Policinë e Shtetit ishte e paligjshme, duke arsyetuar se, si pasojë, kërkeses i lindnin të drejtat e dëmshpërblimit financiar dhe të rikthimit në detyrë. Kjo e drejtë e fundit nuk u rivendos për kërkesën për shkak se ajo nuk kishte paraqitur rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Në këtë mënyrë, marrëdhënia e saj e punësimit nuk u rivendos as *de jure* dhe as *de facto*, që më pas të ndërpritej me shkak të ligjshëm me urdhër lirimi nga detyra, siç pretendon kërkesja, që të siguronte më pas përfitimet financiare të njohura nga ligji. Në këto rrethana, interpretimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për nxjerrjen e përfundimit se kërkitimi për të drejtën e pagesës kalimtare ishte gjë e gjykuar, nuk rezulton të ketë qenë i padrejtë dhe të ketë ndikuar në të drejtën kushtetuese të kërkeses për të pasur një proces të rregullt ligjor, në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se edhe pretendimi i kërkeses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor i lidhur me parimin e sigurisë juridike është i pakabazuar.



80. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 12.6.2023.

Shpallur më 12.7.2023.

Kryetar: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtarë kundër: Marsida Xhaferllari

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 24 (A) 2022, që i përket kërkuases Anila Hoxha, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 240, datë 16.6.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe parashikimeve të nenit 482, paragrafi 3, të KPC-së, si dhe nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, si të papajtueshme me Kushtetutën, edhe pse bashkohemi me shumicën për zgjidhjen e kësaj çështjeje, kemi qëndrim të ndryshëm për disa nga shkaqet mbi të cilat është arritur në këtë përfundim. Më konkretisht, në vlerësimin tonë, vetëm në lidhje me atë pjesë të objektit të kërkesës që ka të bëjë me shfuqizimin e dispozitave, mbajmë qëndrimin se vlerësimi i Gjykatës duhej të ishte ndalur në çështjen e legjitimitetit të kërkuases, pa vijuar më tej me bazueshmërinë në themel të pretendimeve të saj.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuessa ka ngritur padi në gjykatë, me objekt shfuqizimin e urdhrit nr. 652/2013 të ministrit të Brendshëm dhe detyrimin e Ministrisë së Brendshme, si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për dëmshpërblim me pagën që do të përfitonte deri në plotësimin e mandatit 4-vjeçar si zëvendësdyrektore e përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe trajtimin në përputhje me pikën 2 të nenit 25 të ligjit nr. 9749/2007, deri në datën e përfundimit të mandatit, me pretendimin se lirimi i saj nga detyra ishte bërë në kundërshtim me ligjin, në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara. Kjo padi është pranuar pjesërisht nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. 223, datë 27.1.2014, ka vendosur detyrimin e Ministrisë së Brendshme ta dëmshpërblejë kërkuessen me pagën mujore deri në datën 5.1.2016, duke rrëzuar kërkimet e tjera. Vendimi është ndryshuar pjesërisht nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila, me vendimin nr. 1164, datë 1.4.2014, ka vendosur të pranojë edhe kërkimin për anulimin e urdhrit nr. 652/2013. Mbi bazën e rekursit të paraqitur nga palët e paditura dhe kundërrkursin e paraqitur nga kërkuessa, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-3211 (592), datë 20.12.2016, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit. Edhe pse ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta duhet të kishin urdhëruar, krahas dëmshpërblimit me pagën deri në përfundim të mandatit 4-vjeçar, edhe sistemimin e kërkuesses në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel dhe gradë, duke konstatuar se ajo nuk kishte paraqitur rekurs, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se nuk mund të vendoste rikthimin në punë të kërkuesses.

3. Në vijim, kërkuessa ka inicuar një proces tjetër (procesi objekt kërkesë) për detyrimin e Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për nxjerrjen e urdhrit për lirimin nga detyra, trajtimin me pagesë kalimtare, njohjen e periudhës 20.11.2013 - 5.1.2016 për efekt të pensionit të parakohshëm dhe pensionit suplementar të pleqërisë sipas ligjit, si dhe kryerjen e pagesave të përcaktuara në urdhrat e përmbartuesit gjyqësor. Me vendimin nr. 874 (80-2016-890), datë 29.2.2016, Gjykata



Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se mosmarrëveshja përbënte gjë të gjykuar, vendim që është ndryshuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila, me vendimin nr. 3604, datë 12.10.2018, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë, duke e detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të nxjerrë urdhrin e lirit të kërkuësës, trajtimin e saj me pagesë kalimtare sipas ligjit nr. 108/2014, njohjen e periudhës 20.11.2013–5.1.2016 për efekt të pensionit të parakohshëm dhe pensionit suplementar të pleqërisë. Në lidhje me pjesën tjetër të kërtimeve është vendosur rrëzimi i tyre.

4. Mbi bazën e rekursit të palës së paditur në proces, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1854 (240), datë 16.6.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se vendimi gjyqësor për anulimin e urdhrit të lirit dhe zgjidhjen e pasojave të tij është i formës së prerë dhe ka efekte juridike me natyrë ekzekutuese për mosmarrëveshjen në proces, ndaj ajo përbën gjë të gjykuar.

5. Pasi është njohur me këtë vendim kërkuësja ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar jo vetëm vendimin e Gjykatës së Lartë, por edhe përmbajtjen e nenit 482, pika 3, të KPC-së, që parashikon se “*Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit*”, dhe nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 që parashikon se “*Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara*”. Në mbështetje të këtij kërkitimi ajo ka pretenduar se këto dispozita ligjore nuk parashikojnë njoftimin individual të palëve dhe zbatimin e tyre i ka cenuar të drejtën për t’u njoftuar rregullisht, të drejtën për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur në Gjykatën e Lartë.

6. Në lidhje me legjitimitimin e kërkuësës për kundërshtimin e dispozitave ligjore, shumica ka vlerësuar se procesi gjyqësor i kërkuësës është me natyrë administrative, ndaj mënyra e njoftimit të palëve për gjykimin në Gjykatën e Lartë rregullohet nga ligji nr. 49/2012, dispozita të cilat plotësohen nga KPC-ja. Kështu, sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, “*Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit,*

si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara”. Në të njëjtën linjë, fjalia e parë e nenit 482, paragrafi 3, i KPC-së parashikon se “*Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit*” dhe më tej, po ky paragraf parashikon se njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual, kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjyimit. Në këtë drejtim, shumica ka vlerësuar se neni 482, paragrafi 3 i KPC-së dhe neni 61, pika 2, i ligjit nr. 49/2012, që kundërshtohen nga kërkuësja, nuk parashikojnë nxjerrjen e akteve nënligjore dhe zbatohen drejtpërdrejt nga Gjykata e Lartë në procesin që ajo zhvillon, duke përmbushur në këtë mënyrë kushtin e efektit të drejtpërdrejtë, që parashikohet nga neni 49, pika 3, shkronja “e”, i ligjit nr. 8577/2000. Ky kuadër ligjor është përdorur nga Gjykata e Lartë për të kryer njoftimin e kërkuësës për çështjen e saj, duke shpallur në faqen zyrtare dhe në këndin e njoftimeve në ambientet fizike listën e gjykimeve për seancat gjyqësore, si dhe përbërjen e trupit gjykues, ku përfshihet edhe çështja e kërkuësës. Për rrjedhojë, kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar (*shih paragrafët 31-32 të vendimit*).

7. Në lidhje me këtë qëndrim ne ndahemi nga shumica, pasi vlerësojmë se kërkuësja legjitimohet *ratione personae* vetëm për kundërshtimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Ndërsa, për sa i përket kërkitimit për shfuqizimin e dispozitave ligjore të KPC-së dhe ligjit nr. 49/2012, për mënyrën e njoftimit me shpallje në ambientet fizike të Gjykatës së Lartë, në kushtet kur ajo ka dhënë adresën e saktë të banimit dhe numrin e telefonit, çmujmë se ajo nuk legjitimohet *ratione personae*.



8. Në vlerësimin tonë, pretendimet e kërkuases nuk janë ngritur në nivel kushtetues, duke mos arritur të provoje cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, për shkak të përmbajtjes së këtyre parashikimeve ligjore dhe mënyrës se si ato kanë përcaktuar njoftimin e palëve për procesin gjyqësor që zhvillohet në Gjykatën e Lartë. Në kuptim të parashikimeve të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 49, pika 3, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577/2000, kërkuesi duhet të provoje se *cenimi i të drejtave themelore është real dhe jo hipotetik*. Në mënyrë që të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje kërkuesi duhet të provoje se është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga masa e kundërshtuar dhe, në këtë kuptim, në rastin konkret, kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë cenimin e të drejtave të saj të garantuara kushtetutshmërisht nga përmbajtja e normave të kundërshtuara, pra se parashikimi i tyre për mënyrën se si procedon Gjykata e Lartë për njoftimin për datën e zhvillimit të gjykimit cenon thelbin e së drejtës së saj për t’u njoftuar dhe për t’u dëgjuar.

9. Gjykata ka një jurisprudencë të konsoliduar për mbrojtjen e garancive të procesit të rregullt ligjor në drejtim të njoftimit dhe pjesëmarrjes në proces të palëve ndërgjyqëse, duke verifikuar për këtë qëllim rregullsinë e procedurave të njoftimit të ndjekura nga Gjykata e Lartë. Në një numër të konsiderueshëm rastesh të ankimeve kushtetuese individuale, që kanë pasur në objektin e tyre këtë pretendim, Gjykata, pavarësisht nëse çështja është shqyrtuar në seancë publike ose mbi bazë të dokumenteve, nga pikëpamja faktike ka verifikuar, rast pas rasti, nëse njoftimi është realizuar në mënyrat e domosdoshme të përcaktuara nga ligji – me anë të shpalljes në ambientet fizike dhe shpalljes në faqen elektronike. Kur është konstatuar se njoftimi për datën e zhvillimit të seancës në Gjykatën e Lartë nuk ka qenë i shpallur në faqen e saj elektronike, Gjykata e ka pranuar pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, duke argumentuar se sekretaria e Gjykatës së Lartë ka detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazë të dokumenteve, me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve, me qëllim garantimin e së drejtës së

mbrojtjes, barazisë së armëve në gjykim dhe kontradiktoritetit (*shih vendimet nr. 20, datë 22.9.2022; nr. 17, datë 1.3.2017; nr. 76, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Madje, Gjykata ka pohuar se njoftimi i datës dhe orës së gjykimit është një akt i domosdoshëm procedural, që merr rëndësi për më tepër në rastin kur Gjykata e Lartë ka ndryshuar dy vendimet e gjykatave më të ulëta dhe ka rrëzuar padinë e kërkuarit. Në këtë rast, moskomunikimi i zhvillimit të seancës nga ana e administratës gjyqësore, në përputhje me rregullat procedurale për zhvillimin e gjykimit administrativ, sjell mospërfitimin e garancive ligjore të kërkuases për njohjen në kohë të pretendimeve të palës tjetër dhe kundërshtimin e tyre nëpërmjet paraqitjes së argumenteve, kjo me qëllim shmangien e vënies në një pozitë të pafavorshme në raport me atë palë (*shih vendimin nr. 65, datë 7.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret nuk jemi përpara mungesës së njoftimit, pasi ai është realizuar nga Gjykata e Lartë, bazuar pikërisht në parashikimin e dispozitave të kundërshtuara, si në faqen elektronike zyrtare të Gjykatës së Lartë, ashtu edhe në këndin e njoftimeve në ambientet fizike të saj, pra me afishim, duke plotësuar në këtë mënyrë kërkesat ligjore për këtë qëllim.

11. Për sa më sipër, nuk pajtohemi me argumentin e shumicës, që ka shërbyer për legjitimimin e kërkuases për këtë kërkim të ankimit kushtetues individual. Rëndësia e njoftimit të palëve për zhvillimin e gjykimit, përfshirë atë të Gjykatës së Lartë, dhe forcimi i garancive për realizimin e njoftimit efektiv, janë përkrahur edhe nga zhvillimet legjislativë dhe praktika e punës së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në vitin 2012 ligji për organizimin e gjykatave administrative e, më tej, ndryshimet në KPC, në vitin 2017, kanë parashikuar përdorimin e mjeteve elektronike gjatë procesit, ku, krahas njoftimit me shpallje në ambientet fizike, realizohet edhe njoftimi në faqen elektronike të gjykatës, si dhe njoftimi individual i drejtpërdrejtë, në rastin kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit. Këto rregulla kanë rritur efikasitetin e njoftimit, duke mundësuar si thjeshtimin e procedurave, ashtu edhe përsheptimin e gjykimit të çështjeve. Në të njëjtën linjë, Gjykata e Lartë, me urdhrin e datës



2.7.2021, ka përcaktuar detyrimin e sekretarisë gjyqësore që, përveç afishimit në këndin e njoftimit dhe shpalljes në faqen elektronike, të kryejë edhe njoftimin elektronik në adresat e postës elektronike të palëve. Në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se kjo mënyrë njoftimi nëpërmjet përdorimit të mjeteve elektronike i përgjigjet zhvillimit aktual shoqëror dhe se krijon mundësi komunikimi dhe aksesit në kohë reale dhe të garantuar.

12. Në këtë kontekst, vlerësojmë se kërkuësja nuk ka arritur të provojë në nivel kushtetues se mënyra e njoftimit që parashikojnë dispozitat e kundërshtuara, nëpërmjet shpalljes në ambientet fizike të Gjykatës së Lartë dhe faqen elektronike, nuk arrin të sigurojë njoftimin e duhur të palëve në proces dhe se nuk garanton marrjen e tyre dijeni për procesin. Ajo nuk ka arritur të provojë, gjithashtu, se kjo mënyrë njoftimi krijon pengesa të tilla që çojnë në mohimin e të drejtave të palëve në proces.

13. Në përfundim, vlerësojmë se, për sa kohë që kërkuësja nuk ka arritur të provojë se në çfarë mënyre është cenuar në të drejtën e saj kushtetuese për proces të rregullt ligjor, duhej të ishte vendosur mungesa e legjitimitetit *ratione personae* për këtë kërkim të objektit të ankimit kushtetues individual.

Kryetar: Holta Zaçaj

Anëtarë: Genti Ibrahim, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuësës Anila Hoxha, me objekt: *“Shfuqizimi i vendimit nr. 240, datë 16.6.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i fjalisë ‘Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit’, në nenin 482, paragrafi 3, të Kodit të Procedurës Civile, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i fjalisë ‘Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara’, në nenin 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, ‘Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, të ndryshuar, si e papajtueshme me Kushtetutën e*

Republikës së Shqipërisë”, jam kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësoj që ajo duhej të ishte pranuar për shkak se të paktën një prej pretendimeve të kërkuësës ishte i bazuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Në rastin konkret, çështja e kërkuësës, e cila kishte në objekt të drejtat nga marrëdhënia e punësimit të zgjidhur në mënyrë të paligjshme, ishte regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 26.12.2018, bazuar në rekursin e paraqitur nga pala kundërshtare e saj, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Në aktet drejtuar gjykatës kërkuësja kishte depozituar numrin e saj të telefonit celular, ndërsa nuk kishte paraqitur adresën e postës elektronike. Çështja e kërkuësës është vënë në lëvizje në Gjykatën e Lartë pas 3 vjetësh e 6 muaj, kur relatori i çështjes, me vendimin e datës 24.5.2022, ka caktuar datën 15.6.2022 për shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar njëkohësisht edhe sekretarinë gjyqësore të kryente njoftimin e palëve. Sekretaria gjyqësore ka proceduar sipas neneve 482, pika 3, të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, që kundërshtohen nga kërkuësja, duke afishuar aktin e njoftimit në ambientet fizike të Gjykatës së Lartë në datën 31.5.2022, si dhe duke e publikuar atë edhe në faqen zyrtare, në rubrikën *“Çështje të shpallura për gjykim”*, për kategorinë *“Çështje administrative”*, nën rubrika *“Për shqyrtim në dhomë këshillimi”*. Në dosjen e Gjykatës së Lartë është administruar njoftimi se shqyrtimi i çështjeve të shpallura për gjykim në datën 15.6.2022, në dhomën e këshillimit, shtyhet për datën 16.6.2022. I njëjti njoftim është publikuar edhe në faqen zyrtare, në rubrikën *“Njoftime për publikun”*, në datën 15.6.2022, me emërtimin *“Informacion për shtyrjen e çështjeve administrative të planifikuara për shqyrtim në dhomë këshillimi”* përmes të cilit njoftohet se: *“Të gjitha çështjet administrative të shpallura për shqyrtim në dhomë këshillimi, datë 15.6.2022, do të shtyhen për në datën 16.6.2022.”* Në procesverbalin e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, që mban datën 16.6.2022, ora 09:20, është shënuar se palët



ndërgjyqëse kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit nëpërmjet shpalljes së datës 31.5.2022 dhe nuk rezulton të kenë paraqitur ndonjë kërkesë procedurale për përjashtimin e trupit gjykues. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vendosur në disfavor të kërkuësës, duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

3. Mbi këto fakte, kërkuësja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të të drejtave për t'u njoftuar, mbrojtur dhe dëgjuar - të analizuar në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive, si dhe të standardit të arsytimit të vendimit në lidhje me parimin e sigurisë juridike për konceptin e gjësë së gjykuar, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

4. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive, për shkak të mënyrës së zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, shumica ka vlerësuar se është i pabazuar (*shih paragrafin 67 të vendimit*). Sipas saj, Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale për njoftimin e palëve me anë të shpalljes në këndin e njoftimeve në ambientet fizike të saj, si dhe në faqen elektronike zyrtare, ndaj kërkuësja është njoftuar rregullisht dhe i është dhënë mundësia për t'u mbrojtur. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, shumica ka mbajtur në konsideratë edhe disa faktorë: i. kërkuësja kishte marrë njoftim individual për rekursin, në kuptimin që ishte njohur me pretendimet e palës kundërshtare; ii. përbërja e Kolegjit të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar çështjen e kërkuësës është publike dhe e aksesueshme në faqen zyrtare elektronike, ndërsa ajo nuk ka parashtruar ndonjë rrethanë konkrete në drejtim të paanësisë së anëtarëve të trupit gjykues; iii. dhe numri i telefonit celular, që ishte depozituar nga kërkuësja në aktet drejtuar gjykatës, nuk përfshihet në konceptin e të dhënës së kontaktit “adresë e postës elektronike”, referuar përmbajtjes së urdhrit administrativ nr. 131/2021 (*shih paragrafet 63, 64 dhe 66 të vendimit*).

5. Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës, sidomos me vlerësimin që ajo i ka bërë konceptit të mjetit elektronik të njoftimit, duke përjashtuar prej tij telefonin celular. Njoftimi i individit për procesin gjyqësor nuk duhet të

konceptohet dhe as të zbatohet si një detyrim për përmbushjen e përciptë të rregullave procedurale, sepse siç pranon shumica, nëse individ i nuk njoftohet, ai detyrimisht gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih paragrafin 46 të vendimit*). Për këtë arsye, çmoj se është detyrë kushtetuese e gjykatave të kujdesen për efektivitetin e akteve të njoftimit, në përputhje me parimin e përgjithshëm të sanksionuar nga neni 15, pika 2, i Kushtetutës, sipas të cilit organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Ky detyrim, në rastin e procesit të rregullt ligjor, ka lidhje edhe me dinjitetin njerëzor, që, sipas nenit 3 të Kushtetutës, përbën vlerë themelore të rendit tonë juridik. Në këtë kuptim, e drejta për proces të rregullt ligjor përbën kusht *sine qua non* për respektimin e dinjitetit njerëzor, sepse i jep mundësinë individit të dëgjohet, të ketë gjykim të drejtë dhe të riparojë të drejtat dhe interesat që eventualisht i janë shkelur.

6. Nën këtë perspektivë, pretendimi i kërkuësës se Gjykata e Lartë, me mënyrën se si i ka zbatuar normat ligjore për njoftimin e kërkuësës është i bazuar për dy arsye kryesore.

7. *Së pari*, Gjykata kur ka analizuar pretendimin tjetër të kërkuësës për pajtueshmërinë e me Kushtetutën të normave ligjore, ka arritur në përfundimit se kufizimi është proporcional (*shih paragrafin 57 të vendimit*), duke arsyetuar se “*njoftimi me shpallje shoqërohet edhe me mundësinë e njoftimit individual, kur vetë individ i depoziton të dhënat elektronike të kontaktit të tij. Lidhur me këtë të fundit, në kushtet e zhvillimit të sotëm shoqëror, ku individ i ka qasje të lehtë në internet dhe mjete elektronike, Gjykata vlerëson se bëhet fjalë për mundësi reale në dispozicion të individit, i cili me vullnetin e tij të lirë zgjedh, që krabas shpalljes publike, të njoftohet edhe individualisht*”. Duke qenë dakord me këtë pjesë të vendimit, çmoj se i njëjti standard duhej zbatuar edhe në analizën e këtij pretendimi të kërkuësës dhe të nxirrej përfundimi se Gjykata e Lartë duhej ta kishte njoftuar individualisht kërkuësen, në kushtet kur ajo kishte depozituar të dhënen elektronike, “*numrin e telefonit celular*”.



8. Në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor, gjykata ka detyrimin që të bëjë të gjitha përpjekjet e duhura që individit të njoftohet efektivisht për procesin që zhvillohet ndaj tij. Njoftimi me shpallje, edhe pse mund të jetë efektiv për ecurinë e procesit, nuk mund të mbizotërojë ndaj së drejtës për proces të rregullt, në kushtet kur mundësitë dhe mjetet për realizimin e saj dukshëm kanë evoluar. Zbatimi i ngurtë vetëm i kësaj mënyrë njoftimi, minon aftësinë e kërkuesit për të marrë pjesë në proces dhe për të mbrojtur interesat e tij.

9. *Së dyti*, garancitë për realizimin e njoftimit efektiv janë forcuar edhe nga zhvillimet e fundit legjislativë, si dhe nga praktika e punës së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ato u janë përgjigjur zhvillimeve të teknologjisë së informacionit, që kanë lehtësuar komunikimin në jetën e përditshme, pavarësisht distancave gjeografike. Në procedurat gjyqësore vlen të evidentohet përmbajtja e nenit 141 të KPC-së, i zbatueshëm edhe në gjykimin administrativ, i cili ka parashikuar njoftimin elektronik. Ashtu siç me të drejtë vëren shumica, njoftimi elektronik është një alternativë e re ligjore, përdorimi i së cilës duhet nxitur, pasi i përgjigjet jo vetëm nevojës për shpejtësi në procedura, por edhe problematikave të shfaqura në jetën e përditshme nga lëvizjet demografike dhe sistemi i pakonsoliduar ende i adresave të qytetarëve (*shih paragrafin 65 të vendimit*).

10. Në këtë situatë, vlerësoj se Gjykata duhej t'u përgjigjej këtyre zhvillimeve dhe të pranonte se numri i telefonit celular përbën mjet komunikimi elektronik, sepse ai mundëson komunikimin e menjëhershëm të të dhënave nga njëri përdorues tek tjetri nëpërmjet mesazheve, por edhe nëpërmjet platformave sociale. Si i tillë, ai është pajisje e komunikimit elektronik, sepse shërben nga ana teknike për emetimin, transmetimin, rrugëzimin, komutimin dhe/ose marrjen e sinjaleve nëpërmjet valëve elektromagnetike. Në vlerësimin tim, ideja se komunikimi elektronik përfshin vetëm komunikimin me anë të postës elektronike është e varfër dhe nuk u përgjigjet zhvillimeve të sotme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (*sikurse njihet në përditshmëri "TIK"*), të cilat garantojnë sigurimin e aksesit në informacione përmes telekomunikimit, përfshirë këtu

internetin, celularët ose media të tjera komunikimi. Përdorimi i këtyre mjeteve i ka dhënë tashmë një dimension të ri ndërveprimit njerëzor, pasi nxit, realizon dhe motivon në kohë reale komunikimin dhe informimin për çështje që paraqesin rëndësi për individin dhe prekin interesat e tij, veçanërisht në procedura që ndryshojnë situatën juridike në raport me të drejtat dhe liritë themelore të tij. Nën këtë optikë, shmangia e disa mjeteve të komunikimit, të cilat janë të gjerësisht përdorshme nga individit, përbën një barrierë të ngurtë dhe të pakuptimtë.

11. Në rastin në shqyrtim, çështja e kërkueses ishte vënë në lëvizje nga pala kundërshtare e saj. Ndonëse çështja kishte në objektin e saj të drejta që lidheshin me zgjidhjen e paligjshme të marrëdhënies së punës së kërkueses, ajo është vënë në lëvizje pas 3 vjetësh e 6 muaj nga regjistrimi i saj. Në momentin që gjyqtari relator në Gjykatën e Lartë e vuri çështjen në lëvizje, njoftimi me shpallje publike zgjati vetëm 15 ditë (nga data 31.5.2022 në datën 15.6.2022), dhe në vijim, seanca në dhomën e këshillimit u shty për të nesërmen, ndaj njoftimi për këtë seancë të dytë qëndroi i shpallur vetëm një ditë. Edhe pse kërkuesja kishte depozituar numrin e telefonit celular, duke konfirmuar se kishte pritshmëri që njoftimet dhe komunikimet gjyqësore të realizoheshin nëpërmjet këtij mjeti, Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar individualisht kërkuesen. Me fjalë të tjera, pavarësisht se Gjykata e Lartë kishte mjete alternative në dispozicion për të realizuar njoftimin e kërkueses, sikurse komunikimi me telefon, ajo nuk e ka përdorur këtë mjet, duke vendosur një barrë tepër të rëndë për kërkuesen në drejtim të aksesit dhe mbrojtjes efektive.

12. Në përfundim, vlerësoj se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, në lidhje me të drejtën për mbrojtje efektive, të lidhur me mënyrën e zbatimit të ligjit, është i bazuar, për rrjedhojë ankimi kushtetues individual i saj duhej të pranohej dhe të vendosej shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë.

Anëtar: Marsida Xhaferllari



VENDIM
Nr. 36, datë 16.6.2023

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 14.6.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (Nj.) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: JO MË PAK SE NJË E PESTA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

OBJEKTI: Shfuqizimi i ligjit nr. 145/2020, datë 3.12.2020, “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 145/2020, datë 3.12.2020 derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, pika 1, 5, 6, 7, 11, 15, 17, 18, 116, pika 1, 121, 122, 124, 131, pika 1, shkronja “a”, 132 dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe bashkësisë evropiane e shteteve të tyre anëtare”; nenet 20, 21, pika 1, 27, 45, 47, 49, pika 1, 50, pika 1, 51, 51/a, pika 1, shkronja “b” dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin

dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Presidentit të Republikës së Shqipërisë (*Presidenti*), mori në shqyrtim prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 949, datë 25.11.2015 (*VKM nr. 949/2015*), ka miratuar marrëveshjen për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi. Neni 2 i kësaj marrëveshjeje parashikon se ajo do të zbatohet për të gjitha investimet e kryera nga investitorët e secilës prej palëve kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese, qoftë para ose pas hyrjes në fuqi të saj, por nuk do të zbatohet për ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me një investim që lind para hyrjes në fuqi të saj dhe as për ndonjë padi/prendim që është zgjidhur para hyrjes në fuqi të saj. Kohëzgjatja e marrëveshjes është përcaktuar 10 vjet dhe do të vazhdojë më pas të jetë në fuqi për një periudhë ose periudha të ngjashme, përveç se kur njëra prej palëve kontraktuese e zgjidh atë, duke dhënë një njoftim me shkrim për zgjidhje nëpërmjet kanaleve diplomatike të paktën gjashtë muaj para mbarimit të afatit të periudhës fillestare ose të çdo periudhe në vazhdim (neni 21, pika 1).

2. Më datë 26.11.2020 mes përfaqësuesve të qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe është nënshkruar marrëveshja për bashkëpunim



ekonomik ndërmjet dy vendeve (Marrëveshja). Sipas nenit 1 të saj, palët do të inkurajojnë dhe nxisin bashkëpunimin midis dy vendeve, veçanërisht atë ekonomik dhe tregtar dhe partneritetet strategjike në sektorë të veçantë dhe fusha me interes, në bazë të barazisë dhe përfitimeve të ndërsjella, në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në të dhe sipas termave e kushteve të përcaktuara në marrëveshje të veçanta, memorandumë mirëkuptimi dhe protokolle të lidhura për zbatimin e projekteve dhe të programeve konkrete të parashikuara në fushat e bashkëpunimit ndërmjet palëve dhe/ose ndërmjet njërës prej palëve dhe sektorit privat, ose midis sektorit privat të të dyja palëve, dhe / ose organeve ose autoriteteve kompetente të palëve që zbatojnë një projekt ose program konkret. Ky bashkëpunim, sipas nenit 2, përfshin: fushën industriale; tregtinë dhe fushat tregtare; fushën e investimeve; turizmin, në logjistikë dhe në infrastrukturën e ngjashme; fushën e pronave/aseteve/objekteve të paluajtshme; fushën e bujqësisë dhe sigurisë ushqimore, duke përcaktuar edhe aktivitetet që përfshin secila nga këto fusha të bashkëpunimit, por nuk ndalon bashkëpunimin edhe në fusha të tjera.

3. Palët kanë rënë dakord për një listë të projekteve specifike, sipas nenit 6 të saj, që konsiderohen të një natyre strategjike në përmbushjen e objektivave të Marrëveshjes dhe marrëveshjeve të mëparshme ekonomike dhe të bashkëpunimit midis dy palëve, konkretisht: rrizhivillimi i Portit të Durrësit; mundësitë e investimeve në industrinë e turizmit, bujqësisë dhe logjistikës në Vlorë, Sarandë dhe Ksamil; investimet në fushën e turizmit në zonën e Përmetit. Bazuar në këtë listë të projekteve me rëndësi strategjike për zhvillimin ekonomik të të dyja palëve dhe me qëllim realizimin e zbatimit e tyre, në paragrafin e dytë të nenit 6 është parashikuar që palët do të propozojnë subjekte specifike nga sfera publike dhe private, që do të bashkëpunojnë për të garantuar zbatimin e suksesshëm të projekteve, disa ose të gjitha, siç është rënë dakord prej tyre. Po në nenin 6, paragrafi i tretë, parashikohet se “për qëllimet e përmbushjes së kësaj Marrëveshjeje, në përputhje të plotë me nenin 8 të Marrëveshjes për Nxitjen dhe Mbrojtjen e

Investimeve, të nënshkruar midis Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, më datë 15 tetor 2015, kontratat, programet dhe projektet strategjike të rëna dakord, në përputhje me këtë Marrëveshje, nuk do të jenë në asnjë prej Palëve që u nënshtrohen prokurimit publik, tenderit publik, procedurës konkurruese publike ose ndonjë procedure tjetër të përcaktuar në legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë ose të Emirateve të Bashkuara Arabe pas ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje. Procedurat specifike do të bien dakord nga palët, duke përfshirë dhe duke mos u kufizuar në zbatimin e instrumenteve ligjore të rëndësishme për investimet strategjike të aplikuara në të dyja ose secilën nga palët, nëse gjykohet e nevojshme.”.

4. Sipas nenit 7 të Marrëveshjes, marrëveshja ndërmjet Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Këshillit të Ministrave për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin, e ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 61/2014, datë 19.6.2014, do të zbatohet edhe për subjektet qeveritare të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe filialet e tyre. Neni 8, pika 1, i Marrëveshjes parashikon se palët do të krijojnë një komitet të përbashkët ose nënkomitete për të punuar mbi temat e mbuluara prej saj ose ndonjë temë tjetër për të cilën do të bihet dakord midis tyre, ndërsa në nenin 9, paragrafi i parë, parashikohet se Marrëveshja do të hyjë në fuqi me ratifikimin nga parlamenti, për të cilin palët do të njoftohen nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave kushtetuese të nevojshme për ratifikimin e saj. Ajo do të mbetet në fuqi për një periudhë 10-vjeçare, por secila palë ka të drejtë ta përfundojë Marrëveshjen në çdo kohë, duke informuar palën tjetër për këtë në formë të shkruar, nëpërmjet kanaleve diplomatike, përfundim ky që do të jetë i vlefshëm pas gjashtë muajsh nga data e njoftimit.

5. Me ligjin nr. 145/2020, datë 3.12.2020 (*ligji nr. 145/2020*), Kuvendi, në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, ka vendosur të ratifikojë Marrëveshjen, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Ky ligj është quajtur i shpallur sipas nenit 84, pika 2, të Kushtetutës, në kushtet kur Presidenti nuk ka ushtruar të drejtën e shpalljes brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij dhe as të drejtën e kthimit të ligjit për rishqyrtim.



Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 8.1.2021 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit.

6. Me vendimin nr. 14/6, datë 2.12.2021 (*vendimi nr. 14/6*), Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), në vijim të Marrëveshjes dhe në zbatim të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 55/2015*), VKM-ve nr. 1023, datë 16.12.2015 e nr. 1026, datë 16.12.2015, si dhe vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 14.10.2020, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ka vendosur miratimin e statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit “Marina & Jahtet e Durrësit” (Durrës Yachts & Marina), si një projekt i integruar turistik dhe i një rëndësie strategjike për vendin, të kushtëzuar me realizimin e detyrave, planit të veprimit të parashikuar në këtë vendim, si dhe me finalizimin e një marrëveshjeje mbi formën e bashkëpunimit midis palëve, të vlefshme sipas parashikimeve ligjore të zbatueshme. Sipas pikës 3 të vendimit të KIS-it, projekti do të realizohet nga subjekti aplikues “Symphony Real Estate Development” sh.p.k., i cili, sipas pikës 4 të vendimit, do të realizojë një projekt të integruar me port turistik dhe struktura akomoduese elitare, rezidenca me standard të lartë dhe shërbime në funksion të tyre. Projekti do të zhvillohet në një sipërfaqe afërsisht 79 ha, në zonën e Portit të Durrësit, i ndarë në 2 faza zhvillimi. Vendimi i KIS-it ka parashikuar edhe masat mbështetëse që i jepen zhvillimit të projektit (pika 8), duke përcaktuar edhe dokumentacionin që subjekti investues duhet të paraqesë pranë AIDA-s, në përputhje me dispozitat e VKM-së nr. 1030, datë 16.12.2015, “Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimit e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike” (pika 9).

7. Me VKM-në nr. 861, datë 29.12.2021, “Për transferimin në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike, të pronave të paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit” (Durrës

Yachts & Marina), dhe për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Autoriteti Portual Durrës te Ministria e Financave dhe Ekonomisë” (VKM nr. 861/2021), Këshilli i Ministrave ka vendosur transferimin në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike (FPPMIS), të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, me sipërfaqe totale 80.9 (tetëdhjetë pikë nëntë) ha, si dhe ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Autoriteti Portual Durrës (APD) te Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), të pasurive të paluajtshme të përcaktuara në shtojcën 1 dhe në planvendosjen që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij. Vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme shtetërore bëhet sipas përcaktimeve të vendimit nr. 14/6 të KIS-it dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes/kontratës së bashkëpunimit ndërmjet palës shqiptare dhe shoqërisë “Symphony Real Estate Development” sh.p.k., në të cilën do të përcaktohet forma e pjesëmarrjes së shtetit në investim dhe mënyra e vënies në dispozicion të pronës shtetërore, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Sipas pikës 6, pronat do të përdoren nga APD-ja deri në zhvendosjen përfundimtare sipas fazave të zbatimit të projektit (të përcaktuara në vendimin nr. 14/6 të KIS-it) dhe asaj i ndalohet të ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

8. Me vendimin nr. 14/45, datë 18.7.2022 të KIS-it janë miratuar disa ndryshime në vendimin nr. 14/6, konkretisht në titullin e tij, si dhe përmbajtjen e pikave 2, 3, 6, 18, 19, 20, 22, 23, 27 dhe 28. Më konkretisht, statusi “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” i jepet projektit të investimit “Marina & Jahtet e Durrësit” (Durrës Yachts & Marina), për një periudhë 15-vjeçare. Projekti do të realizohet nga subjekti aplikues “Eagle Hills Real Estate Development” sh.p.k (ish-“Symphony Real Estate Development” sh.p.k.) dhe garantues financiar subjekti NSHMI DEVELOPMENT L.L.C. Në lidhje me pikën 6 të vendimit nr. 14/6 është parashikuar që deri në krijimin e kushteve të nevojshme procedurale dhe fizike për realizimin e këtij investimi, projekti fillon me Fazën e Zhvillimit Pilot, dhe për realizimin e



kësaj detyre lidhet një marrëveshje mirëkuptimi midis “Eagle Hills Real Estate Development” sh.p.k. dhe subjektit të posaçëm të ngritur nga APD-ja.

9. Me VKM-në nr. 494, datë 21.7.2022, Këshilli i Ministrave ka bërë disa ndryshime në VKM-në nr. 861/2021, konkretisht në titullin e saj dhe në pikat 1 dhe 2, duke parashikuar transferimin në FPPMIS të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, me sipërfaqe totale 812,600.98 (tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind pikë nëntëdhjetë e tetë) m², nga të cilat 54,217.51 (pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e një) m² sipërfaqe ndërtimore të përcaktuara në shtojcën 1 dhe në planvendosjen që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij. Po kështu, është ndryshuar përgjegjësia e administrimit nga APD-ja, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Drejtësisë, të MFE-ja të pasurive të paluajtshme të përcaktuara prej tij.

10. Me VKM-në nr. 685, datë 26.10.2022, Këshilli i Ministrave ka bërë disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 861/2021, konkretisht në pikën 1, fjalët “...me sipërfaqe totale 812,600.98 m², nga të cilat 54,217.51 m² sipërfaqe ndërtimore...” zëvendësohen me “...me sipërfaqe totale 818,318.98 m², nga të cilat 61,450.51 m² sipërfaqe ndërtimore...”. Në pikat 4 dhe 8 shoqëria “Symphony Real Estate Development” sh.p.k. zëvendësohet me “Eagle Hills Real Estate Development” sh.p.k.

11. Me kërkesën e datës 11.11.2022, një grup prej 36 deputetësh, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e ligjit nr. 145/2020, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (*MSA*), duke kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të këtij akti deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës.

12. Ndërsa kërkesa e subjektit jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit ndodhej për shqyrtim përpara Gjykatës, me ligjin nr. 79/2022, datë 24.11.2022 (*ligji nr. 79/2022*) është miratuar marrëveshja kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Eagle Hills Real Estate

Development, Albanian Seaports Development Company sh.a. dhe NSHMI Development L.L.C., për projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”, si dhe shtojcat e kësaj marrëveshjeje kuadër sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji. Sipas nenit 2, pika 3, të ligjit, pronat e paluajtshme shtetërore të transferuara në FPPMIS për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”, me vendim të Këshillit të Ministrave i kalojnë në pronësi shoqërisë “Albanian Seaports Development Company” sh.a., e cila, sipas të dhënave të Regjistrat Tregtar, është një subjekt i së drejtës shqiptare, e themeluar më 27.7.2022, me aksionar të vetëm APD-në dhe me objekt veprimtarie koordinimin dhe administrimin e proceseve të lidhura me projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit” etj. Sipas nenit 4 të ligjit, shoqëria “Albanian Seaports Development Company” sh.a. lidh marrëveshjen e zhvillimit dhe kontratën për transferimin e titullit të pronësisë sipas tekstit të dokumenteve bashkëlidhur këtij ligji, kurse Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lidh marrëveshjen, “Për Marinën e Durrësit”, sipas tekstit të dokumentit bashkëlidhur këtij ligji.

13. Në vijim, me VKM-në nr. 115, datë 1.3.2023, Këshilli i Ministrave, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, neneve 3 dhe 5 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe nenit 2, pika 3, të ligjit nr. 79/2022, ka vendosur transferimin në pronësi të shoqërisë “Albanian Seaports Development Company” sh.a. të pronave të paluajtshme shtetërore, pjesë e FPPMIS-së, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, sipas shtojcës 1 dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

14. Me vendimin e datës 6.12.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 20.12.2022, ka



vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.²

15. Në mbledhjen e datës 20.12.2022, Mbledhja e Gjyqtarëve mori në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 145/2020. Sipas nenit 45, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000 Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare urdhëron pezullimin e tij. Duke pasur parasysh përmbajtjen e kësaj dispozite, si edhe referuar argumenteve të kërkuësit në mbështetje të këtij kërkitimi, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim si të pabazuar, pasi vlerësoi se kërkuesi nuk ka arritur të provojë ardhjen e pasojave të rënda ose të pariparueshme nga përmbajtja e aktit të kundërshtuar, çka përbën edhe kriterin thelbësor për të vendosur pezullimin e zbatimit të dispozitës/aktit të kundërshtuar.³

16. Me shkresën nr. 3 prot., datë 4.1.2023, Gjykata ka njoftuar palët për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, duke u kërkuar një opinion për disa aspekte specifike të çështjes, të cilat u vlerësuan të nevojshme për zhvillimin sa më të plotë të këtij gjykimi. Më konkretisht, Gjykata ka kërkuar nga palët që të paraqesin paraprakisht vlerësimin e tyre për sa i përket: i) juridiksionit të Gjykatës, në vështtrim të nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, për të shqyrtuar pajtueshmërinë me Kushtetutën ose me marrëveshje të tjera ndërkombëtare të ligjit ratifikues të një marrëveshjeje ndërkombëtare, si dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata; ii) juridiksionit të Gjykatës, në vështtrim të nenit 131, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës, për të shqyrtuar pajtueshmërinë e Marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr. 145/2020, pas ratifikimit të saj; iii) kategorizimit të Marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr. 145/2020, sipas nenit 121, pika 1 ose pika 2, të Kushtetutës, si dhe kriteret e

kategorizimit të marrëveshjeve sipas këtyre dispozitave.

17. Ndërkohë, me kërkesën e datës 9.2.2023, shoqata “Durrësi Autokton” ka kërkuar të marrë pjesë në këtë gjykim në cilësinë e personit të tretë, duke pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se projekti i Portit të Durrësit është i pakonsultuar me banorët e Durrësit dhe se është kundërshtuar në vijimësi prej kësaj shoqate. Sipas saj, duke qenë se për nga objekti i veprimtarisë tërheq të drejta të njëjta me kërkuësin, në përputhje me nenin 134 të Kushtetutës dhe nenin 49 të ligjit nr. 8577/2000 legjitimohet të marrë pjesë në këtë gjykim si palë e tretë, duke u bashkuar me kërkuësin.

18. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin e datës 16.2.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve, në kuptim të nenit 39, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, vendosi rrëzimin e saj si të pabazuar, pasi vlerësoi se shoqata “Durrësi Autokton” nuk ka paraqitur prova dhe nuk ka parashtruar argumente për të provuar interesin e saj të drejtpërdrejtë, konkret dhe aktual në rezultatin e mosmarrëveshjes objekt i këtij gjykimi. Për më tepër, referuar objektit të gjykimit kushtetues të vënë në lëvizje nga subjekti kushtetues një e pesta e deputetëve të Kuvendit dhe shkaqeve të parashtruara nga kërkuësi, si dhe duke pasur parasysh objektin e veprimtarisë së shoqatës “Durrësi Autokton”, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se thirrja e saj për t’u dëgjuar si subjekt i interesuar nuk i shërben dhe nuk është në interes të këtij gjykimi kushtetues.⁴

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

19. **Kërkuësi, jo më pak se 1/5-ta e deputetëve të Kuvendit**, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

19.1 *Për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 145/2020:*

Marrëveshja e ratifikuar me ligjin nr. 145/2020 ka nisur të zbatohet, pasi për rizhvillimin e Portit të Durrësit është aplikuar statusi i investitorit strategjik me procedurë të veçantë për një shoqëri të përzgjedhur nga

² Gjyqtarja Sonila Bejtja shprehu qëndrimin për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

³ Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për pranimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 145/2020.

⁴ Gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Sonila Bejtja votuan për pranimin e kërkesës.



qeveria e Emirateve të Bashkuara, e cila do të investojë 2 miliardë euro për ndërtimin e një porti jahtesh dhe një zone rezidenciale elitare, ku një nga lehtësitë do të jetë edhe vënia në dispozicion e tokës prej 79 ha.

19.2 Për juridiksionin e Gjykatës:

Në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të Kushtetutës, Shqipëria ka pranuar kontrollin *ex ante* të marrëveshjeve ndërkombëtare, me qëllim që Kuvendi të mos lejojë ratifikimin e atyre që bien ndesh me Kushtetutën. Në kushtet e përgjegjshmërisë së ekzekutivit është Gjykata që duhet të garantojë respektimin e shtetit ligjor, pasi ajo ka një rol kryesor në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE) dhe parashikimi i nenit 1 të MSA-së përbën bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji antikushtetues, përfshirë ligjin ratifikues. Referuar nenit 121, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës, Gjykata nuk mund të shqyrtojë marrëveshjen ndërkombëtare pas ratifikimit, por mund të bëjë kontrollin abstrakt të ligjit ratifikues bazuar në shkronjën “a” të këtij neni dhe nëse konstaton se ai është antikushtetues, bie edhe vetë marrëveshja.

19.3 Për themelin e çështjes:

A) Për ligjin nr. 145/2020 *kërkuasi ka pretenduar se bie ndesh me:*

19.3.1 Nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës, për shkak se nuk është përfshirë kreu i shtetit edhe pse jemi para një marrëveshjeje me karakter politik, pasi kemi të bëjmë me integritet territorial, duke qenë se bashkëpunimi është në fusha të ndryshme me impakt financiar dhe territorial. Fushat e përcaktuara janë nevralgjike të ekonomisë dhe Marrëveshja parashikon përjashtimin nga rregullat e prokurimit publik dhe të konkurrencës së detyrueshme sipas MSA-së dhe kuadrit ligjor në fuqi, si dhe konsolidimin e truallit 79 ha në favor të një shoqërie që deklarohet se do të investojë duke prekur territorin e një prej porteve më të rëndësishme në vend.

19.3.2 Qeveria e ka paraqitur si një marrëveshje jopolitike dhe në relacionin e ligjit dhe raportin e komisionit parlamentar përgjegjës thuhet se ajo është konceptuar si marrëveshje kuadër pa implikime financiare. Referuar relacionit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat të datës 2.12.2020, si bazë kushtetuese është përcaktuar pika 1 e nenit 121, kurse

referuar raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*Komisioni i Ligjeve*) të po asaj date, si bazë kushtetuese është përcaktuar shkronja “ç” e pikës 1 të nenit 121. Pra, vetë qeveria dhe Kuvendi kanë pranuar se marrëveshja është politike. Referuar tekstit të marrëveshjes, relacionit shoqërues dhe dokumenteve parlamentare ajo është një marrëveshje kuadër bashkëpunimi ekonomik, ku, në fakt, nuk bëhet e qartë se cilat janë detyrimet financiare dhe mund të ishte një marrëveshje në nivel qeveritar, për sa kohë që e tillë ishte edhe marrëveshja e miratuar me VKM-në nr. 949/2015. Por qeveria, për t'i dhënë fuqinë e një marrëveshjeje ndërkombëtare me karakter politik dhe për të realizuar qëllimet e saj, ndërkohë që teksti binte ndesh me MSA-në, parashikoi hyrjen në fuqi me ratifikimin e saj në parlament.

19.3.3 Konventën e Vjenës, si dhe nenet 4, 7 dhe 122 të Kushtetutës, pasi janë shkelur procedurat e nënshkrimit të Marrëveshjes dhe ratifikimit të saj. Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 43/2016*), procedura për lidhjen e marrëveshjes nuk është bërë transparente në aktet parlamentare, qoftë për sa i përket llojit, nëse është me negociim apo shkëmbim notash, mënyrës se si janë organizuar negociatat, kush ka marrë pjesë në delegacionin për zhvillimin e tyre, miratimin në parim të marrëveshjes dhe ndryshimet e bëra në vijim, apo edhe procedurat e ndjekura sipas këtij ligji. Referuar dokumenteve parlamentare të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit, nuk kuptohet se cila ka qenë ministria kompetente në negociimin e termave të marrëveshjes dhe as se kur është paraqitur prej saj marrëveshja e nënshkruar për ratifikim. Këshilli i Ministrave nuk ka bërë transparencë dhe nuk ka informuar Kuvendin në këtë drejtim. Gjithashtu, mungon mendimi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) dhe i Ministrisë së Drejtësisë (MD), sikurse e kërkon shkronja “dh” e nenit 17 të ligjit nr. 43/2016, që është e detyrueshme.

19.3.4 Nenin 82, pika 1, të Kushtetutës, pasi projektligji nuk është shoqëruar me raportin që për ligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij. Në nenin 6 të Marrëveshjes janë përcaktuar projektet ku do të investohet, ndaj do të duhej të



ishte përcaktuar lloji i projektit dhe fatura financiare për zhvillimin e tij. Në këtë rast bëhet fjalë për vlera investimi të patenderuara në projekte të veprave publike me rëndësi të veçantë edhe historike ku implikohen vlera financiare të larta, për sa kohë vihet në dispozicion pronë publike. Sipas vendimit të KIS-it, në lidhje me projektin e Portit të Durrësit qeveria ka vendosur që investitori të përjashtohet nga taksa e infrastrukturës dhe e strehimit social. Fakti që kjo Marrëveshje do të implementohet me marrëveshje të tjera specifike zbatimi për secilin projekt, tregon se ndikimi në buxhetin e shtetit jo vetëm është i pashmangshëm, por mënyra si është vepruar, pa një studim paraprak lidhur me ndikimet në të ardhmen, investimet dhe dobishmërinë, ngre alarmin se ndikimi do të jetë shumë negativ.

B) Për Marrëveshjen kërkuar ka pretenduar se bën ndesh me:

19.3.5 Identitetin kombëtar, pasi parashikimet e saj jo vetëm shmangin detyrimet për konkurrim të hapur dhe transparent, por cenojnë edhe këtë identitet, duke qenë se Porti i Durrësit ka një histori 3000-vjeçare.

19.3.6 Parimin e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike, pasi synohet hyrja në negociata me të përzgjedhurin e selektuar paraprakisht për të tjetërsuar një tokë publike për investim, ndërsa shteti nuk ka parashikuar të marrë asgjë në këmbim të dhënies së pronës publike ose kur do e marrë atë. Neni 6, pika 3, i Marrëveshjes ka referuar në mashttrim të përmbajtjes së marrëveshjes së miratuar me VKM-në nr. 949/2015, pasi neni 8 i kësaj të fundit nuk ka në përmbajtje përjashtimin nga procedurat konkurruese, tenderuese ose ndonjë procedurë tjetër të përcaktuar në legjislacionet e shteteve palë. Duke garantuar lejimin e përjashtimit nga këto procedura, çdo investitor i huaj nga Emiratet e Bashkuara Arabe në të ardhmen mund të adresojë padi në arbitrazh bazuar në Konventën e ICSID-së, nëse ky detyrim nuk respektohet nga pala shqiptare.

19.3.7 Parimin e barazisë para ligjit dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike, pasi në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës është përcaktuar një trajtim preferencial i shoqërive shtetërore ose private të propozuara nga palët e Marrëveshjes, pa një procedurë konkurrimi të hapur dhe

transparente. Parashikimi në nenin 6, pika 2, përbën kusht parakualifikues për të marrë pjesë në garë, duke e bërë procesin konkurrues selektiv, kurse pika 3 cenon kuadrin ligjor lidhur me prokurimet publike e partneritetin publik privat, të përafruara me direktivat e BE-së në kuadër të MSA-së. Edhe pse përcaktohen fushat e bashkëpunimit, nuk bëhet me dije se si do të përzgjidhet shoqëria dhe pse nuk do të ketë garë të hapur për përzgjedhjen e personit fizik ose juridik me të cilin shteti do të negociojë për nënshkrimin e një kontrate bashkëpunimi, ndërkohë që legjislacioni për prokurimin publik ose për partneritetin publik privat parashikon procedura jo diskriminuese dhe transparente konkurrimi përmes të cilave përzgjidhet operatori që ka ofertën më të leverdishme.

*19.3.8 Parashikimet e MSA-së, pasi Marrëveshja nuk lejon një proces konkurrimi të hapur midis ofertave dhe të bazuar në transparencë. Referuar neneve 6 dhe 7 të saj qëllimi dhe synimi kanë qenë miratimi i një kuadri ligjor special *ad-hoc*, pa garë, pa konkurrencë, në mungesë transparence, duke i njohur këto privilegje vetëm për projektet e identifikuar nga palët në Marrëveshje. Ajo përjashton garën, diskriminon duke favorizuar disa shoqëri në raport me të tjera, cenon konkurrencën, transparencën, prokurimin publik dhe liberalizimin e kontratave publike, duke mos lejuar të marrin pjesë në këto projekte shoqëri të komunitetit. MEPJ-ja ose MD-ja nuk janë shprehur për implikimet që do të sjellë Marrëveshja në drejtim të zbatimit të MSA-së dhe as relacioni i projektligjit ose raportet e komisioneve të Kuvendit nuk shqyrtojnë në detaje përmbajtjen e neneve të saj, por vetëm i përmendin ato.*

20. Subjekti i interesuar, Presidenti, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

21. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka paraqitur si vijon:

21.1 Për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 145/2020:

Marrëveshja e ratifikuar me ligjin nr. 145/2020 nuk cenon interesa shtetërore, shoqërore ose individuale dhe kërkuar nuk argumenton se cilat janë pasojat e ardhura nga hyrja e saj në fuqi prej më shumë se dy vjetësh dhe sa të rënda janë ato. Referimet e kërkuar



nuk kanë të bëjnë me ligjin ratifikues, por me vetë Marrëveshjen, e cila tashmë është ratifikuar dhe nuk është pjesë e këtij gjykimi.

21.2 Për juridiksionin e Gjykatës:

Referuar nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, ligji ratifikues dhe Marrëveshja nuk janë i njëjti akt dhe nuk mund të bëhen në asnjë moment një akt i vetëm. Marrëveshja është akt i së drejtës ndërkombëtare, kurse ligji është instrumenti përmes të cilit Kuvendi jep pëlqimin për të lidhur Shqipërinë në një marrëveshje ndërkombëtare. Duke mos pasur asnjë përmbajtje substanciale e duke qenë një akt i dallueshëm nga Marrëveshja, përjashtohet çdo mundësi e kontrollit substancial të pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Kontrolli nuk shtrihet mbi formën dhe procedurën për hyrjen në bisedime, negocimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes, e cila është një fazë që nuk rregullohet nga procedura parlamentare. As Kushtetuta, as ligji organik i Gjykatës nuk parashikojnë juridiksionin e saj për kontrollin *a posteriori (ex post)* të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara. Kontrolli i pajtueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën mund të kryhet vetëm para përfundimit të procedurave të ratifikimit sipas nenit 131, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës. Edhe referuar nenit 180 të Kushtetutës, lejohet kontrolli *a posteriori (ex post)* vetëm i atyre marrëveshjeve që janë ratifikuar para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

21.3 Për themelin e çështjes:

A) Për ligjin nr. 145/2020:

21.3.1 Në lidhje me kategorizimin e marrëveshjeve sipas nenit 121 të Kushtetutës, Kuvendi, në varësi të rëndësisë, mund të ratifikojë me ligj edhe marrëveshje që nuk parashikohen në pikën 1 të tij, duke mos e lënë këtë vetëm në vlerësimin e Këshillit të Ministrave, çka përputhet edhe me parashikimin e nenit 1, pika 1, të Kushtetutës, sipas të cilit Shqipëria është republikë parlamentare. Kriteret për zbatimin e nenit 121, pika 2, të Kushtetutës janë kontrolli parlamentar mbi pushtetin ekzekutiv, legjitimiteti demokratik i hyrjes në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare, rëndësia e saj dhe parimi i reciprocitetit. Marrëveshja e ratifikuar me ligjin nr. 145/2020 ka karakter

ekonomik dhe me ratifikimin në Kuvend synon krijimin e bazës ligjore ndërmjet palëve, me qëllim sigurimin e një bashkëpunimi ekonomik. Ajo është marrëveshje kuadër dhe nuk ka efekte financiare, ndërkohë që çdo marrëveshje tjetër që do të negociohet dhe nënshkruhet mbi bazën e saj, do të trajtohet e miratohet më vete dhe do të përmbajë, nëse është rasti, edhe efektet financiare.

21.3.2 Pretendimi se procedura është në kundërshtim me nenet 4, 7 dhe 122 të Kushtetutës dhe e paligjshme në kuptim të nenit 46 të Konventës së Vjenës dhe legjislacionit të brendshëm është i pabazuar. Pretendimet e kërkuarit në këtë drejtim nuk kanë të bëjnë me antikushtetutshmërinë e ligjit dhe nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Emiratet e Bashkuara, në përputhje me nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 43/2016, me notën verbale nr. 2020/370784, datë 18.11.2020, kanë paraqitur shprehjen e vullnetit për të qenë të lidhur me marrëveshje bashkëpunimi ekonomik me Shqipërinë, bashkë me draftmarrëveshjen. Ky komunikim, në përputhje me nenin 8, pika 6, të ligjit nr. 43/2016, i është përcjellë zyrtarisht MFE-së nëpërmjet MEPJ-së. Sipas nenit 9, pika 1, të ligjit, palët kanë komunikuar me njëra-tjetrën duke shkëmbyer tekstet, komunikim i realizuar nëpërmjet MEPJ-së. Miratimi i tekstit të Marrëveshjes para nënshkrimit ka vijuar pasi strukturat kompetente të të dyjave palëve kanë dakordësuar tekstin. MEPJ-ja, nëpërmjet sistemit të e-akteve, ka dhënë mendim për miratimin në parim të marrëveshjes, çka i ka çelur rrugën komunikimit për detajet e nënshkrimit. Nëpërmjet ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Emiratet e Bashkuara janë shkëmbyer në distancë tekstet përfundimtare në alternatet shqip dhe arabisht, si dhe emrat e zyrtarëve nënshkrues. Më tej, në përputhje me nenin 14 të ligjit nr. 43/2016, MEPJ-ja ka printuar marrëveshjen dhe ka përgatitur dosjen e palës shqiptare dhe ajo është nënshkruar nga zyrtarët e autorizuar sipas nenit 6, pika 5, të ligjit nr. 43/2016 dhe nenit 7 të Konventës së Vjenës. Në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 43/2016 marrëveshja e nënshkruar është depozituar në MEPJ. Pala shqiptare, nëpërmjet ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Emiratet e Bashkuara, më datë 8.2.2021 ka njoftuar palën tjetër për përfundimin e procedurave të



brendshme për hyrjen në fuqi të marrëveshjes. Të njëjtin njoftim, nëpërmjet së njëjtës rrugë, e ka përcjellë pala tjetër më datë 3.6.2021. Në vijim, MEPJ-ja, në përputhje me nenin 33, pika 3, të ligjit nr. 43/2016, ka njoftuar Qendrën e Botimeve Zyrtare për datën e hyrjes në fuqi të saj.

21.3.3 Procedura e ndjekur respekton në mënyrë rigorozë kriteret për negocimin, nënshkrimin dhe ratifikimin e Marrëveshjes dhe argumentet e kërkuarit nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Kuvendi e ka ratifikuar Marrëveshjen me ligjin nr. 145/2020, për pasojë në këtë rast vlejné parashikimet e nenit 8 të Konventës së Vjenës. Edhe nëse hipotetikusht do të pranohej se ka pasur ndonjë shkelje, çdo lloj parregullsie është rregulluar me ratifikimin e saj nga Kuvendi. Referimi në nenin 46 të Konventës së Vjenës është i pavend, pasi kjo dispozitë kërkon që shkelja e pretenduar të jetë e qartë dhe të ketë të bëjë me një rregull të së drejtës së brendshme të një rëndësie thelbësore, çka nuk është provuar në rastin konkret.

B) Për Marrëveshjen:

21.3.4 *Pretendimi për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike* është i pabazuar, pasi një pasaktësi në referimin e një norme ligjore nuk sjell shkelje, sidomos të nivelit kushtetues. Referimi që bën neni 6 i Marrëveshjes është i drejtë, për sa kohë i shërben zbatimit efektiv të nenit 8 të marrëveshjes së datës 15.10.2015 në lidhje me rastet e kompensimit për dëmet ose humbjet e pësura sipas kësaj dispozite. Marrëveshja synon të vendosë një kuadër ligjor për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe që mbulojnë fusha bashkëpunimi të përcaktuara bashkërisht, duke përfshirë marrëveshjen e datës 15.10.2015. Kjo e fundit ka krijuar hapësirën e nevojshme për rregullimin në mënyrë specifike dhe të drejtpërdrejtë të marrëdhënies së investimit me një investitor të palës tjetër kontraktuese, argument që gjendet i bazuar në nenin 7 të Marrëveshjes. Argumentet e tjera të kërkuarit bazohen në mospërputhshmërinë e parashikimeve të Marrëveshjes me relacionin shpjegues dhe raportin e komisionit parlamentar përgjegjës për financat në drejtim të përcaktimit të efekteve financiare dhe implikimeve buxhetore, të cilat nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

21.3.5 *Pretendimi për shkeljen e dispozitave të MSA-së është i pabazuar*, pasi neni 74 i saj i lejon Shqipërisë që gradualisht të lejojë shoqëritë e komunitetit të marrin pjesë në procedura konkurruese për realizimin e projekteve të shpallura, si dhe u garanton një trajtim jo më pak të favorshëm se ai i shoqërive shqiptare. Edhe sikur hipotetikusht të pranohet se ka konflikt mes Marrëveshjes dhe MSA-së, ajo është miratuar para hyrjes së Shqipërisë në BE, ndaj nuk janë cenuar detyrimet ndërkombëtare të shtetit. Përjashtimi i zbatimit të procedurave të prokurimit dhe tenderimit është një veçori që lind nga natyra e Marrëveshjes, e cila kërkon që palët të marrin përsipër zbatimin e saj nëpërmjet institucioneve shtetërore ose subjekteve tregtare private, ndërkohë që procedurat e përzgjedhjes së subjekteve sipas rregullave të zakonshme të prokurimit ose tenderimit nuk garantojnë në çdo rast përzgjedhjen e subjektit për realizimin e investimit dhe projektit sipas saj.

21.3.6 I pabazuar është edhe *pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike*, pasi Marrëveshja vepron si një marrëveshje kuadër që mishëron dëshirën dhe angazhimin e dy shteteve për të intensifikuar marrëdhënien dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre në fusha të ndryshme. Nisma për bashkëpunim është ndërmarrë nga autoritetet e secilës palë dhe Marrëveshja është e kushtëzuar me kriteret investuese, që do të detajohen në marrëveshje të posaçme. Investimet do të bëhen në pronësinë shtetërore në Shqipëri, në termat dhe kushtet e rëna dakord nga palët, sipas rregullimit që do të bëhet individualisht me marrëveshje të veçantë. Në kushtet kur investuesi është një autoritet i huaj, i cili investon fondet e veta publike, nuk mund të aplikohen rregullat e përgjithshme të prokurimit publik.

22. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar si vijon:

22.1 *Për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 145/2020*

Ligji nr. 145/2020 ka sjellë efekte juridike që më datë 24.1.2021, duke e bërë Marrëveshjen pjesë të legjislacionit të brendshëm, çka është efekti i vetëm juridik dhe ai nuk mund të krijojë pasoja të tjera për shtetin shqiptar. Kërkuar nuk ka parashtruar argumente konkrete për pasojat e dëmshme dhe të pariparueshme, si dhe



mundësinë e cenimit të interesave shoqërorë ose të individëve, por ka paraqitur argumente të përgjithshme, të pabazuara.

22.2 Për juridiksionin e Gjykatës

Kontrolli kushtetues i Marrëveshjes mund të realizohet vetëm para ratifikimit të saj, pasi jurisprudenca kushtetuese në mënyrë të qartë e ka ndarë ligjin ratifikues nga marrëveshja ndërkombëtare, duke i cilësuar si dy akte juridike që nuk vlerësohen së bashku. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, Gjykata nuk mund të ushtrojë kontroll të zakonshëm të pajtueshmërisë së ligjit ratifikues me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare, por vetëm në aspektet procedurale, sikurse mund të jetë vendimi i Kuvendit për miratimin e ligjit ratifikues (kuorumi, numri i votave). Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare ushtrohet vetëm *a priori (ex ante)* dhe, si i tillë, krijon efekte të menjëhershme në procedurën që zhvillon Kuvendi, duke e pezulluar atë dhe duke e bërë të pamundur zhvillimin e saj nëse Gjykata vendos papajtueshmërinë me Kushtetutën. Edhe sipas nenit 180, pika 2, të Kushtetutës, Gjykatës i është njohur ushtrimi i kontrollit *a posteriori (ex post)* vetëm për marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara para datës 28.11.1998, procedurë e saktësuar edhe në nenin 53 të ligjit nr. 8577/2000.

22.3 Për legjitimimin e kërkesës

22.3.1 Kërkesi nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi me ratifikimin e Marrëveshjes humb e drejta e subjekteve për t’iu drejtuar Gjykatës. Ligji nr. 145/2020 ka hyrë në fuqi më 24.1.2021, kurse kërkesa është paraqitur më 11.11.2022, pra jashtë afatit sipas nenit 131, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës.

22.3.2 Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, pretendimet e kërkesës i referohen Marrëveshjes, e cila nuk mund t’i nënshtrohet vlerësimit të kushtetutshmërisë pas ratifikimit nga Kuvendi. Për më tepër, ato nuk janë të nivelit kushtetues, pasi kanë të bëjnë me konflikte mes normave juridike, për zbatimin e të cilave vlejnë parimet e përgjithshme të së drejtës.

22.4 Për themelin e çështjes:

A) Për ligjin nr. 145/2020:

22.4.1 Neni 121 i Kushtetutës ka përcaktuar rastet kur ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me ligj, ndërsa

pika 2 e tij nuk vendos kritere që do të zbatohen në vendimmarrje, por i është lënë në dorë negocimit të palëve. Në nenin 9 të Marrëveshjes është përcaktuar hyrja në fuqi me ratifikimin nga Kuvendi, duke marrë parasysh kriterin subjektiv, pra vullnetin e palëve, dhe jo ndonjë nga kriteret objektive që detyrojnë zhvillimin e procedurës ratifikuese nga ky organ. Ndaj Marrëveshja kategorizohet si marrëveshje ndërkombëtare në kuadër të nenit 121, pika 2, të Kushtetutës në lidhje me nenin 16 të ligjit nr. 43/2016. Pretendimi se Marrëveshja ka natyrë politike është i pabazuar, pasi sipas nenit 6, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 43/2016, kur marrëveshja që negocohet dhe nënshkruhet është në emër të Këshillit të Ministrave, plotfuqia lëshohet nga ministri i MEPJ-së, pas autorizimit të dhënë nga Kryeministri, ndërkohë që autorizimi i Presidentit kërkohet kur marrëveshja nënshkruhet në emër të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 5, pika 2, të ligjit nr. 43/2016, që nuk është rasti konkret. Veprimet e ndërmarra nga Kryeministri janë në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe ligjore. Këshilli i Ministrave e ka dërguar Marrëveshjen për ratifikim në Kuvend pasi paraprakisht e ka miratuar në mbledhjen e datës 25.11.2020, procedurë që siguron zbatimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, pasi u jep mundësinë deputetëve të shprehen me votë ose ta dërgojnë atë në Gjykatë për kontroll para ratifikimit.

22.4.2 Në lidhje me procedurën e ratifikimit, propozimi është bërë nga Emiratet e Bashkuara Arabe, që, nëpërmjet Ambasadës së Republikës së Shqipërisë ka përcjellë me notë verbale tekstin e marrëveshjes që do të negociohej, në përputhje me nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 43/2016. Ky komunikim i është përcjellë zyrtarisht MEPJ-së, dhe sipas nenit 9, pika 1, të ligjit nr. 43/2016, palët kanë negociuar në distancë duke shkëmbyer tekstet. Miratimi në parim i ka hapur rrugën komunikimit për detajet e nënshkrimit dhe zyrtarët nënshkrues, dhe ajo është nënshkruar sipas nenit 7 të Konventës së Vjenës dhe nenit 6, pika 5, të ligjit nr. 43/2016. Marrëveshja e nënshkruar është depozituar në MEPJ, sipas nenit 24 të ligjit nr. 43/2016 dhe palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme për hyrjen në fuqi, ku marrja e njoftimit të dytë shënon datën e hyrjes



në fuqi. Kërkuesi ka përdorur si referencë faqen zyrtare të Kuvendit, ku bëhet publikimi i dokumenteve të procedurës parlamentare, me qëllim rritjen e transparencës dhe informimit të publikut, ndërkohë që deputetët kërkues, edhe pse kanë të drejtë të kërkojnë dokumente shtesë, nuk e kanë bërë këtë as para ratifikimit të Marrëveshjes, as pas saj. Mendimet e të dyja ministrive nuk janë pjesë e dokumentacionit që publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit, por janë dokumente shoqëruese të projektligjit, të cilat i dorëzohen deputetëve para se të votojnë. MEPJ-ja dhe MD-ja kanë zbatuar detyrimin e tyre ligjor për dhënien e mendimit, ku kanë shprehur dakordësinë për miratimin dhe nuk kanë pasur asnjë vërejtje për përmbajtjen e Marrëveshjes.

22.4.3 Në lidhje me *pretendimin për cenimin e nenit 82, pika 1, të Kushtetutës*, kanë kaluar afro 2 vjet nga miratimi i ligjit ratifikues dhe fillimi i zbatimit të Marrëveshjes, dhe në buxhetin e shtetit për vitet 2021 dhe 2022 nuk është parashikuar asnjë implikim financiar i lidhur me to. Për çdo projekt të ardhshëm do të krijohen akte të tjera juridike, që, në varësi të situatave, mund të kenë edhe implikime financiare, për të cilat, në çdo rast, do të vendosin institucionet e shtetit shqiptar.

B) Për Marrëveshjen:

22.4.4 *Pretendimet për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike* vijnë si pasojë e moskuptimit ose keqkuptimit të qëllimshëm të Marrëveshjes, e cila nuk përcakton asnjë përfitues, por identifikon disa projekte që vlerësohen strategjike për të dyja palët lidhur me synimet e tyre për bashkëpunim ekonomik. Këto projekte janë objekt i negociatave mes palëve dhe shteti nuk është i detyruar të pranojë realizimin e ndonjërit prej tyre, nëse kjo nuk përbën interes për të. Pretendimet për referencën e gabuar të nenit 8 të marrëveshjes së vitit 2015 janë të paqarta dhe të pabazuara, pasi kjo dispozitë nuk është përdorur si referencë lejuese, por është një referencë mbrojtëse për investimet që do të mund të realizohen.

22.4.5 *Pretendimet për shkeljen e dispozitave të MSA-së* nuk janë ngritur në nivel kushtetues, pasi vlerësimi i ligjit nr. 145/2020 mund të bëhet vetëm në aspektin procedural, duke qenë ligj ratifikues, pra me karakter individual dhe jo ligj i zakonshëm. Gjykata nuk mund të kontrollojë

pajtueshmërinë e Marrëveshjes me një marrëveshje tjetër ndërkombëtare, siç është MSA-ja, që për nga hierarkia do të gjendet në të njëjtin nivel pas ratifikimit, sipas nenit 122 të Kushtetutës, edhe sikur ky pretendim të ishte paraqitur para ratifikimit.

22.4.6 Marrëveshja ka dispozita drejtpërdrejt të vetëzbatueshme, si dhe nga ato që për zbatimin kërkojnë ndërmarrjen e hapave të tjerë. Edhe legjislacioni i brendshëm parashikon miratimin me ligj të kontratave përfundimtare me investitorët strategjikë, të cilëve KIS-i u ka dhënë statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”. Ligji nr. 55/2015 është një garë e hapur pa limit kohe, por me kritere të rrepta e procedurë të mirëpërcaktuar dhe ofron mundësi për investitorët e huaj dhe vendas, që kanë propozime ambicioze dhe me ndikim, që të bëjnë propozimet e tyre pranë AIDA-s. Edhe *lex specialis* (nenet 6 dhe 35, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”) parashikon miratimin me ligj të kontratave të investimeve në të njëjtën linjë me ligjin për investimet strategjike. Po kështu, ligji për prokurimin publik në nenin 8, pika 1, parashikon se nuk zbatohet për kontrata publike dhe konkurse projektimi, të cilat autoriteti ose enti kontraktor është i detyruar t’i japë ose organizojë në përputhje me procedura prokurimi të ndryshme nga ato që përcaktohen në këtë ligj. Këto parashikime janë në përputhje me nenin 9 të direktivës nr. 2014/24 dhe nenet 70 dhe 74 të MSA-së.

22.4.7 Në lidhje me *pretendimin për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike*, kërkuesi i referohet një akti juridik që nuk mund t’i nënshtrohet vlerësimit të kushtetutshmërisë. Këto pretendime, për sa kohë që nuk janë paraqitur para se Kuvendi të miratonte ligjin nr. 145/2020, nuk mund të vlerësohen nga Gjykata. Për zbatimin e Marrëveshjes do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi, i cili është në përputhje me MSA-në dhe direktivat e BE-së.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

23. Kërkuesi ka parashtruar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të



Kushtetutës, është pranuar kontrolli kushtetues *ex ante* i marrëveshjeve ndërkombëtare, me qëllim që Kuvendi të mos lejojë ratifikimin e atyre që bien ndesh me Kushtetutën. Megjithatë, në kushtet e papërgjegjshmërisë së ekzekutivit, është Gjykata që duhet të garantojë respektimin e shtetit ligjor, pasi ajo ka një rol kryesor në procesin e anëtarësimit në BE dhe parashikimi i nenit 1 të MSA-së përbën bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji antikushtetues, përfshirë ligjin ratifikues. Referuar shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata nuk mund të shqyrtojë marrëveshjen ndërkombëtare pas ratifikimit, por ajo mund të bëjë kontrollin abstrakt të ligjit ratifikues, bazuar në shkronjën “a” të këtij neni dhe në rast se konstaton se ai është antikushtetues, bie edhe vetë marrëveshja. Ky qëndrim gjen mbështetje edhe në diskutimet në Komisionin Parlamentar për hartimin e projektkushtetutës, si dhe doktrinën kushtetuese.

24. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se referuar nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, ligji ratifikues dhe Marrëveshja nuk janë i njëjti akt dhe nuk mund të bëhen në asnjë moment një akt i vetëm. Marrëveshja është akt i së drejtës ndërkombëtare, kurse ligji është instrumenti përmes të cilit Kuvendi jep pëlqimin për të lidhur Shqipërinë në një marrëveshje ndërkombëtare. Duke mos pasur asnjë përmbajtje substanciale e duke qenë një akt i dallueshëm nga Marrëveshja, përjashtohet çdo mundësi e kontrollit substancial të pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. As Kushtetuta, as ligji organik i Gjykatës nuk parashikojnë juridiksionin e saj për kontrollin a posteriori (ex post) të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, por kontrolli i pajtueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën mund të kryhet vetëm para përfundimit të procedurave të ratifikimit, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës. Sipas tij, edhe referuar nenit 180 të Kushtetutës, lejohet kontrolli a posteriori (ex post) vetëm i atyre marrëveshjeve që janë ratifikuar para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

25. Sipas subjektit të interesuar, Këshilli të Ministrave, kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare mund të realizohet vetëm para ratifikimit të tyre, pasi jurisprudenca kushtetuese

në mënyrë të qartë ka ndarë ligjin ratifikues nga marrëveshja ndërkombëtare, duke i cilësuar si dy akte juridike që nuk vlerësohen së bashku. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, Gjykata nuk mund të ushtrojë kontroll të zakonshëm të pajtueshmërisë së ligjit ratifikues me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare, por vetëm në aspektet procedurale, sikurse mund të jetë vendimi i Kuvendit për miratimin e ligjit ratifikues (kuorumi, numri i votave). Kontrolli kushtetues i marrëveshjes ndërkombëtare ushtrohet vetëm a priori (ex ante) dhe, si i tillë, krijon efekte të menjëhershme në procedurën që zhvillon Kuvendi, duke e pezulluar atë dhe duke e bërë të pamundur zhvillimin e saj nëse Gjykata vendos papajtueshmërinë me Kushtetutën. Edhe sipas nenit 180, pika 2, të Kushtetutës, Gjykatës i është njohur ushtrimi i kontrollit a posteriori (ex post) vetëm për marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara para datës 28.11.1998, procedurë e saktësuar edhe në nenin 53 të ligjit nr. 8577/2000.

26. Referuar objektit të kërkesës në shqyrtim dhe pretendimeve të parashtruara nga kërkuksi, Gjykata vlerëson se ato kanë të bëjnë me procedurën e zhvilluar gjatë negocimit të Marrëveshjes nga Këshilli i Ministrave dhe atë të miratimit nga Kuvendi, si edhe me vetë përmbajtjen e saj. Në këtë drejtim, si dhe referuar prapësimeve të subjekteve të interesuara që kanë ngritur çështjen e juridiksionit kushtetues, është e nevojshme të konkludohet nëse Gjykata është kompetente në bazë të Kushtetutës për shqyrtimin e këtyre pretendimeve në këtë fazë të procesit.

27. Në lidhje me juridiksionin e saj Gjykata ka pohuar se ai e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, sipas të cilit: “1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.”. Kjo dispozitë kushtetuese përcakton funksionin themelor të Gjykatës, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese (shih vendimet nr. 38, datë 9.12.2022; nr. 36, datë 4.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese).



28. Neni 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “c”, të Kushtetutës kanë përcaktuar kompetencën e Gjykatës për të vendosur për pajtueshmërinë e ligjit dhe të akteve normative të organeve qendrore e vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Nga ana tjetër, sipas nenit 5 të Kushtetutës, Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, kurse sipas nenit 122 të Kushtetutës, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare dhe ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi kërkon nxjerrjen e një ligji. Në nenin 121 të Kushtetutës janë parashikuar rastet në të cilat ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me ligj, por duke njohur të drejtën e Kuvendit që të ratifikojë edhe marrëveshje të tjera që nuk listohen në mënyrë të shprehur në këtë dispozitë. Neni 122, pika 2, parashikon se një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të dhe në piramidën e akteve normative, sipas nenit 116 të Kushtetutës, që përcakton marrëdhëniet midis normave juridike në bazë të raportit të mbi/nënvendosjes së tyre, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara janë radhitur në hierarkinë e akteve normative nën Kushtetutën, por mbi ligjet dhe aktet e tjera normative.

29. Gjykata vëren se renditja dhe klasifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare përcaktohet nga Kushtetuta, e cila rregullon edhe raportin ndërmjet së drejtës ndërkombëtare dhe asaj kombëtare. Në këtë kuptim, në rendin tonë juridik marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi, jo vetëm që nuk janë të renditura në të njëjtin nivel me ligjet, por ato janë përcaktuar nga kushtetutëbërësi edhe si kritere të kontrollit kushtetues të ligjeve dhe akteve të tjera normative. Duke pasur parasysh se efektiviteti dhe zbatueshmëria e së drejtës ndërkombëtare në rendin e brendshëm përcaktohet nga vetë Kushtetuta, në rastet kur një marrëveshje ndërkombëtare kërkon ndërhyrjen nga Kuvendi nëpërmjet një ligji me qëllim bërjen e saj efektive sipas nenit 122 të Kushtetutës, një gjë e tillë u jep marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj përparësi mbi ligjet e zakonshme. Për

rrjedhojë, nëse një ligj i zakonshëm do të bjerë ndesh me një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar me ligj, do të konsiderohet se cenohet parimi i hierarkisë së normave.

30. Për sa më sipër, rezulton se Kushtetuta ka zgjedhur konceptin monist në marrëdhëniet mes së drejtës kombëtare dhe asaj ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, dispozitat kushtetuese kanë përcaktuar një hierarki të normave juridike, të detyrueshme për t'u zbatuar nga gjykatat dhe organet e tjera, sipas së cilës marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj bëhen pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe kanë epërsi në krahasim me ligjet e zakonshme. Referuar këtij koncepti, normat e marrëveshjes ndërkombëtare nuk inkorporohen në tekstin e aktit juridik ratifikues në substancë, me qëllim transferimin e tyre në rendin e brendshëm. Ligji ratifikues, si rregull, sikurse dhe në rastin konkret, përmban vetëm një nen, ku shprehet për marrëveshjen që ratifikon dhe hyrjen e saj në fuqi, ndërkohë që teksti i marrëveshjes i bashkëlidhet dhe bëhet pjesë përbërëse e tij. Për rrjedhojë, statusi i marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar nuk barazohet me atë të aktit juridik që i jep asaj efektivitet në rendin e brendshëm ligjor. Ky akt juridik nuk parashikohet të ushtrohet në çdo rast që shteti shqiptar vendos të hyjë në marrëdhënie ndërkombëtare, por vetëm në rastet e përcaktuara nga pikat 1 dhe 2 të nenit 121 të Kushtetutës, pra në varësi të natyrës së marrëveshjes ose kur e vlerëson vetë Kuvendi.

31. Në kuadër të procesit parlamentar që çon në miratimin e ligjit ratifikues, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend (sidomos pakica parlamentare) jo vetëm që ushtrojnë përgjegjësinë kushtetuese të kontrollit të kushtetutshmërisë së marrëveshjes ndërkombëtare që propozohet të ratifikohet, por, duke u njohur në detaj me brendinë e marrëveshjes, ato mund të arrijnë në përfundimin se ajo (marrëveshja) bie ndesh me Kushtetutën dhe kësaj mund të ndërmarrin nismën për fillimin e kontrollit paraprak (*ex ante*) të kushtetutshmërisë së marrëveshjes ndërkombëtare dhe të kërkojnë nga Gjykata që të verifikojë çdo dyshim në lidhje me pajtueshmërinë e saj me parimet kushtetuese ose të drejtat e liritë themelore të njeriut.

32. Duke pasur parasysh sa më sipër, për sa kohë që marrëveshjet ndërkombëtare të



ratifikuara për nga renditja e tyre në sistemin e brendshëm ligjor nuk barazohen me ligjet e zakonshme, për rrjedhojë edhe vetë ligji ratifikues është një akt juridik i mëvetshëm. Në një interpretim *a contrario*, nëse do të pranohej se marrëveshja ndërkombëtare dhe ligji ratifikues janë i njëjti akt juridik, një qasje e tillë do të bënte të humbte kuptimin parashikimi kushtetues që lejon kontrollin e pajtueshmërisë së ligjeve me marrëveshjet ndërkombëtare.

A.1 Për Marrëveshjen ndërkombëtare

33. Gjykata vlerëson të nevojshme të theksojë paraprakisht se në përcaktimin e juridiksionit të saj në çështje të caktuara, ajo bazohet në: i) përmbajtjen e dispozitave kushtetuese; ii) jurisprudencën kushtetuese relevante, në interpretim dhe zbatim të tyre.

34. Për sa i përket përmbajtjes së normave kushtetuese, në lidhje me kontrollin kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare, Gjykata vëren se dy janë rastet për të cilat Kushtetuta ka parashikuar në mënyrë të shprehur juridiksionin kushtetues në këtë drejtim. Rasti i parë i referohet atij të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “b”, i Kushtetutës, që parashikon kompetencën e Gjykatës për kontrollin e kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre. Rasti i dytë, i parashikuar nga neni 180, pika 2, i Kushtetutës, lejon kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, duke përcaktuar se Këshilli i Ministrave i paraqet Gjykatës marrëveshjet ndërkombëtare të cilat përmbajnë dispozita që bien në kundërshtim me këtë Kushtetutë. Kjo dispozitë kushtetuese me natyrë kalimtare ka rregulluar momentin e kalimit nga një sistem në një tjetër, duke parashikuar mënyrën e zbatimit të dispozitave të reja në lidhje me situatat faktike ose marrëdhëniet ekzistuese. Pikërisht, një rregullim i tillë kushtetues evidenton qartë se për sa u përket kufijve të kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare, një kontroll paraprak i përgjithshëm (*ex ante*), që vihet në lëvizje nga subjektet e përcaktuara dhe vetëm para ratifikimit të tyre, mbetet një çështje thelbësore e juridiksionit të Gjykatës (shih Debatë Kushtetues, Vëllimi II, faqet 19-21).

35. Gjykata vlerëson se kontrolli i kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre, midis të tjerash, synon të garantojë seriozitetin e shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare në linjë me parimin themelor të së drejtës ndërkombëtare *pacta sunt servanda*. Ky parim i së drejtës ndërkombëtare publike, i kodifikuar në Konventën e Vjenës, është një gur themeli në rendin ligjor ndërkombëtar, që synon t’u japë siguri juridike shteteve dhe subjekteve të tjera të përfshira në marrëdhënie ndërkombëtare se marrëveshjet e arritura do të respektohen. Gjykata thekson se Konventa e Vjenës përcakton dy kritere kryesore në sferën e zbatimit të traktateve ndërkombëtare, parimin e *pacta sunt servanda* (neni 26), sipas të cilit çdo traktat në fuqi është detyrues për palët dhe duhet të kryhet prej tyre në mirëbesim, dhe parimin se një palë nuk mund të përdorë dispozitat e së drejtës së brendshme si justifikim për pamundësinë e tij për të zbatuar një traktat (neni 27).

36. Gjykata nuk ka shqyrtuar më parë kërkesa me objekt kontrollin e kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare pas ratifikimit të tyre nga Kuvendi. Përkundrazi, në kuptim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata vëren se ajo është vënë më parë në lëvizje për kontrollin e kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit nga Kuvendi, siç ka qenë rasti i kontrollit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të “Statutit të Romës” për Gjykatën Ndërkombëtare Penale (shih vendimin nr. 186, datë 23.9.2002 të Gjykatës Kushtetuese) ose të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë, “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare” (shih vendimin nr. 15, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese). Sipas jurisprudencës kushtetuese, vetëm kontrolli paraprak i marrëveshjes ndërkombëtare nuk cenon Konventën e Vjenës, pasi ky kontroll realizohet para se ajo të ratifikohet nga Kuvendi, sipas nenit 121 të Kushtetutës, në përputhje me të drejtën e brendshme shqiptare. Për rrjedhojë, në këto raste nuk kemi të bëjmë me shmangje nga detyrimet që vijnë si pasojë e lidhjes së një marrëveshjeje ndërkombëtare në përputhje me



rregullat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare publike dhe në veçanti të parimit *pacta sunt servanta* (shih vendimin nr. 15, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

37. Gjykata vëren se nuk ka asnjë dispozitë tjetër kushtetuese që të përcaktojë kompetencën e saj për kontrollin e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën, përveç shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës. Sipas nenit 124, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata i nënshtrohet vetëm kësaj të fundit dhe përderisa një kompetencë e tillë nuk është parashikuar shprehimisht në Kushtetutë, nuk mund të ushtrohet prej saj. Gjykata rithekson se kompetencat e saj nuk mund të ndryshohen, të ngushtohen ose të zgjerohen, përveçse me ligj kushtetues (*shih vendimet nr. 36, datë 4.11.2021; nr. 212, datë 29.10.2002; nr. 34, datë 24.9.1996 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në juridiksionin kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës, përfshihet kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare vetëm para ratifikimit të tyre me ligj nga Kuvendi. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se dispozitat kushtetuese nuk i njohin asaj në mënyrë të shprehur dhe të drejtpërdrejtë kompetencën për të vendosur për kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare pas ratifikimit dhe pasi ato bëhen pjesë e rendit të brendshëm juridik.

38. Në këtë kuptim, për sa kohë që në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë kushtetuese kishte hyrë në fuqi ligji ratifikues nr. 145/2020, Gjykata vlerëson se ky është një fakt juridik që pamundëson kontrollin kushtetues të Marrëveshjes sipas nenit 131, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës. Duke iu referuar më tej edhe përmbajtjes së dispozitave të ligjit nr. 8577/2000, në pjesën që rregullon procedurat e gjykimit kushtetues, konstatohet se si procedura të gjykimit kushtetues ai ka parashikuar vetëm ato që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit, duke përcaktuar subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën, afatet e shqyrtimit dhe vendimmarrjen e saj (nenet 52 dhe 52/a). Kurse në nenin 53 të këtij ligji gjen reflektim i njëjti parashikim i nenit 180 të Kushtetutës, sipas të cilit lejohet kontrolli *ex post* vetëm i atyre

marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, duke përcaktuar si subjekt që mund të vinte në lëvizje këtë proces Këshillin e Ministrave.

39. Gjykata rithekson se gjatë procedurës parlamentare, deputetët, ashtu si edhe çdo subjekt tjetër kushtetues që i njihet e drejta e nismës për fillimin e kontrollit paraprak të marrëveshjeve ndërkombëtare sipas nenit 134 të Kushtetutës dhe nenit 52, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, kanë të gjitha mundësitë që të vënë në lëvizje Gjykatën për ushtrimin e juridiksionit të saj kushtetues sipas nenit 131, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës. Gjykata konstaton se ekzistojnë mekanizmat e duhur politikë dhe juridikë për të garantuar shtetin e së drejtës. Këto mekanizma mund dhe duhet të ushtrohen, duke respektuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Mospërdorimi i tyre në mënyrën dhe kohën e duhur nuk mund të përbëjë shkak për zgjerimin e juridiksionit të Gjykatës në lidhje me kontrollin e kushtetutshmërisë së marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar tashmë, me argumentin e rolit të saj si garantuese e shtetit ligjor nga papërgjegjshmëria e ekzekutivit. Për rrjedhojë, argumenti i kërkuarit, mbi të cilin ai kërkon ushtrimin e juridiksionit kushtetues pas ratifikimit të Marrëveshjes, në rastin konkret nuk gjen mbështetje kushtetuese.

40. Për sa më sipër, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, që përbën edhe bazën ligjore të përcaktuar nga vetë kërkuari në mbështetje të kësaj kërkesë, çështja e kontrollit të kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare pas ratifikimit të tyre nuk përfshihet në kategoritë e çështjeve për të cilat Gjykata ka juridiksion për të vendosur. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit që kanë të bëjnë me përmbajtjen e Marrëveshjes, përkatësisht ato në lidhje me cenimin e: i) identitetit kombëtar, për shkak të historisë 3000-vjeçare të Portit të Durrësit; ii) parimit të shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike, pasi synohet hyrja në negociata me të përzgjedhurin e selektuar paraprakisht për të tjetërsuar një tokë publike për investim; iii) parimit të barazisë para ligjit dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike, pasi, në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, është përcaktuar një trajtim preferencial i shoqërive shtetërore ose



private të propozuara nga palët e Marrëveshjes, pa një procedurë konkurrimi të hapur dhe transparente; iv) parashikimeve të MSA-së, pasi nuk lejohet një proces konkurrimi i hapur dhe transparent, nuk mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues. Në këtë këndvështrim, për të njëjtën arsye, Gjykata vlerësoi të mos trajtojë as pretendimin e kërkuarit lidhur me natyrën e Marrëveshjes, pra nëse ajo përfshihet nën rregullimet e pikës 1 të nenit 121 të Kushtetutës apo të pikës 2 të tij, sikundër kanë prapësuar subjektet e interesuara, për sa kohë në këtë rast jemi para një marrëveshjeje të ratifikuar tashmë me ligj nga Kuvendi. Po kështu, edhe pretendimet e kërkuarit për cenimin e neneve 4 dhe 7 të Kushtetutës, për shkak se nuk është përfshirë kreu i shtetit në procedurën e negociimit dhe miratimit të Marrëveshjes edhe pse ajo, sipas tij, konsiderohet si një marrëveshje me karakter politik, që lidhet me integritetin territorial dhe prek fusha nevrologjike të ekonomisë, pavarësisht se janë paraqitur si shkaqe për kundërshtimin e ligjit nr. 145/2020, ato përthithen nga pretendimet që kanë të bëjnë me procedurën për negociimin dhe miratimin e Marrëveshjes, për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues për sa kohë janë ngritur pas ratifikimit të marrëveshjes ndërkombëtare.

A.2. Për ligjin ratifikues

41. Gjykata thekson se edhe pse Kushtetuta ndalon kontrollin kushtetues të marrëveshjes ndërkombëtare pas ratifikimit të saj, nga ky lloj kontrolli, ashtu si edhe për çdo ligj tjetër, nga pikëpamja formale, nuk mund të ketë përjashtim për aktin ratifikues të Kuvendit. Sikurse u parashtrua edhe më lart, pavarësisht se marrëveshja ndërkombëtare i bashkëlidhet ligjit ratifikues dhe është pjesë përbërëse e tij, kjo nuk u jep dispozitave të saj karakterin juridik të normave të ligjit ratifikues. Anasjelltas, vetëm për shkak se akti ratifikues përmban bashkëlidhur edhe tekstin e marrëveshjes, duke e bërë pjesë të tij, ai nuk merr vlerën juridike të marrëveshjes ndërkombëtare. Ndaj akti për ratifikimin dhe vetë marrëveshja ndërkombëtare, miratimi i së cilës konfirmohet nga i pari, nuk janë i njëjti akt juridik. Në një interpretim *a contrario*, nëse Gjykata do të pranonte që janë i njëjti akt juridik, duke vlerësuar se ka juridiksion vetëm për kontrollin *ex ante* të marrëveshjes ndërkombëtare,

atëherë ligji ratifikues do të mbetej jashtë kontrollit kushtetues, çka do të binte ndesh me parimet e shtetit të së drejtës që kërkon kontrollin e ligjeve. Rrjedhimisht, referuar nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare nuk mbetet jashtë juridiksionit kushtetues.

42. Nga ana tjetër, Gjykata thekson se pohimi se ajo ka juridiksion për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit ratifikues të marrëveshjes ndërkombëtare nuk nënkupton që në këtë juridiksion përfshihet edhe vetë marrëveshja, përmbajtja e saj substanciale për shkak të qenies pjesë përbërëse e tij. Kjo sepse ligjvënësi mund ta miratojë një marrëveshje ndërkombëtare në tërësinë e saj ose të mos e miratojë atë, por ai nuk mund ta ndryshojë/ modifikojë tekstin e saj, i cili i bashkëlidhet ligjit në formë të plotë, ashtu siç është miratuar nga palët në marrëveshje. Edhe pas ratifikimit dhe hyrjes së saj në fuqi, dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare nuk mund të ndryshohen ose shfuqizohen me një akt të Kuvendit, por referuar Konventës së Vjenës, “Për të drejtën e traktateve”, një gjë e tillë mund të ndodhë vetëm në kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar nga vetë ajo ose në përputhje me rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Në rastin kur marrëveshja ndërkombëtare nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji, vetëm ky i fundit mund të jetë objekt ndryshimi, plotësimi ose shfuqizimi nga ligjvënësi. Ndaj, nisur nga natyra e veçantë dhe përmbajtja, si rregull, e ligjit ratifikues si një akt juridik i shprehjes së pëlqimit nga Republika e Shqipërisë për të qenë palë në një marrëveshje ndërkombëtare, por edhe në respektim të parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, në veçanti të rregullit *pacta sunt servanda*, juridiksioni i Gjykatës për kontrollin kushtetues të ligjit ratifikues të marrëveshjes ndërkombëtare nuk mund të jetë i pakufizuar. Në raste të kësaj natyre, ky juridiksion kufizohet vetëm në aspektin formal, konkretisht në verifikimin nëse shprehja e pëlqimit të Republikës së Shqipërisë për të qenë palë në marrëveshjen ndërkombëtare, është bërë në cenim të qartë dhe objektivisht të dukshëm të një rregulli të së drejtës së brendshme të një rëndësie thelbësore, domethënë në vlerësimin



nëse ligji ratifikues është miratuar nga organi kompetent sipas procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.

43. Për rrjedhojë, në lidhje me mundësinë e kontrollit ex post të ligjit që ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare, Gjykata e trajton juridiksionin e saj në drejtim të kompetencës për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e ligjit të brendshëm për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës, vetëm në aspektin formal, i cili shtrihet në drejtim të procedurës parlamentare për miratimin e tij. Gjykata vlerëson se për sa kohë ligji ratifikues i kundërshtuar përmban vetëm shprehjen e pëlqimit nga Republika e Shqipërisë për të qenë palë në marrëveshjen ndërkombëtare, kontrolli i saj kufizohet vetëm në kuptim të respektimit të procedurave kushtetuese të miratimit të tij dhe nuk mund të shtrihet mbi Marrëveshjen si pjesë përbërëse të ligjit ratifikues, pasi nga pikëpamja kushtetuese kjo do të nënkuptonte kontrollin e vetë marrëveshjes ndërkombëtare. Në kushtet kur vlerësoi se kontrolli kushtetues i ligjit ratifikues nuk përjashtohet nga juridiksioni kushtetues, Gjykata do të ndalet në vijim në verifikimin e kriterëve të tjera ligjore për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

B. Për legjitimitimin e kërkuarit

B.1 Për legjitimitimin racione personae

44. Gjykata vëren se subjekti kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve përfaqëson një subjekt të pakushtëzuar, i cili nuk ka nevojë të provojë interesin e tij të drejtpërdrejtë në lidhje me çështjen në shqyrtim, për shkak të interesit publik që mbart, për rrjedhojë kërkuari legjitimohet *racione personae* të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së akteve normative të kundërshtuara.

45. Për sa i takon legjitimitetin formal të kërkuarit, Gjykata konstaton se kërkesa me të cilën është vënë në lëvizje procesi kushtetues është paraqitur më datë 11.11.2022, nga një grup prej 36 deputetësh të Kuvendit, të cilët përbëjnë subjektin kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000. Gjatë shqyrtimit të kërkesës u konstatua se disa prej deputetëve

nënshkruar të saj kanë dhënë dorëheqjen nga mandati i deputetit dhe në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, janë zëvendësuar me vendimet përkatëse të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për rrjedhojë, në momentin që çështja ishte për shqyrtim në seancë plenare, këta deputetë nënshkruar të kërkesës nuk e gëzonin më këtë status.

46. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson se verifikimi i kriterëve formale të pranueshmërisë së kërkesës, pra edhe verifikimi i numrit të deputetëve që i drejtohen asaj (jo më pak se një e pesta e deputetëve), realizohet në momentin e vënies në lëvizje të kontrollit kushtetues dhe ky kriter është plotësuar nga kërkuari. Po kështu, edhe në momentin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare ky kriter ka rezultuar i plotësuar, për sa kohë që kërkuari ka ruajtur përsëri numrin e kërkuar nga dispozita kushtetuese, neni 134, pika 1, shkronja “c”, i Kushtetutës (shih vendimin nr. 21, datë 18.4.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

47. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *racione personae* të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit.

B.2. Për legjitimitimin racione temporis

48. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se kërkuari nuk legjitimohet *racione temporis*. Ai ka pasur mundësinë t'i drejtohet Gjykatës për kundërshtimin e Marrëveshjes para ratifikimit, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës, ndërkohë që me ratifikimin e saj humb e drejta e subjekteve që të kërkojnë shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën. Kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 11.11.2022, në një kohë kur Marrëveshja është ratifikuar afro 2 vjet më parë, më 3.12.2020 me ligjin nr. 145/2020, i cili ka hyrë në fuqi më 24.1.2021. Për rrjedhojë, kërkesa me këtë objekt është jashtë afatit kushtetues sipas nenit 131, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës.

49. Gjykata rithekson se Marrëveshja dhe akti ratifikues i saj janë dy akte të veçanta juridike dhe se për kundërshtimin e ligjit ratifikues, për sa kohë që ai është pjesë e juridiksionit kushtetues, gjejnë zbatim të njëjtat kriterë ligjore që zbatohen për kundërshtimin e akteve normative si të papajtueshme me Kushtetutën. Sipas nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen



e kërkesës është 2 vjet nga hyrja në fuqi e aktit (ligjit ose të akteve të tjera normative). Në rrethanat kur afati i zbatueshëm për paraqitjen e kërkesës për kontrollin kushtetues edhe të ligjit ratifikues është 2 vjet, Gjykata konstaton se kërkesa në rastin konkret konsiderohet se është paraqitur brenda afatit ligjor. Ligji nr. 145/2020 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 8.1.2021 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 11.11.2022, për rrjedhojë kërkuksi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

B.3 Për legjitimitimin *ratione materiae*

50. Sipas kërkuksit, janë cenuar Konventa e Vjenës, si dhe nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës në procedurën e negocimit dhe miratimit të Marrëveshjes dhe ratifikimit të saj. Në thelb, ai ka pretenduar se është anashkaluar Presidenti, edhe pse referuar raportit të Komisionit të Ligjeve është përcaktuar si bazë kushtetuese shkronja “ç” e pikës 1 të nenit 121, duke pranuar kështu se marrëveshja është politike. Po kështu, kërkuksi ka pretenduar cenimin e nenit 82, pika 1, të Kushtetutës, pasi projektligji nuk është shoqëruar me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij. Në nenin 6 të Marrëveshjes janë përcaktuar projektet ku do të investohet, ndaj duhej të ishin përcaktuar lloji i projektit dhe fatura financiare për zhvillimin e tij. Fakti që kjo Marrëveshje do të implementohet me marrëveshje të tjera specifike zbatimi për secilin projekt, tregon se ndikimi në buxhetin e shtetit jo vetëm është i pashmangshëm, por mënyra si është vepruar, pa një studim paraprak lidhur me ndikimet në të ardhmen, investimet dhe dobishmërinë, ngre alarmin se ndikimi do të jetë shumë negativ. Kjo jep premisa për ndikime negative jo vetëm në nivelin e borxhit, por në të gjithë situatën financiare në tërësi. Po sipas kërkuksit, referuar parashikimeve të ligjit nr. 43/2016, procedura për lidhjen e marrëveshjes nuk është bërë transparente në aktet parlamentare, referuar të dhënave të faqes zyrtare, si dhe mungon mendimi i MEPJ-së dhe MD-së, që sipas shkronjës “dh” të nenit 17 të ligjit nr. 43/2016 është i detyrueshëm.

51. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit, ai mund të ratifikojë me ligj edhe marrëveshje që nuk parashikohen në paragrafin e parë të nenit 121 të Kushtetutës. Në rastin konkret janë

respektuar kriteret e parashikuara në lidhje me negocimin, nënshkrimin dhe ratifikimin e marrëveshjes, por edhe nëse hipotetakisht do të pranohej se ka pasur ndonjë shkelje gjatë negocimit dhe nënshkrimit, çdo lloj parregullsie është rregulluar me ratifikimin e saj nga Kuvendi. Referimi në nenin 46 të Konventës së Vjenës nuk ka vend në këtë rast, pasi kjo dispozitë kërkon që shkelja e pretenduar të jetë e qartë dhe të kishte të bënte me një rregull të së drejtës së brendshme të një rëndësie thelbësore, çka nuk është provuar në rastin konkret. Në lidhje me pretendimin për nenin 82, pika 1, të Kushtetutës, marrëveshja e ratifikuar me ligjin nr. 145/2020 është marrëveshje kuadër dhe nuk ka efekte financiare, por synon krijimin e bazës ligjore ndërmjet palëve, me qëllim sigurimin e bashkëpunimit ekonomik në fushat ekonomike të përcaktuara në nenin 2 të saj. Çdo marrëveshje tjetër specifike që do të negociohet dhe nënshkruhet mbi bazën e saj do të trajtohet e miratohet më vete dhe do të përmbajë, nëse është rasti, edhe efektet financiare.

52. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se, bazuar në nenin 121, pika 2, të Kushtetutës, në nenin 9 të Marrëveshjes është përcaktuar hyrja në fuqi me ratifikimin nga parlamenti, duke u marrë parasysh në këtë rast kriteri subjektiv, pra vullneti i palëve. Në lidhje me pretendimin për nenin 82 të Kushtetutës, edhe pse kanë kaluar afro 2 vjet nga miratimi i ligjit ratifikues dhe fillimi i zbatimit të Marrëveshjes, në buxhetin e shtetit për vitet 2021 dhe 2022 nuk është parashikuar asnjë implikim financiar që lidhet me to. Për çdo projekt të ardhshëm do të krijohen akte të tjera juridike që, në varësi të situatave, do të mund të kenë edhe implikime financiare, për të cilat, në çdo rast, do të jenë institucionet e shtetit shqiptar që do të vendosin. Kurse për sa u përket pretendimeve për mungesën e mendimit të MEPJ-së dhe MD-së, kërkuksi ka përdorur si referencë faqen zyrtare të Kuvendit, ku janë publikuar dokumentet e projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërkohë që mendimet e dy ministrave nuk janë pjesë e dokumentacionit që publikohet në faqen zyrtare, por dokumente shoqëruese të projektligjit, të cilat u dorëzohen deputetëve para se të votojnë. MEPJ-ja dhe MD-ja kanë zbatuar detyrimin e tyre ligjor për



dhënien e mendimit, ku kanë shprehur dakordësinë për miratimin e Marrëveshjes dhe nuk kanë pasur asnjë vërejtje për përmbajtjen e saj. Deputetët kërkues, edhe pse kanë të drejtë të kërkojnë dokumente shtesë, nuk e kanë bërë as para ratifikimit të Marrëveshjes, as pas saj.

53. Gjykata vëren se sipas nenit 121, pika 1, të Kushtetutës ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj në rastet e përcaktuara shprehimisht prej saj. Ndërsa sipas pikës 2 të këtij neni, Kuvendi, me shumicën e të gjithë anëtarëve, mund të ratifikojë edhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare që nuk parashikohen në paragrafin 1 të këtij neni. Ndërsa sipas pikës 4, norma kushtetuese i ka deleguar ligjvënësit të rregullojë me ligj parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe denoncimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

54. Gjykata vlerëson të theksojë se neni 121, pika 1, i Kushtetutës ka përcaktuar në mënyrë të qartë kategoritë e marrëveshjeve ndërkombëtare që kërkojnë domosdoshmërisht ratifikimin e tyre me ligj nga Kuvendi. Megjithatë, kjo dispozitë nuk është kufizuese në lidhje me veprimtarinë kushtetuese të Kuvendit, për sa kohë që norma kushtetuese i ka lënë atij hapësirën të vlerësojë dhe të ratifikojë me ligj marrëveshje të një natyre të ndryshme nga ato që parashikohen në pikën 1, që i paraqiten sipas ligjit nr. 43/2016. Ndërsa ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare sipas pikës 1 është detyrues për të dhe Kuvendi nuk mund të shmanget ose të ketë diskrecion për zbatimin e saj, në rastin e pikës 2 të këtij neni kjo çështje i përket vlerësimit të këtij organi, pa përcaktuar norma kushtetuese kufizime të tjera përtej parashikimeve të pikës 1 dhe shumicës së votave për vendimmarrjen.

55. Në drejtim të ligjit ratifikues, pra të procedurës parlamentare të zhvilluar nga Kuvendi, kërkuesi ka pretenduar se qeveria e ka kaluar si një marrëveshje bashkëpunimi ekonomik pa implikime financiare dhe territoriale, edhe pse ajo është një marrëveshje me karakter politik. Gjykata vlerëson se këto pretendime, edhe pse janë orientuar drejt përmbajtjes së nenit 82, pika 1, të Kushtetutës, në lidhje me respektimin e kësaj dispozite kushtetuese për sa i përket shoqërimit të ligjit të propozuar me raportin që përligj shpenzimet

financiare për zbatimin e tij, në thelb kanë të bëjnë me natyrën e Marrëveshjes, në kuptim të përfshirjes së saj në fushëveprimin e nenit 121, pika 1, të Kushtetutës dhe jo me ligjin ratifikues të saj. Për rrjedhojë, ato nuk mund të jenë objekt i këtij gjykimi kushtetues (shih paragrafin 40 supra).

56. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se referuar procesverbalit të seancës plenare të datës 3.12.2020, ligji nr. 145/2020 është miratuar me 92 vota. Gjykata konstaton se në nenin 78 të Kushtetutës është përcaktuar kuorumi dhe shumica e nevojshme e votave të anëtarëve të Kuvendit për vendimmarrjen e tij (i referuar si bazë ligjore edhe në aktet e procedurës parlamentare), si rregull i përgjithshëm që gjen zbatim për sa kohë Kushtetuta nuk parashikon një rregullim të ndryshëm. Ndërsa referuar përmbajtjes së pikës 2 të nenit 121 të Kushtetutës, ajo ka parashikuar një shumicë të të gjithë anëtarëve të Kuvendit për ratifikimin e marrëveshjeve që nuk përfshihen në pikën 1 të kësaj dispozite. Edhe pse në rastin konkret nuk është vënë në diskutim baza kushtetuese e vendimmarrjes së Kuvendit, në drejtim të kuorumit dhe numrit të votave të nevojshme për miratimin e ligjit ratifikues, rezulton se kërkesat e nenit 121 të Kushtetutës përmbushen.

57. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundim se procedura e zhvilluar nga Kuvendi në këtë rast nuk cenon parimet dhe standardet kushtetuese, për rrjedhojë pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim janë të pabazuara.

58. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa në shqyrtim duhet të rrëzohet sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe nenet 52, 52/a, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,



VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 16.6.2023.

Shpallur, më 12.7.2023.

Kryetar: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Elsa Toska, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtare kundër: Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen nr. 7 (Nj.) 2022 të Regjistrimit Themeltar, me kërkesë jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, nuk ndaj qëndrim të njëjtë me shumicën, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi ka arritur në përfundimin se në lidhje me kontrollin në substancë të marrëveshjes ndërkombëtare kjo Gjykatë nuk ka juridiksion, kurse në lidhje me procedurën e zhvilluar nga Kuvendi për miratimin e ligjit ratifikues i ka gjetur pretendimet e kërkesës të pabazuara, duke vlerësuar se në këtë rast nuk janë cenuar parimet dhe standardet kushtetuese.

2. Në lidhje me çështjen e juridiksionit të Gjykatës, shumica ka vlerësuar se normat e marrëveshjes ndërkombëtare nuk inkorporohen në tekstin e aktit juridik ratifikues në substancë me qëllim transferimin e tyre në rendin e brendshëm. Ligji ratifikues, si rregull, sikurse dhe në rastin konkret, përmban vetëm një nen, ku shprehet për marrëveshjen që ratifikon dhe hyrjen e saj në fuqi, ndërkohë që teksti i marrëveshjes i bashkëlidhet dhe bëhet pjesë përbërëse e tij. Për rrjedhojë, statusi i marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar nuk barazohet me atë të aktit juridik që i jep asaj efektivitet në rendin e brendshëm ligjor (*shih paragrafin 30 të vendimit*). Ajo ka vlerësuar se në juridiksionin kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës, përfshihet kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare vetëm para ratifikimit të tyre me ligj nga Kuvendi dhe se dispozitat kushtetuese

Faqe | 11166

nuk i njohin asaj në mënyrë të shprehur dhe të drejtpërdrejt kompetencën për të vendosur për kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare pas ratifikimit dhe pasi ato bëhen pjesë e rendit të brendshëm juridik (*shih paragrafin 37 të vendimit*). Në lidhje me ligjin ratifikues, ajo ka vlerësuar se akti për ratifikimin dhe vetë marrëveshja ndërkombëtare, miratimi i së cilës konfirmohet nga i pari, nuk janë i njëjti akt juridik. Rrjedhimisht, referuar nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, vlerësimi i kushtetutshmërisë së këtij akti nuk mbetet jashtë juridiksionit kushtetues (*shih paragrafin 41 të vendimit*).

3. Në lidhje me sa më sipër, unë ndaj qëndrim tërësisht të ndryshëm me shumicën, pasi në vlerësimin tim, jo vetëm që marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj nuk mund të përjashtohen nga kontrolli kushtetues, por edhe referuar pretendimeve të paraqitura nga kërkesesi vlerësoj se ato janë të bazuara edhe në themel, për rrjedhojë vënë në dyshim kushtetutshmërinë e të gjithë procedurës së zhvilluar për miratimin dhe ratifikimin e Marrëveshjes.

4. Duke iu referuar përmbajtjes së normave kushtetuese, vërehet se ato kanë bërë dallim brenda kategorisë së marrëveshjeve ndërkombëtare mes atyre që ratifikohen me ligj dhe atyre për të cilat nuk është e nevojshme kalimi në procedurën parlamentare, duke parashikuar, për këto të fundit, vetëm detyrimin e Kryeministrit që të njoftojë Kuvendin sa herë që Këshilli i Ministrave nënshkruan një marrëveshje të tillë. Duke pasur parasysh këtë, vlerësoj se shumica, nëpërmjet qëndrimit të saj, *së pari*, ka bërë dallimin mes kontrollit të kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara dhe të atyre që nuk ratifikohen nga Kuvendi dhe, *së dyti*, duke pasur parasysh parashikimet e nenit 121, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ka krijuar premisat që në të ardhmen Kuvendi të ratifikojë çdo marrëveshje ndërkombëtare që ai synon t’ia shmangë kontrollit kushtetues.

5. Në vlerësimin tim si gjyqtare në pakicë, Gjykata ka juridiksion për të kontrolluar kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës, i cili është rregulli i përgjithshëm që përcakton juridiksionin kushtetues për kontrollin e akteve



ligjore. Po kështu, edhe pse Kushtetuta ka përcaktuar në nenin 131, pika 1, shkronja “b”, në mënyrë të posaçme kontrollin paraprak të marrëveshjeve ndërkombëtare, kjo dispozitë nuk mund të interpretohet se kufizon kontrollin kushtetues të këtyre akteve, por përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i kontrollit *a posteriori* të akteve ligjore. Kjo, sepse, si rregull, Gjykata shqyrton kushtetutshmërinë e akteve ligjore pas hyrjes së tyre në fuqi dhe pasi bëhen pjesë e rendit të brendshëm juridik. Si përjashtim nga ky rregull, Gjykata, vetëm në rastin e shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, ka kompetencën që të shqyrtojë kushtetutshmërinë e një akti përpara se ai të bëhet pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe të sjellë pasoja, duke pasur parasysh natyrën e detyrimeve që lindin prej tij dhe të marrëdhënieve që krijohen në të tilla raste.

6. Edhe pse formalisht ndodhemi përpara dy akteve juridike të veçanta, nga njëra anë marrëveshja ndërkombëtare që ndjek një procedurë të caktuar dhe, nga ana tjetër, ligji i organit ligjvënës për ratifikimin e saj, marrëveshja ndërkombëtare bëhet pjesë e rendit të brendshëm vetëm për shkak se inkorporohet në aktin ratifikues, pra si pjesë e tij, jo si akt i veçantë juridik, që ndjek një procedurë miratimi dhe shpallje e botimit më vete. Është ligji i zakonshëm, që duke e bërë pjesë të tij marrëveshjen ndërkombëtare, i jep asaj vlerën juridike dhe e fut në rendin e brendshëm juridik, i cili është edhe momenti prej nga ajo fillon të prodhojë efekte.

7. Sipas nenit 122, pika 1, të Kushtetutës çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar bëhet pjesë e sistemit të brendshëm juridik pas botimit në Fletoren Zyrtare, kurse sipas nenit 117, pika 3, të Kushtetutës marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj shpallen dhe botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet. Sipas pikës 2 të nenit 122, një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Në rendin juridik të përcaktuar nga Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare janë mbi ligjet, por nën Kushtetutën, e cila është norma më e lartë në këtë hierarki, me përjashtim të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, së cilës në nenin 17 të saj Kushtetuta i ka dhënë vlerën e

standardit kushtetues, për sa i përket kufizimit të të drejtave të njeriut.

8. Duke pasur parasysh renditjen dhe klasifikimin e akteve normative që kanë fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, edhe pse renditen më lart se ligjet, ndodhen në një nivel më të ulët se sa normat dhe parimet kushtetuese. Për rrjedhojë, është e papranueshme që në rast përplasjeje me Kushtetutën, kjo e fundit të ketë synuar përjashtimin e tyre nga kontrolli i kushtetutshmërisë. Duke qenë se marrëveshja dhe ligji ratifikues janë të lidhur pashmangërisht me njëra-tjetrën, Gjykata vihet në lëvizje për kundërshtimin e ligjit ratifikues, për sa kohë që ndodhemi përpara ushtrimit të kontrollit *a posteriori* të normave, që kërkon që ato të kenë hyrë në fuqi paraprakisht, por e gjykon këtë akt në tërësinë e tij, pra jo vetëm për respektimin e aspekteve procedurale të miratimit të tij nga Kuvendi, por edhe në lidhje me aspektet përmbajtësore/substanciale të tekstit të marrëveshjes që është pjesë integrale dhe e pandashme e tij. Kontrolli kushtetues i ligjit ratifikues përfshin të gjitha elementet e tij: përmbajtjen në tërësi, pra edhe të marrëveshjes si pjesë përbërëse e tij, kompetencat për miratimin, ashtu edhe procedurën e miratimit.

9. Duke njohur juridiksionin e Gjykatës për të kontrolluar ligjin që jep pëlqimin për ratifikim, në mënyrë indirekte pranohet edhe kontrolli i marrëveshjes ndërkombëtare, në përputhje me supozimin se nëse kjo e fundit përmban dispozita që nuk janë në përputhje me Kushtetutën, atëherë ligji që jep pëlqimin për ratifikimin e një marrëveshjeje të tillë është, gjithashtu, në kundërshtim me Kushtetutën. Përndryshe, qëndrimi i shumicës që i ndan këto akte në drejtim të kontrollit të kushtetutshmërisë së tyre çon në një qasje dhe kontroll tërësisht formalist, duke pasur parasysh se verifikimi i procedurës parlamentare është i kufizuar vetëm në disa aspekte kushtetuese. Po kështu, shumica nuk ka analizuar dhe nuk ka vënë në diskutim se çfarë pasojash sjell ushtrimi i një kontrolli të tillë të kufizuar. Çfarë do të ndodhë me marrëveshjen ndërkombëtare dhe pasojat e saj në rast se Gjykata konstaton shkelje kushtetuese në procedurën parlamentare dhe shfuqizon ligjin ratifikues? A mund të qëndrojë më një



marrëveshje ndërkombëtare në rendin e brendshëm juridik, pasi ligji që i ka dhënë asaj këtë pozicion normativ do të përjashtohet nga ky rend përmes shfuqizimit?

10. Duke vijuar më tej, edhe e drejta ndërkombëtare nuk i ndalon shtetet që të përcaktojnë në të drejtën e tyre të brendshme raportin mes normave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të rregullojnë konfliktet mes tyre, duke mos vendosur një detyrim absolut për respektimin vetëm të akteve të së drejtës ndërkombëtare. Në këtë kuptim, pavarësisht vendit që u ka dhënë marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin tonë të brendshëm, Kushtetuta nuk ka parashikuar që e drejta ndërkombëtare ka përparësi absolute edhe mbi të drejtën kushtetuese, ndaj si ligjvënësi, ashtu edhe kjo Gjykatë është e detyruar vetëm nga rendi kushtetues (përmbajtja e tij) dhe jo përmbajtja e akteve të tjera normative, pavarësisht renditjes së tyre. Shumica është nisur nga prezumimi i kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, ndërkohë që nuk rezulton asnjë interpretim i tillë i normave kushtetuese që të pengojë kontrollin e përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën nga pikëpamja e vlerave dhe e parimeve kushtetuese.

11. As Marrëveshja objekt gjykimi dhe as ligji ratifikues i saj nuk janë norma të rangut kushtetues, ndaj këto burime të së drejtës nuk konsiderohen se janë të pakontrollueshme nga Gjykata. Edhe pse mjeti me anë të të cilit vihet në lëvizje gjykimi kushtetues është formalisht akti që lejon hyrjen e saj në sistemin juridik të brendshëm (ligji ratifikues), ritheksoj se kontrolli kushtetues përfshin përmbajtjen e aktit në tërësinë e tij, pra edhe tekstin e marrëveshjes ndërkombëtare pjesë e tij.

12. Thënë sa më sipër, në vlerësimin tim, Gjykata duhej të kishte deklaruar veten kompetente për të ushtruar kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të të gjithë procedurës së ndjekur për negociimin, miratimin, deri në ratifikimin e Marrëveshjes me ligj të Kuvendit, si faza të së një njëjtës procedurë. Për rrjedhojë, kontrolli kushtetues duhej të kishte vijuar më tej me shqyrtimin në themel të pretendimeve të kërkuarit që kanë të bëjnë me cenimin e neneve 4 dhe 7 të Kushtetutës, për shkak të mospërfshirjes së kreut të shtetit në

procedurën e negociimit të Marrëveshjes edhe pse ajo ka natyrë politike, si dhe cenimin e nenit 82 të Kushtetutës, për shkak se projektligji nuk është shoqëruar me relacionin e shpenzimeve financiare.

13. Këto pretendime të kërkuarit janë të lidhura me përcaktimin e natyrës së Marrëveshjes, në kuptim të nenit 121, pika 1, të Kushtetutës. Përcaktimi i kësaj natyre nëpërmjet normës kushtetuese që mbulon këtë akt është e lidhur në mënyrë thelbësore me të gjithë procedurën e realizuar për negociimin, miratimin dhe më pas ratifikimin e saj. Megjithatë, edhe në qasjen që ka përqaftuar Gjykata në këtë rast, një pretendim i tillë nuk mund të mbetet pa u trajtuar prej saj, pasi vë në dyshim në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe procedurën parlamentare për miratimin e ligjit ratifikues, si objekt i identifikuar i kontrollit kushtetues, në drejtim të respektimit të bazës kushtetuese ku kjo veprimtari është bazuar.

14. Edhe pse nuk vlerësoj të ndalem shumë gjatë në analizën e këtij pretendimi, vlerësoj të theksoj se përcaktimi i natyrës së Marrëveshjes, pra nëse ajo është me natyrë politike ose jo, pra nëse përfshihet në parashikimet e pikës 1 të nenit 121, është i mjaftueshëm për të arritur në një përfundim të drejtë në lidhje me këtë çështje. Ky element kushtetues çon më tej në verifikimin e dy aspekteve kryesore përgjatë kësaj procedure, konkretisht rolit dhe përfshirjes së Presidentit, si dhe respektimit të nenit 82, pika 1, të Kushtetutës në drejtim të akteve të procedurës parlamentare.

15. Sipas nenit 92, shkronja “ë”, të Kushtetutës, Presidenti lidh marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit. Duke iu referuar parashikimeve të ligjit nr. 43/2016, neni 5 ka parashikuar se marrëveshjet ndërkombëtare mund të lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose në emër të Këshillit të Ministrave. Marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë mund të nënshkruhen nga Presidenti i Republikës ose nga Kryeministri, anëtarët e Këshillit të Ministrave ose çdo zyrtar i lartë, në çdo rast, me autorizim nga Presidenti i Republikës, ndërsa marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Këshillit të Ministrave mund të nënshkruhen nga Kryeministri ose nga anëtarët e



Këshillit të Ministrave, ose çdo zyrtar i lartë, në çdo rast, me autorizim nga Kryeministri.

16. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se në rastet kur bëhet fjalë për marrëveshje me karakter *politik*, shfaqja e vullnetit jashtë vendit, në emër të Republikës, bëhet nga Presidenti, duke iu përmbajtur politikës së përcaktuar më parë nga qeveria dhe/ose parlamenti, sipas rastit. Marrëveshje me natyrë politike konsiderohen të gjitha ato marrëveshje që sjellin pasoja për ekzistencën e shtetit, integritetin territorial, pavarësinë e tij ose pozitën e vetë shtetit në arenën ndërkombëtare. Veçanërisht, konsiderohen si marrëveshje politike ato që lidhen direkt me shpalljen, sigurimin ose zgjerimin e pozitës së një shteti ndaj një shteti tjetër, si dhe ato që kanë të bëjnë me marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë. Është kjo arsyeja që hyrja në fuqi e këtyre marrëveshjeve kondicionohet edhe me dhënien e pëlqimit nga ligjvënësi, pra ratifikimin, pasi të tilla marrëveshje duhet të jenë të mbështetura te parimi i legjitimitetit demokratik të organeve të brendshme të një shteti, në përputhje me parimin e demokracisë (*shih vendimin nr. 15, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Kërkuesi ka pretenduar pikërisht se kjo Marrëveshje ishte me natyrë politike, pasi përfshihej në parashikimet e shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 121, për rrjedhojë ajo duhej të ishte lidhur në emër të Republikës dhe të nënshkruhej nga Presidenti ose personi i autorizuar prej tij dhe jo nga Këshilli i Ministrave. Sipas nenit 26, pika 4, të Rregullores së Kuvendit, projektligjet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare shqyrtohen nga Komisioni i Ligjeve, nga Komisioni për Politikën e Jashtme, nga komisioni që mbulon fushën në të cilën është bërë marrëveshja dhe, nëse marrëveshja ka efekte financiare, nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat. Referuar relacionit shoqërues të projektligjit, të paraqitur nga Këshilli i Ministrave, si bazë ligjore janë përcaktuar nenet 78, 83, pikat 1 dhe 3 dhe 121 të Kushtetutës. Kurse referuar raportit të Komisionit të Ligjeve të datës 2.12.2020, ai është shprehur se bazuar në nenin 121, pika 1, shkronja “ç” dhe nenin 17 të ligjit nr. 43/2016 marrëveshja do t’i nënshtrohet procedurës së

ratifikimit dhe do të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi. Në vlerësimin tim referimi nga Komisioni i Ligjeve në këtë dispozitë nuk mund të konsiderohet si një gabim material pasi prezumohet se deputetët e njohin ligjin ndaj nuk mund t’i referohen gabim atij e aq më pak normës kushtetuese ku bazojnë veprimtarinë e tyre. Përkundrazi, për sa kohë që ky komision si bazë kushtetuese ka përcaktuar shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 121, që përcakton se ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj në rastet kur kanë të bëjnë me marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë, ka pranuar se marrëveshja në fakt është politike. Për rrjedhojë, Kuvendi duhej të ishte ndalur në verifikimin e kushtetutshmërisë së procedurës për negociimin dhe miratimin e saj, në drejtim të mungesës së përfshirjes së kreut të shtetit.

18. Ritheksoj se pavarësisht qasjes së mbajtur nga shumica për juridiksionin e saj, ratifikimi nga Kuvendi me ligj i një marrëveshjeje që edhe pse do të rezultonte me natyrë politike nuk është nënshkruar në emër të Republikës së Shqipërisë, do të vinte në dyshim më së paku procedurën parlamentare dhe ushtrimin e kompetencave kushtetuese nga ky organ. Qëndrimi i shumicës e ka shndërruar kontrollin kushtetues në këtë procedurë, edhe pse i pranuar si i pjesshëm, në një kontroll formal, që ndalet vetëm në verifikimin e kuorumit të nevojshëm për zhvillimin e seancës dhe të numrit të votave për miratimin e ligjit, aspekte që rrallëherë ose asnjëherë do të arrinin të vinin në dyshim një procedurë të tillë parlamentare në drejtim të respektimit të parimeve të kushtetutshmërisë dhe shtetit të së drejtës.

19. Përcaktimi i natyrës së Marrëveshjes, përveç verifikimit të ushtrimit të kompetencave nga organet e përfshira në procesin e negociimit dhe miratimit, merr rëndësi edhe për sa i përket procedurës parlamentare, në drejtim të verifikimit të pretendimit tjetër të kërkuarit për shkeljen e nenit 82, pika 1, të Kushtetutës, për shkak të mungesës së shoqërimit të projektligjit me raportin që përlligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij.

20. Sipas nenit 82 të Kushtetutës propozimi i ligjeve, kur është rasti, duhet të shoqërohet me



raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij. Në thelb, kjo dispozitë përcakton detyrimin për paraqitjen e raportit që përligj shpenzimet financiare në rastet kur projektligji ndërhyt në financat publike, pra ndikon në buxhetin e shtetit, duke sjellë rritje shpenzimesh ose pakësim të të ardhurave të tij (*shih vendimin nr. 32, datë 27.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, projektligji hartohet në formën e një akti normativ dhe shoqërohet me relacionin, duke specifikuar kjo dispozitë edhe elementet që duhet të përmbajë ai. Kurse referuar sërish nenit 26, pika 4, të Rregullores së Kuvendit, që ka përcaktuar komisionet parlamentare në të cilat kalon shqyrtimi i projektligjeve për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ai parashikon në mënyrë të shprehur se nëse marrëveshja ka efekte financiare ajo shqyrtohet nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

21. Duke pasur parasysh që në ushtrimin e veprimtarisë legjislativë Kuvendi shfaqet si interpretues i parë i normave kushtetuese në miratimin e normave vetërregulluese dhe zbatimin e tyre, edhe shqyrtimi i këtij projektligji nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat të çon të nënkuptosh se ajo është vlerësuar si një marrëveshje që ka efekte financiare, për rrjedhojë do duhej të ishte shoqëruar edhe me relacionin përkatës shoqëruar. Mungesa e një akti të tillë bën ndesh, për rrjedhojë, me përmbajtjen e nenit 82, pika 1, të Kushtetutës, duke vënë në dyshim në aspektin kushtetues edhe procedurën e zhvilluar gjatë miratimit të ligjit ratifikues.

22. Duke qenë se në vlerësimin tim kontrolli kushtetues që shtrihet mbi ligjin ratifikues e përthith edhe marrëveshjen ndërkombëtare si pjesë e tij, rritet se kjo nënkupton që ky kontroll përfshin të gjithë procedurën si një e tërë, pra në të gjitha elementet e saj, që prej fillimit të saj (organi kompetent, autorizimi dhe tagrat e tij) dhe deri në realizimin e procedurës parlamentare. Për rrjedhojë, qoftë edhe konstatimi i një të mete kushtetuese në procedurën e ratifikimit të ligjit, do të bënte që të binte bashkë me të edhe Marrëveshja si pjesë përbërëse dhe e pandarë e tij.

23. Për të gjitha argumentet si më sipër, në vlerësimin tim si gjyqtare në pakicë, Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin e kërkesës dhe

shfuqizimin e ligjit nr. 145/2020, datë 3.12.2020, “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”, si i pajtueshëm me Kushtetutën.

Anëtare: Sonila Bejtja

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkesës, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, me objekt: “*Shfuqizimi i ligjit nr. 145/2020, datë 3.12.2020 Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, si i pajtueshëm me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 145/2020, datë 3.12.2020, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi*”, ne, gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Fiona Papajorgji, edhe pse bashkohemi me qëndrimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, konkurrojmë për arsyetimin e vendimit. Në vlerësimin tonë, çështja duhej trajtuar nën këndvështrimin *ratione temporis*, që kufizon kompetencën e Gjykatës për shqyrtimin e kërkesës.

2. Paraprakisht theksojmë se, ashtu sikurse ka evidentuar edhe shumica, Gjykata është vënë edhe më parë në lëvizje sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës për kontrollin e kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre, konkretisht për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të “Statutit të Romës” për Gjykatën Ndërkombëtare Penale (*shih vendimin nr. 186, datë 23.9.2002 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë, “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe të zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare” (*shih vendimin nr. 15, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërkohë, kjo është hera e parë që Gjykata merr në shqyrtim një kërkesë me objekt kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit ratifikues dhe marrëveshjes ndërkombëtare pas hyrjes në fuqi të kësaj të fundit, ndaj mungesa e jurisprudencës



në këtë drejtim ishte arsyeja themelore për të cilën kemi votuar për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

3. Marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar, objekt shqyrtimi, është negociuar nga Këshilli i Ministrave dhe është lidhur (nënshkruar) më datë 26.11.2020. Në vijim, ajo është ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 145/2020, datë 3.12.2020 (*ligji nr. 145/2020*), i cili është shpallur në heshtje nga Presidenti i Republikës. Marrëveshja ndërkombëtare, së bashku me ligjin nr. 145/2020 për ratifikimin e saj janë publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 8.1.2021. Neni 9 i marrëveshjes ndërkombëtare parashikon se ajo hyn në fuqi nga dita e njoftimit të fundit nga pala e fundit që përfundon procedurën e vetë kushtetuese të ratifikimit. Në zbatim të këtij neni, pala shqiptare më datë 8.2.2021 ka njoftuar palën e Emirateve të Bashkuara për përfundimin e procedurave të saj të brendshme. Të njëjtin njoftim e ka përcjellë edhe pala tjetër më datë 3.6.2021, i cili, duke qenë njoftimi i fundit, shënon edhe datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare. Në vijim, Ministria e Punëve të Jashtme ka njoftuar Qendrën e Botimeve Zyrtare për datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare. Pas kryerjes së këtyre njoftimeve nëpërmjet kanaleve diplomatike, marrëveshja ndërkombëtare, në bazë të nenit 122, pika 1, të Kushtetutës, është bërë pjesë e sistemit juridik shqiptar.

4. Pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare, një grup prej 36 deputetësh të Kuvendit, kanë vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për shfuqizimin e ligjit ratifikues të saj. Në përmbajtje të kërkesës së tyre janë formuluar dy kërtime: i) shfuqizimi i marrëveshjes ndërkombëtare, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “b”; ii) dhe shfuqizimi i ligjit nr. 145/2020 për ratifikimin e saj, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës.

5. Shumica, fillimisht, ka vlerësuar se Gjykata nuk ka juridiksion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të Kushtetutës për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare konkrete, në kushtet kur kërkesa është paraqitur pas ratifikimit të saj (*shih paragrafët 37 dhe 40 të vendimit*), vlerësim me të cilin ndajmë

të njëjtin qëndrim. Në vijim, ajo ka pranuar se Gjykata ka juridiksion për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit ratifikues të marrëveshjes ndërkombëtare (*shih paragrafin 41 të vendimit*), sipas nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës dhe se afati i paraqitjes së kërkesave me këtë lloj objekti është 2-vjeçar, njësoj si për çdo ligj tjetër (*shih paragrafin 49 të vendimit*). Sipas shumicës, nisur nga natyra e veçantë dhe përmbajtja e ligjit ratifikues, si një akt juridik i shprehjes së pëlqimit nga Republika e Shqipërisë për të qenë palë në një marrëveshje ndërkombëtare, por edhe në respektim të parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, në veçanti të rregullit *pacta sunt servanda*, juridiksioni i Gjykatës për kontrollin kushtetues të ligjit ratifikues të marrëveshjes ndërkombëtare kufizohet vetëm në aspektin formal, konkretisht në vlerësimin nëse ligji ratifikues është miratuar nga organi kompetent sipas procedurës së parashikuar nga Kushtetuta (*shih paragrafin 42 të vendimit*). Me këtë arsyetim, shumica ka kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit nr. 145/2020 dhe në përfundim ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

6. Në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se thelbi i mosmarrëveshjes kushtetuese kërkonte interpretimin përfundimtar të Kushtetutës për procesin e përfundimit të marrëveshjes ndërkombëtare dhe ndryshimin që ai ka nga procesi legjislativ, për të zgjidhur çështjen e kompetencës së Gjykatës për shqyrtimin e kërkesave të tilla dhe kufizimet kohore të kësaj kompetence (*ratione temporis*). Duke ndjekur këtë linjë arsyetimi, çmojmë se duhej vendosur rrëzimi i kërkesës për shkaqet e mëposhtme.

7. *Së pari*, jemi të mendimit se kompetenca e Gjykatës për të kontrolluar pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjit ratifikues kufizohet *ratione temporis* gjer në hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare. Shkaku i kufizimit kohor lidhet me marrëdhënien që ekziston midis së drejtës ndërkombëtare dhe asaj kombëtare. Kjo marrëdhënie rregullohet nga Kushtetuta, dispozitat e së cilës përcaktojnë rendin dhe klasifikimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare në sistemin juridik shqiptar. Kështu, pasi përcakton si parim themelor zbatimin e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë (*neni 5*), Kushtetuta, në



vijim, parashikon se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara bëhen pjesë e sistemit juridik të brendshëm, pasi botohen në Fletoren Zyrtare dhe kanë epërsi mbi ligjet (*neni 116 dhe 122, pikat 1 dhe 2*), madje, në raste të caktuara, kanë epërsi edhe mbi të drejtën e vendit (*neni 122, pika 3*) dhe se marrëveshjet ndërkombëtare kanë efekt të drejtpërdrejtë, përveçse kur ato parashikojnë nxjerrjen e një ligji (*neni 122, pika 1*).

8. Gjithashtu, në nenin 121, pika 4, të Kushtetutës përcaktohet se parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe denoncimin e marrëveshjeve ndërkombëtare parashikohen me ligj. Bëhet fjalë për ligjin nr. 43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 43/2016*), i cili rregullon procesin e përfundimit të marrëveshjeve ndërkombëtare. Në fakt, rregullat e ligjit janë në përputhje (shpesh edhe përsëritje), me parimet dhe procedurat e Konventave të Vjenës, “Për të drejtën e traktateve”, të viteve 1969 dhe 1986, (në të cilat Republika e Shqipërisë ka aderuar respektivisht me ligjet nr. 8696/2000 dhe nr. 18/2014), ndërsa çështjet e parregulluara në ligj trajtohen sipas normave të së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme në Republikën e Shqipërisë (*neni 37 i ligjit nr. 43/2016*).

9. Nga analiza e këtij kuadri normativ, rezulton se procesi i lidhjes dhe përfundimit të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar përfshin rregullat e pajtimit të vullneteve shtetërore në nivel ndërkombëtar, që materializohen në fazat e negocimit⁵, lidhjes (nënshkrimit)⁶, ratifikimit⁷, botimit dhe hyrjes në fuqi të saj⁸. Në kushtet kur procedurat e ratifikimit në sistemet juridike të shteteve palë në marrëveshje ndërkombëtare realizohen në kohë dhe me procedura të brendshme të ndryshme, atëherë hyrja në fuqi e marrëveshjes është e lidhur me njoftimin e ndërsjellë të instrumenteve të ratifikimit – konkretisht me ditën e njoftimit të fundit. Kjo është edhe arsyeja që ligji nr. 43/2016 parashikon detyrimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të përcjellë

aktet e njoftimit të instrumenteve të ratifikimit për botim në Qendrën e Botimeve Zyrtare⁹. Kështu, edhe në rastin konkret, në nenin 9, paragrafi i parë, të marrëveshjes ndërkombëtare është parashikuar, ndër të tjera, se palët do të njoftohen me kanale diplomatike për përfundimin e procedurave kushtetuese të nevojshme për ratifikimin nga parlamenti të kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare dhe se ajo hyn në fuqi nga data e marrjes së njoftimit të fundit. Në këtë kuptim, shkëmbimi i instrumenteve të ratifikimit përcakton kohën e saktë se kur marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar ka efekte juridike të plota në rang ndërkombëtar. Ndërsa botimi i saj në Fletoren Zyrtare siguron njohjen e qytetarëve me rregullat e saj dhe pas botimit ajo bëhet pjesë e sistemit juridik të brendshëm.

10. Ndërkohë, dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuar që janë bërë pjesë e rendit juridik, mund të ndryshohen¹⁰ ose pushojnë së vepruari, në kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar në vetë ato ose në përputhje me rregullat e së drejtës ndërkombëtare, që janë reflektuar në ligjin nr. 43/2016. Kurse nxjerrja e njëanshme e marrëveshjes ndërkombëtare e ratifikuar nga sistemi i brendshëm juridik ndjek vetëm procedurën e denoncimit të saj, siç përcaktohet nga neni 121, pika 4, i Kushtetutës, i konkretizuar nga ligji nr. 43/2016. Ky përcaktim kushtetues mbështetet edhe nga kompetenca e kufizuar në kohë e Gjykatës për kontrollin kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare vetëm para ratifikimit të tyre, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës.

11. Nën këtë analizë, nuk pajtohemi me shumicën kur ajo pohon se ligji ratifikues mund të kontrollohet nga Gjykata, qoftë edhe vetëm në aspektin formal, brenda afatit 2-vjeçar nga hyrja e tij në fuqi, njësoj si çdo ligj tjetër (*shih paragrafin 49 të vendimit*). Pranimi i një ideje të tillë sjell mundësinë që ligji ratifikues të shfuqizohet pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare dhe shfuqizimi eventual i tij, në thelb, godet vetë marrëveshjen ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, krijohet situata që Kushtetuta nuk e pranon – atë të zhvlehtësimit të marrëveshjes ndërkombëtare

⁵ Neni 9 i ligjit nr. 43/2016.

⁶ Neni 15 i ligjit nr. 43/2016.

⁷ Neni 17 i ligjit nr. 43/2016.

⁸ Neni 117, pika 3 i Kushtetutës dhe neni 16 i ligjit nr. 43/2016.

⁹ Neni 33, pika 3, i ligjit nr. 43/2016

¹⁰ Neni 23 i ligjit nr. 43/2016.



pas hyrjes në fuqi të saj, sipas një procedure që nuk parashikohet në vetë marrëveshjen ndërkombëtare dhe përtej procedurës kushtetuese të denoncimit. Për rrjedhojë, kjo procedurë e ndryshme zhvleftësimi e marrëveshjes ndërkombëtare, e cila, tashmë, është lënë si mundësi nga shumica, bie ndesh me parimin kushtetues të detyrueshmërisë të së drejtës ndërkombëtare (*neni 5 i Kushtetutës*), si dhe nuk përputhet me kompetencën e Gjykatës, së cilës i është njohur vetëm kompetenca për të kontrolluar marrëveshjen ndërkombëtare vetëm para ratifikimit. Po kështu, kjo bie ndesh edhe me parimin tjetër themelor të së drejtës ndërkombëtare *pacta sunt servanda*, që edhe shumica e pranon si një gur themeli në rendin ligjor ndërkombëtar. Ajo që minohet nëpërmjet kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit ratifikues pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare, është pikërisht serioziteti i shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Këtë fakt juridik shumica nuk e merr në konsideratë dhe nuk e analizon.

12. *Së dyti*, duke marrë shkas nga çështja konkrete, Gjykata duhej të interpretonte konceptin kushtetues të ratifikimit, i cili, sipas vlerësimit tonë, është i gjerë dhe nuk përfshin vetëm procedurën e miratimit nga Kuvendi të ligjit ratifikues. Duke u bazuar në parimin themelor kushtetues, sipas të cilit Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme (*neni 5*), rezulton se në nivel kushtetues ratifikimi përfaqëson të gjithë procesin e përfundimit të marrëveshjes ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë, deri në hyrjen në fuqi të saj. Ky interpretim i domosdoshëm për të pajtuar dhe përmbledhur termit e ndryshëm të përdorur në të drejtën ndërkombëtare, të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë (të tilla si: ratifikimi, aderimi, pranimi, miratimi), merr rëndësi në gjykimin konkret për të përcaktuar në vijim konceptet kushtetuese të ligjit ratifikues dhe të momentit kohor “para ratifikimit”.

13. *Së treti*, kufizimi *ratione temporis* i kompetencës së Gjykatës për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit ratifikues nuk mund të njësohet me atë të ligjit, si produkt i procesit legjislativ vetëm për shkak se akti juridik ka të

njëtin emër, “ligji”. Procesi i përfundimit të marrëveshjeve ndërkombëtare është thelbësisht i ndryshëm nga proceset e tjera normative të brendshme, siç është procesi legjislativ për miratimin e ligjeve, për shkak se aktet juridike që miratohen prej tyre janë tërësisht të ndryshme, nga pikëpamja e burimit të krijimit të tyre dhe renditjes/vlerës në piramidën e akteve normative. Duke mbajtur në konsideratë këtë ndryshim, Kushtetuta i ka rregulluar ato në mënyrë të ndarë nga njëri-tjetri, që do të thotë se procedura e miratimit të tyre dhe shpërndarja e kompetencave të organeve kushtetuese është e ndryshme.

14. Kështu, Kushtetuta, marrëveshjeve ndërkombëtare i ka dedikuar nenet 121–123 në kreun II të pjesës së shtatë, duke përcaktuar shprehimisht në pikën 4 të nenit 121 se procedura për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare parashikohet me ligj. Kjo do të thotë se procesi vendimmarrës i marrëveshjeve ndërkombëtare nuk është përfshirë në rregullat e procesit ligjvënës, të cilit i dedikohen nenet 81–85 në kreun IV të pjesës së tretë të Kushtetutës. Dallimi midis këtyre dy proceseve evidentohet edhe në përmbajtjen e nenit 117, pika 3, të Kushtetutës, i cili duke përcaktuar se marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj, shpallen dhe botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet, sanksionon elementin procedural (shpalljen dhe botimin) që ato e kanë të njëjtë. Normimi kushtetues i ndarë është tregues i qartë se procedura që ndjek vendimmarrja e organeve kushtetuese për marrëveshjen ndërkombëtare, ku përfshihet edhe ligji ratifikues, është e ndryshme nga ajo e procesit legjislativ, ku miratohen aktet normative të llojit ligj. Për të ilustruar, nga pikëpamja procedurale, ndryshimin midis ligjit ratifikues dhe ligjit, si akt normativ, vlen të evidentohet fakti se ligji ratifikues ka propozues vetëm Këshillin e Ministrave, duke përjashtuar mundësinë e propozimit të deputetit ose të 20 mijë zgjedhësve, siç ndodh te ligji gjatë procesit legjislativ.

15. Karakteristika e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara lidhet me faktin që ajo është produkt i vullnetit të përbashkët të shtetit shqiptar me të paktën një shtet tjetër. Për këtë arsye, procesi i përfundimit të marrëveshjes



ndërkombëtare zhvillohet me ndërveprimin e organeve kushtetuese të shtetit shqiptar, sipas kompetencave që u ka dhënë Kushtetuta, me ato të shtetit të huaj, sipas kompetencave të rendit juridik të huaj, ndërveprim i cili krijon akt normativ me efekte juridike në nivel ndërkombëtar.

16. Duke mbajtur në konsideratë këtë karakteristikë, Kushtetuta, në nenin 116 të saj, e cilëson marrëveshjen ndërkombëtare të ratifikuar si akt normativ që ka fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke e renditur të dytën në piramidën e hierarkisë së akteve normative. Kjo do të thotë se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara gëzojnë, nga pikëpamja formale, një status *supra* legjislativ, por në lidhje me Kushtetutën ato renditen poshtë saj. Pozicionimi i lartë i tyre në këtë renditje dëshmon rëndësinë dhe fuqinë që ato kanë për normimin e çështjeve që i përkasin shtetit dhe shoqërisë shqiptare. Kjo konfirmohet edhe nga neni 122, pika 2, i po kësaj Kushtetute, sipas të cilit një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Në këndvështrim të rëndësisë që ka përfshirja e një marrëveshjeje ndërkombëtare në sistemin e brendshëm ligjor, jo pa qëllim Kushtetuta i ka dhënë kompetencën Gjykatës për të kontrolluar pajtueshmërinë e ligjeve, jo vetëm në raport me të, por edhe me marrëveshjet ndërkombëtare, sikurse e përcakton shprehimisht neni 131, pika 1, shkronja “a”, i saj. Në këtë mënyrë, një ligj që bie ndesh me një rregull të përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare cenon rendin kushtetues, prandaj mund të pranohet se roli i tyre është i njëjtë me atë të Kushtetutës dhe se ato në të vërtetë gëzojnë një status *quasi* kushtetues në rendin kushtetues.

17. Së katërti, ligji ratifikues i marrëveshjes ndërkombëtare, edhe pse miratohet nga Kuvendi, është një akt juridik i ndryshëm nga ligji, që miratohet si akt normativ në përfundim të procesit ligjvënës. Ligji ratifikues është instrumenti procedural që materializon vullnetin shtetëror për marrjen përsipër të angazhimeve në nivel ndërkombëtar. Këtë vullnet Kushtetuta, në bazë të neneve 121 dhe 122, ia ka besuar Kuvendit, jo vetëm për të shpërndarë në mënyrën e duhur kompetencat në fushën e politikës së jashtme, por edhe për dy qëllime të

tjera. Nga njëra anë, ratifikimi me ligj nga Kuvendi i jep marrëveshjes ndërkombëtare një nivel të mjaftueshëm legjitimiteti demokratik dhe, nga ana tjetër, siguron që Kuvendi të ushtrojë kontroll efektiv mbi ekzekutivin, përpara se një marrëveshje të bëhet e detyrueshme, sipas së drejtës ndërkombëtare. Në përfundim të procesit, marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar bëhet pjesë e sistemit juridik shqiptar.

18. Në këtë kuptim, ligji ratifikues është një akt juridik i brendshëm, i miratuar vetëm me vullnetin e ligjvënësit shqiptar, ndaj, ai i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Në këtë pikë biem dakord me shumicën, por ajo që na ndan është fakti se ligji ratifikues nuk njësohet me ligjet e tjera, sepse nuk ka vlerë normative, por vetëm vlerë instrumentale ndaj marrëveshjes. Kjo është arsyeja që ligji ratifikues nuk mund të gjejë renditje dhe klasifikim të veçantë në piramidën e akteve normative të nenit 116 të Kushtetutës, sepse si instrument i marrëveshjes ndërkombëtare, ai është në funksion të procesit të përfundimit të saj. Pra, ligji ratifikues i shërben vlefshmërisë së procesit të përfundimit të marrëveshjes ndërkombëtare.

19. Ky konkluzion bazohet në nenin 122, pika 1, të Kushtetutës, si dhe në rregullat e Konventës së Vjenës dhe të ligjit nr. 43/2016, të cilat parashikojnë se ratifikimi është akti juridik me të cilin shprehet pëlqimi i Republikës së Shqipërisë për të qenë palë në një marrëveshje ndërkombëtare (neni 17 i ligjit nr. 43/2016 dhe neni 14 i Konventës së Vjenës). Mungesa e vlerës normative të ligjit ratifikues vihet re lehtësisht gjatë zbatimit të normave juridike në praktikë, ku në çdo rast referenca juridike vendoset te përmbajtja e marrëveshjes ndërkombëtare dhe jo te ligji ratifikues, i cili përmendet thjesht si atribut i marrëveshjes për të evidentuar që bëhet fjalë për marrëveshje të ratifikuar me ligj.

20. Në ndryshim nga ligjet si akte normative të miratuara me anë të procesit ligjvënës, ligji ratifikues ka përmbajtje konkrete dhe shtron në zbatimin e tij, pasi në përmbajtje ai zyrtarizon vullnetin e Kuvendit për t'u angazhuar në një marrëveshje. Në thelb, ligji ratifikues është akti në formë të shkruar, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e pjesë në një marrëveshjeje ndërkombëtare, pra për të



përfitur të drejta e për të përmbushur detyrime dhe që është nënshkruar më parë prej saj. Këto tipare janë një tregues tjetër i natyrës instrumentale të ligjit ratifikues.

21. Për të kuptuar natyrën instrumentale të ligjit ratifikues mund të përdoret analogjia me aktet juridike në procesin ligjvënës. Kështu, në rastin e një ligji të propozuar nga Këshilli i Ministrave, praktika legislative përmban disa akte juridike të mëvetshme, siç janë vendimi i Këshillit të Ministrave për propozimin e projektligjit, ligji i miratuar nga Kuvendi dhe dekreti i Presidentit të Republikës për shpalljen e ligjit. Megjithatë, VKM-ja dhe dekreti i Presidentit janë akte instrumentale të ligjit, ndaj në hipotezën që ndonjë prej tyre përmban vese kushtetuese, atëherë gjykimi kushtetues do të vihet në lëvizje sipas kompetencës së Gjykatës për kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit dhe jo sipas akteve të tjera normative.

22. Për sa më sipër, vlerësojmë se, paraprakisht, shumica në shqyrtimin e kërkesës duhej të shpjegonte natyrën dhe karakteristikat e ligjit ratifikues, jo vetëm në drejtim të hierarkisë së normave juridike ose të përmbajtjes së tij, por në drejtim të vlerës së tij normative, si instrument për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare.

23. *Së pesti*, ashtu siç pohon shumica, marrëveshja ndërkombëtare dhe ligji ratifikues janë dy akte juridike të mëvetshme. Por, edhe pse marrëveshja ndërkombëtare dhe ligji ratifikues i saj mund të jenë dy akte të veçanta juridike, për sa i takon vendit të tyre në hierarkinë e normave juridike ose edhe nëse ligji ratifikues është instrument i mëvetshëm në lidhje me marrëveshjen në vetvete (*shih paragrafin 32 të vendimit*), kjo nuk do të thotë që në kuptim të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve, në zbatim të nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, ligji ratifikues të barazohet me çdo ligj tjetër.

24. Në fakt, edhe vetë shumica bie në kontradiktë, sepse, nga njëra anë, pohon se për kundërshtimin e ligjit ratifikues, për sa kohë që ai është pjesë e juridiksionit kushtetues, gjejnë zbatim të njëjtat kritere ligjore që zbatohen për kundërshtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të akteve normative, për rrjedhojë edhe afati ligjor 2-vjeçar nga hyrja e tij në fuqi (*shih paragrafin 49 të vendimit*), nga ana tjetër, shumica

evidenton se juridiksioni i Gjykatës për kontrollin kushtetues të ligjit ratifikues të marrëveshjes ndërkombëtare nuk mund të jetë i pakufizuar. Përkundrazi, ky juridiksion kufizohet vetëm në aspektin formal, domethënë në vlerësimin nëse ligji ratifikues është miratuar nga organi kompetent sipas procedurës së parashikuar nga Kushtetuta (*shih paragrafin 42 të vendimit*).

25. Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës, sepse vlerësojmë se marrëveshja ndërkombëtare dhe ligji ratifikues janë akte juridike, të cilat nxirren brenda të njëjtut proces – atij të përfundimit të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar. Kështu, marrëveshja ndërkombëtare nuk mund të bëhet pjesë e rendit juridik pa ligjin ratifikues, ndërsa pa pasur një marrëveshje ndërkombëtare të lidhur (të nënshkruar), nuk mund të miratohet ligji ratifikues. Në këtë kuptim, vlerësojmë se përcaktuese për kompetencën e Gjykatës për shqyrtimin e këtyre akteve është interpretimi i konceptit kushtetues “*para ratifikimit*”, për të cilin jemi të mendimit se i referohet procesit të përfundimit të marrëveshjes dhe jo vetëm momentit të votimit të ligjit ratifikues në Kuvend.

26. Kjo merr kuptim nëse mbahet në konsideratë se sistemi ynë normativ është i llojit monist, sikurse thekson edhe shumica, për sa u takon marrëveshjeve ndërkombëtare, dhe Kushtetuta ka zgjedhur modelin e kontrollit *ex ante* të marrëveshjeve, për të ruajtur besueshmërinë në nivel ndërkombëtar (*shih paragrafët 30, 34 dhe 35 të vendimit*). Për rrjedhojë, analiza në këtë këndvështrim do të merrte rëndësi edhe për vetë jurisprudencën kushtetuese, pasi Gjykata e kishte mundësinë të shpjegonte konceptin kohor “*para ratifikimit*”, që përcaktohet në nenin 131, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës.

27. Në këtë pikë, duhet evidentuar se çdo marrëveshje, konventë ose akt tjetër ndërkombëtar dypalësh, ose shumëpalësh përmban rregullin kohor të hyrjes në fuqi të saj. Sikurse u përmend më sipër, për sa i takon Shqipërisë, kjo lidhet me njoftimin e ligjit ratifikues dhe hartimin e instrumenteve të ratifikimit, sipas parashikimeve të vetë



marrëveshjes¹¹. Në këtë kuptim, duket që koncepti kushtetues “*para ratifikimit*”, në rastin e ligjit ratifikues, përfshin periudhën kohore deri në momentin që dërgohet, pritët ose depozitohet instrumenti i fundit i ratifikimit.

28. Për sa më lart, mendojmë se me këtë vendim të shumicës Gjykata ka humbur një mundësi për të vendosur një standard kushtetues të rëndësishëm lidhur me kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit ratifikues të një marrëveshjeje ndërkombëtare.

29. Si përfundim, nën dritën e argumenteve të mësipërme, vlerësojmë se kriteri për (mos)legjitimitimin *ratione temporis* të kërkuarit duhet të trajtohet nga shumica në lidhje me procesin e përfundimit të marrëveshjes ndërkombëtare dhe të përbënte shkakun për rrëzimin e kërkesës konkrete, e cila është paraqitur jashtë afatit kohor kushtetues.

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari

VENDIM

Nr. 8, datë 3.7.2023

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 ‘Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit

të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 8, datë 3.7.2023 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi nr. 4, dosja nr. 115/a, “Raport mbi luftën kundër burokracisë për vitin 1967”, me 22 (njëzet e dy) fletë, kutia 26. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

2. Fondi nr. 4, dosja nr. 115/8, “Udhëzim dërguar DPB-ve mbi masat kundër veprimtarisë armiqësore të elementit antiparti”, viti 1968, me 7 (shtatë) fletë, kutia 26. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

3. Fondi nr. 4, dosja nr. 23/3, “Vendim i byrosë mbi zgjerimin e kufinjve të qarkullimit të përfaqësive diplomatike të vendeve kapitaliste në vendin tonë”, viti 1955, me 5 (pesë) fletë, kutia 28. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

4. Fondi nr. 4, dosja nr. 25, “Relacion dërguar Ministrisë së Jashtme mbi veprimtarinë armiqësore të funksionarëve të legatës jugosllave në rrethin e Shkodrës”, viti 1957, me 2 (dy) fletë, kutia 29. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

5. Fondi nr. 4, dosja nr. 26, “Relacione mbi lëvizjet e dyshimta të B. V., student në Shkollën e Partisë “Lenini”, viti 1958, me 13 (trembëdhjetë) fletë, kutia 29. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Fondi nr. 4, dosja nr. 28/2, “Raport propozime mbi kombinacionet të rëndësishme dhe relacionet përkatëse nën drejtim të objektit kryesor dhe objekteve në veçanti “Lordi”; teknika operative dhe kompjimin e çelësave”, viti 1959–1960, me 150 (njëqind e pesëdhjetë) fletë, kutia 30. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

7. Fondi nr. 4, dosja nr. 521, “Informacion për disa shqetësime që janë krijuar nga dorëzimi i kufomave të personave të vrarë në kufi, familjeve të tyre për varrim”, viti 1990, me 4 (katër) fletë, kutia 251. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

8. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje përpunimi nr. 3965, në ngarkim të B. K., viti 1967–1990, me 2 volume, me 167 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) dhe 25 (njëzet e pesë)

¹¹ Nenet 31 dhe 32 të ligjit nr. 43/2016.



fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

9. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Mirditë, dosje formulare nr. 1326, në ngarkim të N. P, viti 1981, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

10. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje përpunimi nr. 2785, viti 1976–1990, me 104 (njëqind e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

11. Fondi Operativ, dosja agenturale nr. 2583, me pseudonimin “Tigri”, viti 1980–1982, me 2 volume, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

12. Fondi i të arratisurve, dosje nr. 30, vitet 1958–1988, me 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

13. Fondi i të Arratisurve, dosje nr. 494, vitet 1943–1951, me 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

14. Fondi i të arratisurve, dosja nr. 28, vitet 1957–1988, me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

15. Fondi i të arratisurve, dosja nr. 29, vitet 1948–1960, me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

16. Kartelë model. 2, me nr. 1335, me pseudonimin “Elida”, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

17. Fondi Emigrantët Ekonomikë, dosje fashikullore nr. 522, viti 1959–1961, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

18. Fondi Emigrantët Ekonomikë, dosje kërkimi nr. 649, viti 1948–1964, me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

19. Fondi i të arratisurve, dosja formulare nr. 1957/18, vitet 1940–1965, me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

20. Fondi Kosova, dosja nr. 13058, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

21. Fondi Kosova, dosja nr. 251, me 12 (dymbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1944–

1950. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

22. Fondi Kosova, dosja nr. 250, me 133 (njëqind e tridhjetë e tre) fletë; dosja daton në vitin 1945–1976. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

23. Fondi Kosova, dosja nr. 170, me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë; dosja daton në vitin 1943–1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

24. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje përpunimi nr.10, viti 1952–1989, me 6 volume, me 789 (shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

25. Fondi Operativ, dosja formulare nr. 5779, viti 1959–1961, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

26. Fondi Operativ, dosja formulare nr. 5036, viti 1962–1988, me 238 (dyqind e tridhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

27. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosja formulare nr. 4852, viti 1966–1980, me 185 (njëqind e tetëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

28. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, dosja përpunimi nr. 1805, viti 1972–1988, me 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

29. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje përpunimi nr. 6523, viti 1946–1989, me 151 (njëqind e pesëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

30. Fondi Operativ, dosja nr. 1683, viti 1948–1979, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

31. Fondi Operativ, dosje formulare nr. 1356, viti 1946–1977, me 41 (dyzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

32. Fondi Përpunimi, dosja nr. 484, viti 1946–1987, me 108 (njëqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

33. Fondi nr. 4, dosja nr. 166, “Përgjithësime dërguar Degës së Punëve të Brendshme mbi disa shkelje të evidencuara në ndjekjen e një përpunimi me tendencë sabotimi dhe mbi zbulimin e goditjes e sabotatorit H. F. në Ndërmarrjen e Ndërtimit Tepelenë”, viti 1981,



me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

34. Fondi Drejtoria e Dytë, dosja pa numër, viti 1988, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

35. Fondi Grupet, dosja fashikull pa numër, viti 1983, me 80 (tetëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

KRYETAR
Gentiana Sula

VENDIM
Nr. 9, datë 3.7.2023

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar; në kreun I, neni 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar; me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 ‘Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 9, datë 3.7.2023, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje pune nr. 1 (2882), me pseudonimin “Tomorri”, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitin 1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

2. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje pune nr. 2 (2884), me pseudonimin “Pëllumbi”, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

3. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 3 (2592), me pseudonimin “Liqeni”, me 13 (trembëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1983–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

4. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 4 (2891), me pseudonimin “Besniku”, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitin 1987–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

5. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 5 (2565), me pseudonimin “Artisti”, me 34 (tridhjetë e katër) fletë; dosja daton në vitin 1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

6. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 6, me pseudonimin “Lisi”, me 49 (dyzet e nëntë) fletë; dosja daton në vitin 1987–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

7. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 7 (2254), me pseudonimin “Adriatiku”, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1985–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

8. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 8 (2233), me pseudonimin “Bogdani”, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1985–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

9. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 9 (2607), me pseudonimin “Konspiratori”, me 13 (trembëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1984–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

10. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 10 (2658), me pseudonimin “Bujari”, me 13 (trembëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1985–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.



11. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 11 (2144), me pseudonimin “Pushka”, me 28 (njëzet e tetë) fletë; dosja daton në vitin 1979–1986; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

12. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 12 (2106), me pseudonimin “Sinjali”, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1979–1986; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

13. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 13 (13759), me pseudonimin “Mullavci”, me 13 (trembëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1984–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

14. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 14 (14330), me pseudonimin “Jezerca”, me 30 (tridhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1986–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

15. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 15 (782), me pseudonimin “Misari”, me 48 (dyzet e tetë) fletë; dosja daton në vitin 1962–1967; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

16. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 16 (2659), me pseudonimin “Drejtësia”, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë; dosja daton në vitin 1984–1985; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

17. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 17 (2280), me pseudonimin “Graniti”, me 43 (dyzet e tre) fletë; dosja daton në vitin 1986–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

18. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje pune nr. 18 (2871), me pseudonimin “Mali”, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1987–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

19. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 19 (2897), me pseudonimin “Debatiku”, me 25 (njëzet e pesë) fletë; dosja daton në vitin 1973–1989; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

20. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 20 (2383), me pseudonimin “Kreshniku”, me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë; dosja daton në vitin

1981–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

21. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 21 (2859), me pseudonimin “Besa”, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1987; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

22. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 22 (2570), me pseudonimin “Rudeshi”, me 21 (njëzet e një) fletë; dosja daton në vitin 1984–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

23. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 23 (2865), me pseudonimin “Inteligjenti”, me 32 (tridhjetë e dy) fletë; dosja daton në vitin 1985–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

24. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje pune nr. 24 (2900), me pseudonimin “Kitara”, me 10 (dhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1987–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

25. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje pune nr. 25 (2899), me pseudonimin “Spiranca”, me 28 (njëzet e tetë) fletë; dosja daton në vitin 1987–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

26. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje pune nr. 26 (2842), me pseudonimin “Sulmi”, me 12 (dymbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1987–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

27. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje pune nr. 27 (2357), me pseudonimin “Kalibri”, 13 (trembëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1986–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

28. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 28 (2901), me pseudonimin “Furtuna”, me 31 (tridhjetë e një) fletë; dosja daton në vitin 1987–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

29. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 29 (2960), me pseudonimin “Sportisti”, me 13 (trembëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1986–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

30. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje pune nr. 30 (2879), me



pseudonimin “Bregu i detit”, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1987–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

31. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 31 (2830), me pseudonimin “Sulbica”, me 13 (trembëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1983–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

32. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 32 (2843), me pseudonimin “Kukuli”, me 26 (njëzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitin 1987–1988; kutia 1; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

33. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 33 (2076), me pseudonimin “Shpata”, me 21 (njëzet e një) fletë; dosja daton në vitin 1978–1981; kutia 2; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

34. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 34 (2069), me pseudonimin “Gështenja”, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1978–1981; kutia 2; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

35. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 35 (1201), me pseudonimin “Guximtari”, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1951–1981; kutia 2; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

36. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 36 (2343), me pseudonimin “Grumbullimi”, me 13 (trembëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1959–1981; kutia 2; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

37. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 37 (900), me pseudonimin “Edukata”, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1953–1981; kutia 2; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

38. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale dhe pune nr. 38 (40), me pseudonimin “Kopaçi”, me 43 (dyzet e tre) fletë; dosja daton në vitin 1964–1981; kutia 2; grupi 1. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

39. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tropojë, dosje personale nr. 39 (1940), me

